



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 29 SHTATOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 29. SEPTEMBRA 2016. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Votimi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
5. Votimi i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,
6. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 6 deputetë nënshkrues, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës,
7. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës,
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 05/106, datë 25. 8. 2016, me të cilin konsiderohet interesi publik nga lëshimi i licencës për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC,
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 06/106, datë 25. 8. 2016, me të cilin konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës për hulumtim për Projektin e Kompanisë Sharr Cem dhe Titan Amerika,
10. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice
2. Priprema za plenarnu sednicu
3. Vreme za izjave van dnevnog reda,
4. Glasanje za imenovanje jednog člana u Komisiji za imovinske zahteve,
5. Glasanje za Nacrt zakona o strateškim investicijama u Republici Kosova,
6. Interpelacija premijera Isa Mustafa, na zahtev poslanika Visar Ymeri, podržan od 6 poslanika potpisnika, u vezi državnog telefonskog koda Republike Kosova,
7. Interpelacija premijera Isa Mustafa, na zahtev poslanika Ismajl Kurteshi, podržan od 7 poslanika potpisnika, u vezi aktuelne političke situacije u severnom delu Republike Kosova,
8. Razmatranje predloga –odluke Vlade Republike Kosova br. 05/106 od 25. 08. 2016 godine na osnovu koje se smatra od javnog interesa izdavanje licence za projekat Kompanije Envidity Energy Kosova LLC,
9. Razmatranje predloga-odluke Vlade Republike Kosova br. 06/106 od 25. 08. 2016 godine na osnovu koje se smatra od javnog interesa izdavanje licence za istraživanje za projekat Kompanije Sharr Cem i Titan Amerika,
10. Izbor jednog (1) člana u Tužilačkom savetu Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Po fillojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës,
të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 2016.

Të nderuar kolegë,
Më lejoni para se të fillojmë mbledhjen e seancës plenare, ta theksojmë një fakt të veçantë për ta
shënuar një ditë të veçantë të rrugëtimit tonë nacional për pavarësi - 25-vjetorin e Referendunit
të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Për një fjalë rasti e kisha ftuar nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, profesor Sabri
Hamitin që ta marrë fjalën. Faleminderit!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Dua të kujtojmë sot bashkë në Kuvend dhe në gjithë vendin 25-vjetorin e një ngjarjeje të shënuar
për Republikën tonë - Referendumin për pavarësinë e Kosovës që u mbajt nga 26-30 shtator të
vitit 1991.

Organizuar në Kosovë në republikat ish-jugosllave, në Evropë, në Amerikë, në Australi dhe
gjetiu, nga 99,87% e qytetarëve të Kosovës që dolën ato ditë në referendum, 81,01% e trupit
votues votuan për. Me shumicë absolute, gati një milion njerëz, e pohuan vullnetin për sovranitet
të Kosovës.

Rezultatet e Referendunit u formalizuan më pastaj me Rezolutë të Kuvendit të Kosovës.

Edhe nëse nuk u pranuan formalisht këto rezultate në kancelaritë e botës, në fillim jo se jo, u
njohën botërisht si zëri autentik i një populli që po e afirmonte me disiplinë politike e kulturore
qytetare subjektivitetin e veçantë dhe imperativin e ekzistencës së vet.

Referendumi për pavarësi vërtetoi dhe legjitimoi Deklaratën e Pavarësisë të 2 Korrikut 1990 dhe
shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës të 7 shtatorit të po këtij viti.

Referendumi u parapriu zgjedhjeve të para demokratike parlamentare presidenciale në vend, më
24 maj 1992.

Këto ishin themelet juridike e demokratike të shtetit të Kosovës, që do të bëhej me rrugë
institucionale politike, më vonë edhe ushtarake për liri e pavarësi të vendit.

Referendumi popullor i vitit 1991, me organizimin e pashoq dhe me votën masive, të
papërsëritshme në historinë e re të Kosovës, e konfirmoi vullnetin e popullit për liri dhe pavarësi,
por edhe përcaktimin për demokraci përfaqësuese.

Kosova mund të drejtohej vetëm nga njerëz të zgjedhur prej popullit me besimin e tij.

Prijësi historik i Kosovës, Ibrahim Rugova, kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, forcës kryesore politike, por edhe i Këshillit të Partive Politike Shqiptare të atëhershme, duke u bërë president me votë të drejtpërdrejtë, e udhëhoqi me urti popullin e Kosovës në rrugën e gjatë e të vështirë të jetësimit të vullnetit të vet, duke e fituar lirinë në vitin 1999 dhe pavarësinë përfundimisht në vitin 2008.

Kjo, me punën e madhe të qindra-mijëra njerëzve pjesëmarrës në rezistencë aktive, ndërtues të shtetit, por edhe me sakrificën më sublime të mijëra e mijëra shqiptarëve në luftën çlirimtare në fund të shekullit të kaluar, që e gëzoi përkrahjen e botës demokratike e të Aleancës më të madhe politike ushtarake, NATO.

Referendumi i vitit 1991 dhe zgjedhjet e vitit 1992 e shtruan rrugën e pakthyeshme institucionale për realizimin e pavarësisë së Kosovës si një çështje ekzistenciale për ne atëherë dhe sot. Bashkë me Deklaratën e 2 Korrikut, ato janë preambula e pashkruar e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Le të kujtojmë përherë lavdinë e ideatorëve dhe realizuesve të Referendumit për pavarësi të para 25 vjetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar Profesor!

Falënderojmë të gjitha gjeneratat për punën e jashtëzakonshme që e kanë bërë në lirinë e Kosovës. Lavdi gjithë atyre që nuk janë në mesin tonë!

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Nga seanca e mëparshme, më 22 shtator 2016, kanë qenë të lajmëruar, por për mungesë kohe nuk e kanë marrë fjalën deputetët që unë do t'i lexoj, ndërkohë po e shoh i kemi edhe 15 deputetë tjerë, të cilët janë lajmëruar për sot.

Ndoshta do të ishte më mirë një minutë pauzë, që kryetarët e grupeve parlamentare ta bëjnë një listë të përbashkët, janë deputetët tuaj, në mënyrë që të mos shkojmë në bazë të radhitjes. Në qoftë se shkojmë në bazë të radhitjes, atëherë proceduralisht më duhet t'i lexoj vetëm ata të seancës së kaluar.

Grupet parlamentare çfarë qëndrimi kanë? PDK-ja? A dëshironi të krijoni listë, e cila është optimale, që të na tregoni qëndrimin. Elmi Reçica e ka fjalën. Urdhëro!

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët dhe të pranishmit,

Grupi Parlamentar mendon se kjo është një kohë gjysmë-orëshe në çdo seancë dhe ata që nuk mbërrijnë, ne kemi qëndrim të grupit parlamentar që për sot dihet se kush do të flasë edhe në emër të grupit, edhe si individ. Kështu që unë mendoj që ajo çfarë ka kaluar javën e kaluar ka kaluar, ne s'mund ta zgjasim asnjë pikë të rendit të ditës. Ky është qëndrimi.

KRYETARI: Kush është në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, se unë nuk i kam emrat, nga këta që kanë qenë të lajmëruar. Janë Labinotë Demi-Murtezi, Raif Qela, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Nait Hasani, Hajdar Beqa. Regjia, ju lutem! Sërish fjalën e ka Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Zakonisht ne e dërgojmë me shkrim, nuk e di pse s'ka ardhur sot se kush flet në emër të grupit dhe në këtë pikë, por le ta merr qysh është në rend dite dikush që të flasë.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, cili është qëndrimi? Vetëm të jemi të qartë, i kam diku rreth 25 emra, 15 janë lajmëruar në këtë seancë, 10 në seancën e kaluar. Mendova nëse dëshironi ata të cilët kanë qenë nga seanca e kaluar.

Glauk për korrektësi, urdhëro fjalën, por po e shoh që nuk po duan t'i ndërrojnë.

GLAUK KONJUFCA: Lëvizja "Vetëvendosje" e ka dorëzuar edhe me shkrim rendin e atyre që do të flasin, unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar, pastaj do të flasin Driton Çausi dhe Aida Dërguti. Kështu që kjo mbetet.

KRYETARI: Vetëm kryetar i grupit, lista që ka qenë më herët atëherë bie. Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Ne i kemi dy, Teuta Haxhiu, në emër të grupit, dhe Bali Muharremi që ka qenë në rend prej javës së kaluar.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "Nisma", Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Ne natyrisht se jemi për t'u respektuar Rregullorja dhe në emër të grupit do të flasë Shukrije Bytyqi dhe deputeti Enver Hoti, në rast se i vjen rendi brenda 30-minutëshit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi "6+"? Ok-ej, në rregull është. Atëherë Lista serbe nuk qenka.

Shkojmë në bazë të grupeve parlamentare në radhitje. Labinotë Demi-Murtezi, nga Partia Demokratike e Kosovës, deklarohet në emër të vet apo të grupit.

LABINOTË DEMI MURTEZI: Faleminderit, kryetar!

Flas në emrin tim personal.

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Tashmë dy vjet Qeveria e Republikës së Kosovës e ka pezulluar punën e disa OJQ-ve në qytete të ndryshme të vendit me dyshime për veprimtari dhe nxitje të ekstremizmit të dhunshëm fetar. Pa i specifikuar çështjet konkretisht, të gjitha këto OJQ vazhdojnë të mbeten të pezulluara edhe përkundër transparencës së treguar nga ato.

Kur them transparencë, e kam fjalën specifikisht për OJQ-në “Akeja”, e cila i është drejtuar edhe gjykatës për vlerësim të kësaj situate, sipas tyre, të padrejtë, karshi Ministrisë së Administratës Publike, ngase vendimi për pezullim ka ardhur nga kjo ministri.

E padrejtë sipas këtyre dhe e logjikshme, në përgjithësi për ne, ngase asociacioni për kulturë, edukim dhe arsimim “Akeja” veprimtarinë e vet e ka të rregulluar me ligje dhe rregulloret e vendit në fuqi, ndërkaq veprimtarinë e saj në fusha të ndryshme kulturore e edukative gjithmonë e ka artikulluar nëpërmjet figurave të vendit, e shpeshherë të përcjellë edhe nga ministrat të Qeverisë sonë.

Kuvendi i Kosovës tashmë e ka miratuar Ligjin për parandalimin e pjesëmarrjes së qytetarëve të saj në luftëra dhe konflikte të armatosura. Me këtë ligj dhe mbi këtë bazë tashmë duhet të qartësohen argumentet për fuqizim të dyshimit të ngritur për këto veprimtari, ose tërheqjen nga ai pezullim që po i mban peng OJQ-të, përkatësisht shoqërinë civile.

Vendi ynë dhe asnjë vend tjetër nuk e ka luksin të ofendojë dhe të humbë kuadro të asnjë fushe, por të ofrojë gjithnjë bashkëpunim me individë intelektualë dhe shoqëri civile sa herë që shfaqet nevoja për një veprim konkret ose plan kombëtar.

Tashmë Ministria e Punëve të Brendshme dhe zyrtarët e Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës kanë deklaruar zyrtarisht se gjendja e sigurisë në vend në këtë aspekt është në nivel të lartë.

Andaj, në sensin e vazhdimit të kultivimit të tolerancës së dëshmuar fetare dhe lirive e të drejtave të çdo individ, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare, gjinore e fetare, i ftoj organet e drejtësisë që ta përshpejtojnë punën e tyre dhe t’i bëjnë publike veprimet përkatëse për të gjitha OJQ-të një nga një.

Nuk ka mbetur njëri pa thënë deri më tani se terrorizmi nuk njeh as komb as fe. Prapa kësaj qëndroj unë dhe të gjithë të tjerët, andaj nga organet tona kompetente kërkojmë që të përshpejtohen procedurat për identifikime dhe rezultate konkrete tashmë edhe karshi bazës sonë ligjore të lartpërmendur. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Nuredin Ibishi, flet për grupin.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti nënkryetar,
Zoti kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar përfaqësues diplomatikë,

Përfaqësues të medieve dhe qytetarë,

Numri i madh i armëve ilegale në Kosovë që sipas agjencive të ndryshme ndërkombëtare, por edhe vendore, janë diku mbi 300 mijë, përkundër konfiskimit të vazhdueshëm nga Policia e Kosovës, dhe pasojat e përdorimit të tyre, si dhe trendi i rritjes së aksidentit rrugorë në trafik janë shkaktarë kryesorë të humbjeve të jetës së njerëzve, dëmtimet në shëndet dhe trup, e shumë nga këto raste edhe mbeten me invaliditet të përhershëm.

Gjithashtu, këto aksidente krijojnë shqetësime, jo vetëm në familje, por edhe në shoqëri, në përgjithësi.

Pra, pasojat tjera janë të pallogaritshme, ngase ato kapin, jo vetëm dëme të mëdha materiale të menjëhershme, por edhe shuma të mëdha financiare për mbulimin e nevojave për trajtime të ndryshme shëndetësore që janë në vazhdimësi dhe me afate të pakufizuara.

Si anëtar i grupeve punuese në amendamentimin e dy ligjeve, Ligjit për armë, i hyrë në fuqi në gusht 2015, dhe Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, që ka hyrë në fuqi në këtë vit, me fillimzbatimin e masave para disa ditëve, ku përveç harmonizimit me dispozitat ligjore të ‘acquis communautaire’, ne i kemi ashpërsuar edhe masat ligjore nga institucionet e Ekzekutivit të dispozitave ligjore me qëllimin e vetëm të parandalimit të veprimeve inkriminuese dhe kundërvajtësve të shkelësve, të cilët me frymën e tyre të kundërligjshme sjellin deri te aksidentet me pasoja tragjike.

Lidhur me këtë, Republika e Shqipërisë mund të na shërbejë edhe si model i mirë i zbatimit praktik të këtyre dy ligjeve.

Nëse i referohemi praktikës së institucioneve kompetente të zbatimit të Ligjit për armë në Shqipëri, si shembull mund të merret rasti kur një person zihet në posedim legal të armës, të njëjtit në formë të prerë i zbatohet masa e arrestit nga policia dhe pas mbajtjes policore të procedimit në prokurori, në procedurë të shkurtër i caktohet edhe paraburgimi deri në shqiptimin e masave të vendimit në gjykatë me burgim të detyrueshëm ligjor.

Në Kosovë, edhe pse me Kodin Penal dhe Ligjin e ri për kundërvajtje janë të përcaktuara veprat nga kjo fushë, në shumicën e rasteve nuk zbatohen procedurat dhe masat e parapara ligjore dhe me këtë është krijuar edhe një praktikë e keqe e pandëshkueshmërisë së kryesve kjo gjendje e ka sjell dukurinë që shumë persona të mbajnë dhe të bartin ilegalisht armë, por edhe t’i përdorin ato.

Në rastin tjetër të zbatimit të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor në Shqipëri, për shkak të trendit rriten aksidentet e trafikut rrugor dhe në veçanti me pasoja të fatalitetit-vdekjes, është propozim i ri i organit kompetent - Ministrisë së Punëve të Brendshme - që në Kodin Penal të shtohet edhe vepra penale “vrasje në trafik” për shkaktarin e aksidentit.

Këtë praktikë e kanë edhe disa vende të Bashkimit Evropian. Prandaj, duhet edhe ne ta plotësojmë Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Praktikë e keqe e krijuar në Kosovë është se shkaktarët e këtyre aksidenteve me pasoja të fatalitetit llogariten thjesht si një fatkeqësi trafiku pa qëllim, por që në esencë përmban në vete

veprime të vetëdijshme të sjelljes dhe veprimeve, pra shkelje të rregullave të trafikut nga pasoja e shpejtësisë, ngasjes së automjeteve në gjendje dhe në ndikim të alkoolit dhe në ndikim të substancave të tjera dhe krejt kjo shpie deri te ideja e një mentaliteti të krijuar mbrapsht në opinionin kosovar që shkon përtej Kanunit të Lekë Dukagjinit me propozim të pajtimit se shkaktari i aksidentit duhet të falet, ngase thjeshtë është një aksident trafiku dhe se kryesi nuk ka pasur qëllim të caktuar ndaj viktimës së rastit.

Edhe gjykatat e kanë krijuar një praktikë të keqe, kur gjatë trajtimeve gjyqësore të këtyre lëndëve si rrethanë lehtësuese e marrin gjendjen e pajtimit me familjen e viktimës.

Në aksidente të trafikut, si në Kosovë, po ashtu edhe në Shqipëri, nuk pësojnë vetëm pjesëmarrësit direkt në trafik dhe këmbësorët, por edhe zyrtarët policorë që e mbikëqyrin dhe e rregullojnë trafikun rrugor. Shembull, në Kosovë, kur në autostradën “Ibrahim Rugova”, nga një shofer i papërgjegjshëm, me veprimin e tejkalimit të shpejtësisë, është aksidentuar polici i trafikut rrugor me pasoja të rënda trupore. Ndërsa në Shqipëri mbytet zyrtari policor në krye të detyrës nga një recidivist i tejkalimit të shpejtësive me aksidente rrugore.

Ashpërsimi i këtyre masave në Kosovë në fillim të zbatimit të Ligjit të ri për trafikun po i jep rezultatet e para. Janë zvogëluar dukshëm aksidentet në trafik dhe si indikator janë raportet edhe nga qytetarët, por edhe raportet policore dhe raportet e qendrave të emergjencave mjekësore.

Po ashtu, edhe bashkësia, shkolla, shoqëria civile, si dhe institucionet kompetente në nivel qendror dhe lokal duhet të ndërmarrin masa sensibilizuese me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, si në parandalim, po ashtu edhe në masat reaguese në rastet e trendëve në rritje të këtyre dukurive.

Lidhur me këtë mendoj se duhet të ketë një konsistencë nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik me qëllim parësor të parandalimit dhe ndërmarrjes së masave ndëshkuese për shkelësit.

E njëjta duhet të jetë edhe lidhur me zbatimin e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit. Kryetari i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, në emër të Grupit, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të Kuvendit,

Kisha ortodokse serbe, bashkë me Akademinë e Shkencave dhe me ushtrinë e Milosheviqit kanë qenë trinomi i prodhimit dhe ekzekutimit të doktrinës së supremacisë dhe të hegjemonizmit serb.

Kjo doktrinë kulmoi gjatë periudhës së Milosheviqit dhe shkaktoi gjenocid në veçanti ndaj shqiptarëve dhe ndaj boshnjakëve. Kisha ortodokse serbe kishte rol të jashtëzakonshëm në indoktrinimin dhe mobilizimin e popullit serb në luftë për vrasjen e popujve të tjerë. Me sytë e mi e kam parë një dokument shumë të rëndësishëm, të cilin e posedon Shukri Aliu. Shukri Aliu ka qenë edhe dëshmitar në Gjyqin e Hagës dhe ky dokument është thirrje zyrtare, pra dokumenti

është origjinal, po flas për dokument origjinal, është thirrje zyrtare që Kisha ortodokse serbe ua bënte për mobilizim në luftë të gjithë të rinjve dhe meshkujve të moshës madhore dhe nuk është kështu thirrje për mobilizim të përgjithshëm, po është thirrje me emër dhe mbiemër që i drejtohet njeriut personalisht dhe e fton të shkojë në luftë.

Do të ishte mirë që ky dokument të botohej, sepse e gjithë bota mbarë do ta shihte më mirë se me çfarë kishe kemi të bëjmë. Pra, një kishë e cila jo vetëm që drejtpërdrejt duhet të mbajë përgjegjësi për atë që ka ndodhur në Ballkan, por që kësaj ligësie çnjerëzore që ka ndodhur ia dha përmasën hyjnore të shenjtërisë dhe kurrë nuk denjoi asnjëherë të vetme ta thotë qoftë edhe një deklaratë pendese a distancimi për këto vepra makabre që natyrisht ia mbajnë duart e lyera me gjak.

Një prej veprave ogurzeza të doktrinës gjenocidale të Serbisë ishte edhe përpjekja për ndërtimin e një kishe në oborrin e Universitetit të Prishtinës. Më 27 janar të vitit 1999 këtij objekti ia vendosën madje edhe kryqin në maje. Pas dhjetëra e dhjetëra masakrave nëpër Kosovë që po i kryente ushtria, policia dhe grupe paramilitare të Serbisë, duke filluar nga Qirezi e Likoshani, te Prekazi e Abria dhe vetëm 12 ditë pas masakrës së Reçakut Serbia në Kosovë po i festonte këto akte gjakatare përmes ndërtimit të një kishe politike dhe ku po e ndërtonte se?! Në mes të Universitetit të Prishtinës. Për Serbinë, Universiteti i Prishtinës gjithnjë është parë si një lloj qerthulli i rezistencës kombëtare shqiptare kundër pushtimit serb. Me kaq popullatë sa kishin ata në Kosovë dhe pas dëbimit të tërësishëm të shqiptarëve nga universiteti, një oborr i tillë kaq i madh i universitetit ishte i panevojshëm për Serbinë, prandaj vendosën ta serbizonin komplet këtë pjesë, fillimisht përmes ndërtimit të një kishe politike aty.

Kurse, sot Aleksandër Vuçiçi po dëshiron ta vazhdojë punën aty ku e ka lënë Milosheviqi më 27 janar të vitit 1999. Prandaj, deklarata e presidentit Hashim Thaçi për mbrojtjen e kësaj vepre monstruoze të regjimit të Milosheviqit është më shumë se neveritëse. Është e mjerueshme se si nga frika se mos po përfundon në kthetrat e Gjykatës Speciale, njeriu i gjorë është në gjendje të përkulet edhe përpara pllakave të “terrorit shqiptar”, e t’u dalë në mbrojtje kishave të Milosheviqit.

Ah, sikur ta mbronte kështu edhe veriun e Kosovës, Kullën dhe Çakorrin, apo lapidarin e rrëzuar nga Serbia të UÇK-së në Preshevë, sa më ndryshe do t’i kishim punët!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kam dalë sot këtu për të ngritur një çështje, mendoj shumë serioze për funksionimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës nxjerr rezoluta, rekomandime dhe akte të tjera. Një shqetësim imi dhe i grupit tonë parlamentar është se këto rezoluta dhe këto akte a janë të obliguara për

Qeverinë e Republikës së Kosovës? Kosova është shpallur republikë parlamentare, kurse sot kjo është shndërruar në qeveritare.

Atëherë, meqë nuk kisha kujt t'ia drejtoj pyetjen, se rezolutat që po i nxjerrim në Kuvend, e që janë një numër shumë i madh prej tyre, unë nuk do t'ju lodh me secilën prej tyre, por po i përmend disa: janë nxjerrë rezoluta në Kuvendin e Republikës së Kosovës për çështjen e të pagjeturve. I kemi mashtruar ata familjarë, i kemi mashtruar, po them, në qoftë se këto rezoluta nuk janë obligim për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Kemi nxjerrë shumë rezoluta të tjera, për çështje edhe të demarkacionit me Malin e Zi, edhe për çështjet e migrimit të qindra-mijëra qytetarëve që kanë dalë nga Republika e Kosovës edhe për shumë e shumë çështje të tjera.

Atëherë, ju lutem, çka është obligim për Qeverinë e Republikës së Kosovës? Sot në rend dite se i kemi edhe dy interpelanca: një për kodin telefonik që ka qenë interpelancë edhe disa vjet më parë e legjislaturës së kaluar. Sot kemi edhe një interpelancë tjetër për çështjen e shqiptarëve në pjesën veriore të Mitrovicës. Pse po diskutojmë ne? Çka po bëjmë ne në fund të Kuvendit? Kur rezolutat nxirren në bashkëpunim me të gjitha grupet parlamentare, ne jemi deputetë të zgjedhur nga qytetari, ne jemi përfaqësues të popullit të Republikës së Kosovës, atëherë a po i mashtrojmë ata qytetarë ne me ato debate, orë të tëra këtu në Kuvendin e Kosovës? Po nxjerrim një rezolutë dhe, në anën tjetër, thuhet nuk është obligim për Qeverinë.

Në Komisionin për të Drejtat e Njeriut e kam ngritur këtë çështje disa herë, sepse më 3 gusht, në Ditën e të pagjeturve, është diskutuar pra në atë tryezë se rezolutat nuk janë obligim. Unë them që një prej rezolutave për çështje të pagjeturve e obligojnë Qeverinë e Republikës së Kosovës që t'i kushtëzojë bisedimet me Serbinë deri në fatin e gjetjes së të fundit të pagjetur në Kosovë.

Nëse këto nuk janë obligime për Qeverinë, unë kam kërkuar edhe një interpretim nga Zyra Ligjore e Kuvendit, nuk është kthyer asnjëherë, interpretim me shkrim. Prandaj, edhe njëherë këtu Kryesisë së Kuvendit, deputetëve, ju bëj thirrje a janë obligim apo nuk janë?

Nëse nuk janë, atëherë ne si deputetë çka po bëjmë? Pse po i nxjerrim ato rekomandime? Pse po diskutojmë me orë të tëra? A sa për të dalë në media? Sinqerisht ky është shqetësim për të gjithë neve, të mos i mashtrojmë qytetarët, duke tentuar për të thënë se po bëjmë diçka për ta, përderisa këto dokumente që nxjerr organi më i lartë legjislativ në vend nuk janë obligim për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Atëherë, faktikisht është e vërtetë ajo që Qeveria e Republikës së Kosovës po e monitoron Kuvendin, e jo që do të duhej të ndodhte e kundërta. Andaj, unë kërkoj një përgjigje, thashë nuk kam gjetur hapësirë kujt t'ia drejtoj këtë pyetje. Prandaj, Kryesia e Kuvendit le të vendosë, le ta rregullojë këtë çështje dhe të mos bëhemi kinse po punojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të "Nismës për Kosovën", deputetja Shukrije Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot fjalimin tim do ta ndaj në dy pjesë: fillimisht do ta filloj me deklaratat fyese të kryeministrit Isa Mustafa ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Tanimë është dëshmuar se qeveritarëve tanë, qytetarët ju duhen vetëm në kohë fushate që t'i mashtrojnë me premtime marramendëse e t'i manipulojnë derisa të marrin votën e tyre, e mandej t'i fyejnë e t'i shajnë pa pikë ndërgjegjeje.

Ju e dini se një ndër zonat më të prekura prej etheve hemorragjike është komuna e Malishevës, ku si pasojë e neglizhencës së institucioneve të Republikës së Kosovës kemi pasur 18 viktima, e që shumë pak është marrë Qeveria e Republikës së Kosovës me at çështje. Falë Zotit dhe angazhimit të qeverisjeve lokale viteve të fundit ne nuk kemi pasur viktima, andaj unë kërkoj nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, që t'iu drejtohet qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe veçanërisht qytetarëve të Malishevës dhe t'ju kërkojë falje për fyerjen që u ka bërë.

Unë dua t'i tregoj kryeministrit Isa Mustafa dhe ish-kryeministrit se Malisheva nuk është vendi i zagarrëve dhe i rriqrave, por është vend që vetëm gjatë luftës së fundit ka dhënë 74 dëshmorë, afër 320 martirë, ka ende mbi 40 të zhdukur dhe ka qenë strehimore e qindra-mijëra qytetarëve të Republikës së Kosovës anembanë.

Unë i ftoj të gjitha subjektet opozitare, shoqërinë civile dhe të gjithë që të bëhen më aktivë në deklaratat e tyre kundër kësaj Qeverie të keqe, sepse sa më shpejt që shkon Isa Mustafa dhe Qeveria e tij, shpëton Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj.

Ndërsa, pjesën e dytë do t'ia kushtoj fillimit me vonesë të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë s'ka gjetur as një minutë kohë që të kërkojë falje për shtyrjen dhe vonesën e arsimit në Republikën e Kosovës. Fëmijët që mezi kanë pritur të fillojnë mësimin dhe të ulen në bankat shkollore, ende ndoshta edhe sot, kur ne po flasim nuk janë pajisur anembanë Kosovës me libra dhe atë për çfarë arsye, për arsye banale: mungesë të buxhetit!

Mungesa e librave për t'u shkolluar gjeneratat e ardhshme është sfidë, të cilën qytetarët dhe fëmijët tanë po e vuajnë për nga mospërfillja dhe mosstandardizimi i ndërtimeve të objekteve shkollore. Ministri i Arsimit, Shkencave dhe Teknologjisë tani kohët e fundit ka aktualizuar një çështje për testim të mësimdhënësve që unë mendoj që ne kemi shumë punë të tjera të bëjmë në ngritjen e cilësisë dhe aftësimin profesionist të nxënësve, e jo të merren me testimet e mësimdhënësve.

Kosova tani e sa vite po vuan nga shkolla profesionale, duke u dublikuar institucionet, siç e kemi Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional, ku edhe nxit konflikte në "x" komuna, ku mësimdhënësit i heq prej punës dhe i çon në punë përderisa institucionet nuk kanë nevojë për ato konkurse. E dimë se puna praktike për nxënësit e shkollave profesionale është mungesë, edhe kjo më tepër ndaj qeverisjes së kësaj qeverie duke falimentuar edhe gjigantet më të mëdhenj, siç është "Ferronikeli", ku duke lënë mbi 1000 punëtorë në rrugë dhe tanimë nxënësit e atij lëmi nuk kanë as ku ta bëjnë praktikën.

Ju, qeveri, keni premtuar hapje të vendeve të reja të punës, domethënë dy partitë që jeni në qeverisje dhe tash nëse ju keni dështuar, është mirë të mos dështojnë gjeneratat e së ardhmes. Ministri i Arsimit e ka plot gojën cilësinë në arsim, po unë nuk e di çfarë cilësie do të presim kur administrata është e stërngarkuar me njerëz joprofesionistë, duke transferuar edhe nga Akademia Policore, e duke emëruar si ushtrues detyre dhe udhëheqës në divizionin e arsimit privat.

Ju ministër, keni emëruar zyrtarë të lartë në arsimin e mesëm punëtorë me Bachelor dhe ata persona i dërgoni që të zgjedhin drejtorë në “x” komuna, përderisa konkursi për drejtorë në shkolla është të jetë me Master.

Nuk e di se si do ta intervistojë një punonjëse e Bachelorit, edhe atë me një kualifikim në kolegjet private, një master për drejtor. Prandaj, ministër, kërkojmë nga ju që të merreni seriozisht me arsimin dhe investimet në arsim, me krijimin e kushteve për gjeneratat e ardhshme që t’i përgatitni për shkencë dhe treg të punës.

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë nevojë për një qeverisje të përgjegjshme, kompetente që arsimit në Republikën e Kosovës të jetë prioritet në vepra konkrete dhe jo në konferenca shtypi dhe në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

I nderuar zëvendëskryetar i Kuvendit,

Kolegë dhe kolege,

Pjesëtarë të Qeverisë, kryeministër, zëvendëskryeministër dhe pjesëtarë të Qeverisë së Kosovës.

Dola këtu për të vazhduar diskutimin e koleges sime Teuta Haxhiu. Zbatimi i rezolutave, të cilat nxirren unanimisht, kjo ishte tema ime, rezolutat dhe zbatimi i tyre nuk po shkon si duhet. Prandaj sikur humbin efektet e nxjerrjes së rezolutave dhe pikërisht të ngre çështjen, të cilën e kam nisur para disa muajsh: nxjerrjen e rezolutës për gjenocidin.

E them këtë, sepse nuk e kam ngritur deri tash... Nënshkrimet për këtë rezolutë janë dorëzuar te kryetari i Kuvendit, por meqenëse në mbledhje në Kuvend mungonin nënshkruesit e kësaj rezolute, tani janë këtu, kërkoj nga Kryesia e Kuvendit që të riaktualizohen këto nënshkrime dhe në momentin e caktuar, kur të gjithë jemi, sikur është sot, të aktualizohet nxjerrja e rezolutës për gjenocidin. Mendoj që kjo na duhet patjetër, sepse nuk ka kuptim pa këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Veton Berisha. S’është deputeti Veton Berisha. Deputeti Driton Çausi e ka fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të pranishëm,

Kanë kaluar tanimë mbi 3 muaj që kur fermerët e Republikës së Kosovës po përballen me një krizë serioze, e cila ka për shkak një sëmundje infektive, pra sëmundjen gungore të lëkurës, por mbi të gjitha e ka për shkak papërgjegjësinë dhe dështimin e plotë të institucioneve, që do të duhej të ishin përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e kësaj sëmundjeje.

Derisa në të gjitha vendet fqinje ka mbi tre muaj, në fillim të qershorit pra, që vaksinimi ka filluar dhe vazhdon edhe më tutje, në Republikën e Kosovës kaluan tre muaj vonesë në vaksinimin e kafshëve, që solli një përhapje të kësaj sëmundjeje në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe humbje të pariparueshme për fermerët, të cilët një shumicë e tyre, e sigurojnë edhe mbijetesën nga aktiviteti blegtoral.

Përveç kësaj, dëshmuam të gjithë edhe dështimin e plotë në marrjen e masave në kontrollin e kësaj sëmundjeje, që nënkuptonte eutanazinë dhe asgjësimin e kafshëve të infektuara, kujtoj kafshët e infektuara vazhdojnë të jenë në stalla dhe janë burim i vazhdueshëm i infeksionit, kurse ato të ngordhurat u hodhën në deponi të thjeshta të mbeturinave, duke qenë sërish burim i infeksionit.

Për kompensimin që do të duhej të pasonte pas asgjësimit të kafshëve të infektuara as që bëhet fjalë dhe kjo nuk është hera e parë që ndodh kështu, ka mbi dy vite që nga shpërthimi i sëmundjes së “blu tangut”, fermerët kosovarë nuk janë kompensuar ende për humbjet e mijëra kafshëve. Në të njëjtën kohë, derisa fermerët detyroheshin të merrnin në mënyrë ilegale vaksinat nga shtetet fqinje, kishim ekipe mobile nga Serbia që merreshin me vaksinimin e gjedhëve të fermerëve serb në lokalitetet serbe në Kosovë.

Pra, si është e mundur gjithë kjo dhe çfarë ndërmorën gjatë gjithë kësaj kohe institucionet që do të duhej të ishin përgjegjëse për menaxhimin e kësaj situatë?

Natyrisht, se nuk ka si të ndodhë ndryshe, kur e kemi një institucion si Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, i cili udhëhiqet nga militantë të PDK-së dhe ku ekzistojnë punëtorë dhe profesionistë të mirëfilltë, të cilët shpërfillen vazhdimisht dhe ku rrjedhimisht gabimet e tyre gjatë viteve kanë pasojë enorme ekonomike në shëndetin e kafshëve dhe në shëndetin publik.

Besoj se të gjithë janë të informuar që sëmundja e brucelozës është e pranishme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zotëri, të kaloi koha. Faleminderit! Jo, s’lejohej, as ty as kurrkujt. Pse ty? I fundit që i ka 3 minuta, Shqip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Janë shumë tema në publik duke u shtjelluar sot në Republikën e Kosovës, por njëra ndër temat të cilat sot më shtyjnë që të prononcohem është tema e banorëve, të cilët janë në Lagjen e Dardanisë, e të cilët u përzonë nga ato hyrje e me të cilët u solidarizuan të gjitha partitë politike, por asnjëra nuk dha asnjë zgjidhje praktike.

Edhe unë po solidarizohem me problemet e tyre, por po mundohem që të jap një mendim që mund të jetë i dobishëm dhe i vlerësuar për të gjitha palët dhe po ashtu, Qeveria e Kosovës dhe institucionet komunale mund të jenë nivel të detyrës.

Është padyshim që çdo uzurpim ose thënë ndryshe, ata banorë kanë qenë në vitin '99 uzurpatorë të zorit dhe kanë mbetur aty, mirëpo nuk është bërë një qasje se si t'u zgjidhet problemi rasteve të cilat janë vërtet sociale.

Qeveria e Kosovës mund të sjellë një ligj bashkërisht me komunën dhe së bashku me ndërmjetësuesit e bankave të hyjnë në garanci bankare të blerjes së atyre hyrjeve, të cilat mund të jenë në pronësi të bankës dhe të garantuesit të Parlamentit këtu nga ne deputetët dhe në rast se ata kanë aftësi të blerjes edhe palët, të cilat pretendojnë se janë pronarë, mund t'i marrin të gjitha financimet. Ndërsa, ata që do t'i shfrytëzojnë do të rrinin në ato banesa për një kohë, siç vepron sistemi bankar me formën e kredisë.

Prandaj, për të dashur me nxjerrë nga mediet edhe në kohë që po ofrohet dimri, nuk është problem vetëm Dardania. Janë, sa kam unë dijeni, edhe disa hyrje të tjera të tilla. Do të ishte mirë që të mos lejohet të procedohen si probleme në medie, por si preventivë t'i paraprijmë çështjes që vërtet kërkon një zgjedhje të problemit. Procedura do të ishte shumë e lehtë, bankat vendore ose Banka Qendrore së bashku me Komunën si propozues dhe Parlamenti së bashku me Qeverinë të hyjnë garantues tek bankat dhe të hyjnë në pronësi me bankat për ato hyrje dhe ata t'i shfrytëzojnë ndërsa pronarëve t'u paguhet, atyre që pretendojnë se janë pronarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjatë 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 33 pyetje parlamentare. Fjalën e merr deputeti Raif Qela, që ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

RAIF QELA: Faleminderit, kryesues!

Zoti kryeministër,

Para nja 20 muajsh, ky Kuvend, por edhe Qeveria, ka qenë në siklet të madh duke e shqyrtuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me qëllim që të pengohet që "Trepça" të shkojë në qorr-sokak. Po këtë situatë e kemi edhe tani. Ligji për "Trepçën" akoma nuk është nxjerrë, prandaj lidhur me këtë unë e kam këtë pyetje për ju.

Jeni zotuar se do ta procedoni në Kuvend në afatin e paraparë Ligjin mbi "Trepçën", këtë zotim nuk e keni përmbushur akoma. Kur do ta procedoni në Kuvend Ligjin për "Trepçën"? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër Mustafa, urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Ju e dini se në fillim të vitit të kaluar ne kemi ardhur në një situatë mjaft të rëndë sa i përket kompleksit “Trepça” dhe në qoftë se e përkufizojmë si Kombinatin “Trepça”, sepse ka qenë një vendim që “Trepça” të shkojë në likuidim.

Ne kemi marrë atëherë masa të shpejta dhe e kemi shpëtuar “Trepçën” nga likuidimi edhe përkundër asaj se nuk ka pasur qëndrim korrekt nga të gjithë deputetët sa i përket kësaj çështjeje.

Ne kemi proceduar më vonë me të gjitha aktivitetet lidhur me gjetjen e zgjidhjes për “Trepçën”, në Qeveri kemi themeluar një komision për hartimin e Ligjit për “Trepçën”. Ky komision është i përbërë nga ekspertë nga Akademia e Shkencave, nga Universiteti, nga punonjësit dhe menaxhmenti i “Trepçës” dhe ekspertë të tjerë, që merren me këtë fushë. Ligji është përgatitur, si i tillë është konsultuar me grupe të ndryshme të interesit, është konsultuar dhe po konsultohet edhe më tutje edhe me faktorin ndërkombëtar dhe ligji do të procedohet në Kuvend, në mënyrë që ne t’i arrijmë të gjitha afatet e domosdoshme, që ligji të aprovohet dhe të nënshkruhet në afatet të cilat nuk e rrezikojnë në asnjë moment “Trepçën”. A do të jetë kjo java e ardhshme apo dhjetë ditë e ardhshme, është çështje tjetër, por ligjin do ta prezantojmë në Kuvend dhe do të arrijmë të gjitha afatet, që ligji të aprovohet.

Përpos ligjit unë mund të ju informoj se AKP-ja ka nënshkruar marrëveshjen për studimin e fizibilitetit për “Trepçën”, ka pasur një stërzgjatje të këtyre procedurave për shkak të ankesave të cilat janë bërë dhe po ashtu, ky Kuvend dhe Komisioni për Ekonomi i këtij Kuvendi ka zhvilluar aktivitete lidhur me pesë studime të rastit, të cilat janë porositur nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, nga të cilat kemi marrë përvojat lidhur me organizimin e komplekseve të ngjashme si “Trepça”, në mënyrë që ato t’i shfrytëzojmë si modalitete për Ligjin për “Trepçën” dhe të përfundojë. Ligji për “Trepçën” do të vijë në Kuvend dhe do të aprovohet në afatin që nuk e rrezikon fare “Trepçën” në të ardhmen.

Ligji është hartuar dhe do të jetë në harmoni me interesat e Republikës së Kosovës dhe me interesat e punonjësve të “Trepçës”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, kryeministër! Zoti deputet Qela, ke pyetje shtesë?

RAIF QELA: A do të thotë kjo se më 2 nëntor do të jetë në fuqi Ligji për “Trepçën”?

KRYESUESI: Kryeministri!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Po, do të jetë në fuqi më 2 nëntor, prandaj ne edhe jemi konsultuar edhe me kryetarin e Kuvendit dhe me sekretari dhe e kemi studiuar tërë agjendën, në mënyrë që të mos rrezikojmë që me 2 nëntor Ligji për “Trepçën” të mos jetë i nënshkruar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Salih Salihu ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje kolegë!

Para disa ditësh Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor me kërkesën e banorëve e vizitoi Hade për t'u njoftuar më mirë për problemet dhe vështirësitë, që kanë këta banorë për të jetuar në këtë fshat, si pasojë e veprimeve të KEK-ut, për të mihur sipërfaqet e tokës së tyre, për eksploatimin e thëngjillit.

Pluhuri, zhurma e makinave të rënda, mungesa e rrugëve, e kanalizimit, por edhe rreziku për të rrëshqitur komplet fshati Hade në gropën e mihjes e bëjnë të pamundur jetën e banorëve të mbetur në atë fshat, të cilëve në fillim, sipas planit strategjik të zhvillimit të punëve, ky fshat është dashur komplet të zhvendoset në Lagjen e Re në Shkabaj, por kjo gjë nuk po ndodh për shkak të devijimit të planit nga KEK-u, gjegjësisht nga Qeveria.

Zoti kryeministër,

A e keni vizituar ju ndonjëherë fshatin Hade dhe fshatrat tjera përreth, aty ku eksploatohet thëngjilli, për të parë se në çfarë kushte mizore jetojnë këta banorë të komunës së Obiliqit dhe, nëse jeni marrë me këtë problematikë, kur mendoni t'i zhvendosni banorët e mbetur në këtë fshat? Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryeministri Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Më 19 shtator kam informatë se përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kanë qenë pjesë e delegacionit të Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, i cili e ka bërë vizitën në fshatin Hade të Komunës së Obiliqit.

Qeveria e Republikës së Kosovës më datën 3 nëntor të vitit 2004 ka nxjerrë vendimin nr. 4/119, me të cilin vendim fshatrat Siboc, Hade, Lajthishtë, Palaj, shpallen zona me interes të veçantë ekonomik. Konform këtij vendimi dhe raportit nga Departamenti për Miniera dhe Minerale, Qeveria e Republikës së Kosovës ka obliguar Ministrinë e Mjedisit që për shkaqe të sigurisë të evakujë një pjesë të fshatit Hade, të cilësuar si zonë e rrezikshmërisë.

Ministria e Mjedisit në fillim të vitit 2005 ka zhvendosur banorët nga zona e rrezikshmërisë dhe konform Ligjit për shpronësim, i cili ka qenë në fuqi në vitin 2005, ka realizuar procesin e shpronësimit dhe kompensimit të pronave të banorëve nga zona e rrezikshmërisë. Me kërkesën e kësaj zone, komuna ka ndarë lokacion Hadja e Re, në fshatin Shkabaj, për vendosjen e këtyre banorëve, ndërsa në qendër të Obiliqit, sipas kërkesës së banorëve, Qeveria ka ndërtuar objektin banesor kolektiv dhe afarist me 80 njësi banesore dhe 24 lokale afariste.

Ndërtimi i objektit banesor dhe lokacionit Hade e Re në Shkabaj është bërë sipas kërkesës së banorëve për formën dhe mënyrën e kompensimit të pronës. Disa nga banorët kanë kërkuar kompensim financiar, disa njësi banesore, disa të tjerë truall në lokacionin e ri për ndërtimin e shtëpisë.

Gjatë tërë kësaj periudhe kohore, prej evakuimit e deri te ndërtimi i objekteve banesore në lokacionin Hade e Re në Shkabaj, Ministria e Mjedisit ua ka paguar banorëve të evakuuar kompensimin e qirasë dhe ushqimit.

Pasi evitimi i rrezikshmërisë së zhvendosjes së banorëve nga fshati Hade është bërë konform planit dinamik për zgjerimin e mihjes së KEK-ut dhe sipas këtij plani dhe kërkesës së KEK-ut në vitin 2010 Ministria, në bashkëpunim me KEK-un, ka zhvendosur një pjesë të banorëve të lagjes Shala të fshatit Hade, ku kompensimi i pronave është realizuar nga KEK-u dhe Ministria e Mjedisit vetëm ka ndihmuar, ka këshilluar dhe monitoruar procesin e zhvendosjes.

Ministria e Mjedisit ka udhëhequr të gjitha procedurat për rregullimin, bartjen e pronës, planin rregullativ dhe ndërtimin e infrastrukturës në lokacionin Hade e Re në Shkabaj, i cili posedon afro 800 parcela nga 7,5 deri në 3 arë, parcelizimin e rrugëve, kanalizimin, ujësjellësin, elektriken, e të tjera.

KEK-u në vitin 2013 ka paraqitur kërkesë për zhvendosjen e banorëve dhe ekonomive familjare nga fshati Shipitullë për nevojat e zgjerimit të mihjes, sipas planit dinamik të Ministrisë dhe ka udhëzuar që zhvendosja e ekonomive familjare nga zona e interesit të bëhet konform dokumentit - Korniza e politikave për zhvendosje për zonën Fusha e Mihjes së re në Republikën e Kosovës, e miratuar me vendim të Qeverisë së Kosovës nr. 10/22, datë 6 korrik 2011, ku KEK-u kryen zhvendosjen, vlerësimin e kompensimin, ndërsa Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për monitorimin e këtij procesi.

Do të thotë, kjo është informata dhe pasqyrim i gjendjes, të cilën e kam marrë nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.

Për çdo çështje tjetër, për të cilën jeni të interesuar, unë mund të kërkoj informatë tjetër, në mënyrë që të plotësoj këtë, t'i përgjigjem në mënyrë shprehimore edhe pyetjes tuaj se a kam qenë atje? Unë nuk kam qenë atje të vizitoj, por kanë shkuar përgjegjësit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mirëpo mund t'ju them se tani kemi telashe edhe me zhvendosjen e banorëve të fshatit Shipitullë, sepse mihja është ofruar shumë afër shtëpive, ndërkaq sipas kritereve të Bankës Botërore, e cila kërkon që me këtë rast të zbatohet Korniza e politikave për zhvendosje dhe jo vetëm procedurat e shpronësimit, të cilat ne i kemi zbatuar në raste të tjera.

Prandaj, duhet të gjejmë mirëkuptim me këta banorë për zhvendosjen e tyre dhe të bëjmë zhvendosjen e sigurt, e cila ndërlidhet po ashtu edhe me Projektin e Kosovës së Re, sepse përvojat nga zhvendosja që i kemi, në këtë rast edhe te Hadja dhe Shipitulla, do të jenë përvoja, të cilat ne duhet t'i zbatojmë edhe në raste të tilla kur kemi të bëjmë te Kosova e Re. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputet Salihu, a ke pyetje shtesë?

SALIH SALIHU: Fillimisht, zoti kryeministër, në bazë të fjalëve të banorëve, përfaqësuesve të fshatit, ju e dini se ka qenë një marrëveshje që komplet fshati Hade të shpërngulet prej aty dhe më vonë KEK-u, sigurisht edhe me pajtimin tuaj si Qeveri, e keni devijuar planin për arsye të panjohura dhe i keni larguar vetëm nga lagjja Shala, ndërkaq, rrugës përpjetë, ku është lagjja Grajçevci, mandej lagjja Mirena, kanë mbetur në fshat.

Pse e keni devijuar planin, banorët po pyesin? Ata thonë gjithçka, por arsyet nuk po i dinë të sakta dhe, zoti kryeministër, është mirë të shkoni ta vizitoni këtë fshat, sepse gjendja kështu e

banorëve është shumë e rëndë, ndotja e mjedisit të ambientit është tepër e madhe. Dhe, sipas disa të dhënave nga kryetari i Komunës së Obiliqit, thotë se rregullatorët tregojnë se ndotja e ambientit tejkalon diku për 30-fish parametrat e standardeve të lejuara për kushtet e ambientit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Mund të them se nuk kam informata se është devijuar plani, mirëpo unë do t'i kërkoj këto informata dhe do t'ju prezantoj në Kuvend në qoftë se kanë ndodhur dhe cilat kanë qenë arsyet e devijimit të planit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Time Kadrijaj! Nuk është këtu. Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Nimet Rrahmani!

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues,
I nderuar ministër,

Unë këtë pyetje e kam parashtruar në seancën e kaluar, por ju nuk ishit prezent. Ka të bëjë me mosfunksionimin e odave të profesionistëve shëndetësorë, përkatësisht me moszbatimin e Ligjit të odave nga Ministria e Shëndetësisë.

Javën e kaluar, ne në Komision, me kërkesën e kryetarëve të 5 odave, e kemi pasur një takim me ta në Komisionin e Shëndetësisë dhe shqetësim i të gjithë kryetarëve të të gjitha odave, nëse i përmbledhim shqetësimet apo brengat e tyre me një fjali të vetme, emërues i përbashkët i të gjitha këtyre problemeve është Ministria e Shëndetësisë, gjegjësisht, siç thanë ata, ministri, i cili nuk e zbaton Ligjin e odave të profesionistëve shëndetësorë.

Ne dje në Komision e patëm edhe ministrin, pra ishit edhe ju prezent, dhe versionin e cilin ju e treguat në Komision ishte i kundërt me atë që e dëgjuam, siç thashë, nga kryetarët e odave.

Pyetja ime konkrete është:

- Ministër, edhe sa do të vazhdoni të shkëlqeni Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, meqë sipas këtij ligji, po e citoj nenin 59, pika 6: “Odat e profesionistëve shëndetësorë do të fillojnë së funksionuari në afat prej 4 muajsh, nga dita e miratimit të këtij ligji”.
Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Rrahmani e ka fjalën.

MINISTRI NIMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete, ne dje i shterëm të gjitha debatet rreth kësaj pyetjeje dhe jo që deklaruaam të kundërtën, por argumentuam krejtësisht të kundërtën me një mori argumente e dokumente, të

cilat i kemi dorëzuar në Komisionin parlamentar dhe nuk besoj se keni arritur dje t'i shihni të gjitha dhe shpresoj se ditët në vijim do të bindeni që ajo çka kemi deklaruar dje ka qenë e vërtetë.

Ne jo vetëm që do të vazhdojmë ta shtyjmë ligjin, por nuk mund të vazhdohet diçka çka nuk është duke ndodhur, sepse ne jemi duke u kujdesur që me përkushtimin dhe kujdesin më të madh ta implementojmë Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë, për të cilin u dakorduam të gjithë dje se është një ligj shumë i avancuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete, a keni pyetje shtesë?

BESA BAFTIJA: Është e vërtetë kjo që e tha ministri se dje u dakorduam që ky ligj të fillojë së implementuari prej 1 janarit 2017, ashtu edhe është zotuar ministri, sepse unë si anëtare e komisionit kërkoja që të kemi një debat publik fillimisht, duke pasur parasysh kundërthëniet e mëdha që ishin në mes të të dhënave që i morëm prej kryetarëve të odave apo edhe të dhënave që na i dha ministri.

Nuk kemi arritur ta analizojmë materialin në tërësi, por me siguri ne si komision do ta analizojmë atë material që e kemi dorëzuar, kështu që mbetet ajo që u tha dje, të shohim se a po implementohet apo do të barten të gjitha kompetencat të kryetarët e odave, ashtu sikur që i parasheh Ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo s'ishte pyetje, por tash prapë Besa Baftija ka pyetje për ministrin Rrahmani!

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Pyetja tjetër ka të bëjë me mosfunksionimin e koronografit. Siç e dimë, edhe kjo para dy ditësh është tash në funksion, mirëpo kisha dashur të më përgjigjet ministri se a ka ndërmarrë diçka ndaj atyre personave, të cilët vazhdojnë në vazhdimësi të keqpërdorin apo të shantazhojnë me aparate, të cilët, siç dihet, qytetarët apo pacientët tanë po vuajnë.

E dimë shumë mirë se gjatë kësaj periudhe, po e cek vetëm se prej 1 deri më 15 shtator diku 35 raste, të cilat kanë pasur nevojë të marrin shërbime për infarkt të miokardit apo për stendim është dashur të transferohen në spitale private.

Kur e llogarisim shumën e mjeteve, të cilat është dashur Ministria e Shëndetësisë të paguajë, atëherë del se jo vetëm që Ministria ka paguar një shumë të madhe mjeteve, por edhe pacientët janë ata të cilët kanë humbur, sepse ata të cilët është dashur të transferohen në fazën akute, dhe çka t'u bëjmë atyre që është dashur më vonë. Ata të cilët kanë normalisht se kanë shkuar në institucionet private, por ata të cilët nuk kanë, e kanë paguar edhe me jetë.

Prandaj, unë kërkoj nga ministri të më japë një përgjigje se çfarë ka ndërmarrë në këtë drejtim ndaj atyre që janë përgjegjës për këto punë në Qendrën Klinike Universitare?

KRYESUESI: Ministri Rrahmani e ka fjalën.

MINISTRI NIMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuar deputete,

Koronografi me të cilin punohet aktualisht në Klinikën e Kardiologjisë është instaluar në vitin 2003 dhe për shkak të vjetërsisë dhe kohës së gjatë së shfrytëzimit nevojat për servise janë më se normale dhe defektet janë të shpeshta.

Prandaj, për shkak të këtyre dy arsyeve, pra të vjetërsisë dhe stërshfrytëzimit të madh, të punës shumë të mirë dhe të përkushtuar i ekipit atje, ka pasur edhe mundësi që të paraqiten defekte të tilla.

Nëse ju keni argumente për abuzime dhe prishje të qëllimshme, ne kishim pasur shumë qejf që ato t'i dorëzoni te organet kompetente, ose te ne dhe ne të marrim masa ndaj individëve. Mirëpo, të etiketohet një klinikë që ka bërë punë të madhe deri tash, përkundër vështirësive, nuk është e drejtë.

Ju e dini që ne e kemi kaluar marrëveshjen për kredi me austriakët dhe jemi në fazën e implementimit të kësaj marrëveshjeje dhe shumë shpejt Klinika e Kardiologjisë Invazive dhe Kardiokirurgjia do të kenë aparaturë moderne dhe do të funksionojnë në kushte krejtësisht tjera, duke përfshirë edhe shtimin e kohës së mbulueshmërisë nga 8 orë deri tash, së pari në 12 orë, e më vonë edhe 24 orë shërbim.

Të gjithë ata të cilët nuk kanë mundur të marrin shërbime këta dy muajt e fundit, por ndonjëherë edhe pas orëve të vona për raste emergjente, ne kemi buxhetin dhe metodën me të cilën në kohë rekorde dhe afatshkurtër i çojmë dhe i shërbejmë, prandaj edhe nuk ka pasur ndonjë problem të madh.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete, a keni pyetje shtesë?

BESA BAFTIJA: Është normale që të ketë defekte në aparaturë dhe këtë ne të gjithë e dimë, por nuk është normale që këto aparatura të mbeten me muaj të tërë jashtë funksionit.

Për këtë ne dimë se ka 3 muaj që ky aparat nuk ka punuar dhe gjatë kësaj periudhe, siç thashë edhe më herët, ka pasur raste të shumta në të cilat janë dëmtuar jo vetëm qytetarët, por edhe Ministria e Shëndetësisë me buxhetin që e ka ndarë.

Vetëm të llogarisnim se sa i ka kushtuar për këto raste që i ka dërguar Ministria e Shëndetësisë do të ishin rreth 250 000 euro, kurse një koronograf i ri kushton diku rreth 300 000 euro.

Ministër, unë nuk e përgjithësova Klinikën e Kardiologjisë, sepse edhe unë e di si punohet dhe se kemi profesionistë shëndetësorë shumë të mirë, por duhet të merrni masa ndaj atyre të cilët po i abuzojnë aparaturat dhe po abuzojnë, për shembull edhe me menaxhmentin, i cili nuk ka ndërmarrë diçka në këtë drejtim për të përshpejtuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Nuk është imja t'ju komentoj, por pyetja bëhet pyetje shtesë dhe ju po shihni se e harxhuat kohën dhe s'e bëtë atë pyetje.

Atëherë, deputetja Selviqe Halimi ka pyetje për ministrin Nimet Rrahmani.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Pyetja ime për Ministrinë e Shëndetësisë ka të bëjë me sigurimet shëndetësore. Kemi edhe premtime elektorale, por edhe në Programin qeveritar parashihet implementimi i sigurimeve shëndetësore dhe desha të di se deri ku kanë arritur përgatitjet dhe kur mund të presin qytetarët se do të fillojë realizimi i sigurimeve shëndetësore në Kosovë. Faleminderit!

MINISTRI IMET RRAHMANI: I nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për pyetjen zonja deputete,

Me vendimin e Qeverisë, ne e dimë që është përcaktuar fillimi i mbledhjes së premieeve nga 1 janar 2017.

Këtij vendimi natyrisht i kanë paraprirë shumë aktivitete përgatitore në Ministrinë e Shëndetësisë, duke filluar nga hartimi i akteve nënligjore për fillimin e mbledhjes së premieeve, themelimi dhe funksionalizimi i këshillit përgatitor për themelimin e Fondit të Sigurimit Shëndetësor, hartimi i dokumenteve tjera përcjellëse të domosdoshme për implementim të Ligjit për sigurime shëndetësore, siç janë çmimet te shërbimet spitalore, jashtëspitalore, pakos bazike të shërbimeve shëndetësore, përcaktimi i modelit të financimit përmes sistemit ..., e të tjera.

Jemi duke e hartuar pakon e përfitimit farmaceutik, manualin për pagesën e performancës për kapitacion në kujdesin parësor shëndetësor dhe modelin e kontratave për kontraktime shërbime me kujdesin spitalor.

Buxheti fillestar i fondit do të shfrytëzohet për përmirësimin e furnizimit me barna dhe material shpenzues, si dhe për mbulimin e pakos përfituese të barnave për qytetarët në kujdesin parësor shëndetësor dhe atë spitalor.

Viti 2017 do të jetë viti i implementimit të ligjit ose i fillimit të implementimit në tërësi të Ligjit për sigurime shëndetësore.

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Zonja deputete, a ke pyetje shtesë?

SELVIQE HALIMI: Për t'u realizuar ligji dhe sigurimet shëndetësore është e domosdoshme që ta kemi në rregull sistemin e informimit shëndetësor.

Zoti ministër, tash nëpër qendra të mjekësisë familjare shihet një farë informacioni se ka filluar implementimi i sistemit të informimit shëndetësor, gjë që sipas njohurive të mia, kjo çështje ka

filluar menjëherë pas luftës, por kur nuk ka arritur që të ketë një data bazë të saktë sa i përket sistemit të informimit shëndetësor.

Si është çështja, apo si është gjendja me sistemin e informimit shëndetësor që është domosdoshmëri paraprakisht që ta kemi në rregull. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!

Po, është një projekt i dytë, i cili është shumë i rëndësishëm për reformimin e sistemit shëndetësor.

Ju e dini që ne e kemi filluar fazën e pilotimit në zonën pilot, që mbulon 30% të institucioneve shëndetësore në Kosovë dhe është duke shkuar mjaft mirë në komunën e Prishtinës dhe kemi dëshmi për shkak se janë tejkaluar disa probleme me trajnimin dhe jemi në fazën e tenderimit për harduerin në pjesën 70% të institucioneve tjera shëndetësore, e nëse nuk kemi probleme gjatë këtij procesi shpresojmë që vitin 2017 ta shtrim rrjetin në tërë Kosovën.

Por, unë mund të ju them që brenda sistemit të informimit shëndetësor ekziston moduli i sistemit të informimit të fondit, i cili mund të shfrytëzohet edhe nëse nuk e kemi komplet të funksionalizuar sistemin e informimit shëndetësor.

Edhe më herët kam deklaruar, janë mendime tuajat personale, që reformën e mirëfilltë të sistemit shëndetësor në Kosovë e bën implementimi i plotë i sistemit informativ shëndetësor, e jo Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, sepse sigurimet shëndetësore nuk do të krijojnë mrekulli për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Mytaher Haskuka ka pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Ministri nuk është këtu, deputet doni ta bëni atë pyetje?

MYTAHER HASKUKA: Ministri kurrë nuk po vjen, prandaj unë po e bëj pyetjen, ndoshta përgjigjet me shkrim.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në valën e privatizimeve e ka shitur shumicën e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, por në shumë raste pagesat e punëtorëve të cilat njihen si 20% nuk janë realizuar në afatet e parapara, e në disa raste, si ajo e punëtorëve të Gypave të Ferizajt, nuk janë realizuar fare.

AKP-ja po ashtu nuk i ka paguar pagat e punëtorëve të cilëve ndërmarrja u ka mbetur borxh, në raste të tilla AKP-ja i ka marrë si obligim.

Ndër rastet e fundit janë edhe punëtorët e ndërmarrjes “Liria” në Prizren, ku më shumë se 100 punëtorë nuk janë paguar 10 pagat e fundit, të cilat AKP-ja u ka mbetur borxh. Ajo në pretekstin e problemeve me llogaritë bankare nuk i ka paguar këto pagesa.

Po ashtu, për pagesat e pagave që janë bërë më herët, AKP-ja nuk i ka deponuar kontributet pensionale të punëtorëve, pasi këto kanë qenë paga për çdo pagesë AKP-ja është dashur të paguajë në Trustin Pensional të Kosovës ashtu siç kërkon ligji.

Çfarë ka bërë Ministria e Zhvillimit Ekonomik në aspektin e mbikëqyrjes së AKP-së dhe implementimit të drejtave të punëtorëve sipas ligjeve në fuqi?

A ka ndonjë iniciativë Qeveria për të siguruar respektimin e të drejtave të punëtorëve karshi AKP-së dhe për t'i parandaluar shkeljet e mëtutjeshme të drejtave të punëtorëve të ish-ndërmarrjeve shoqërore? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Margarita Kadriu-Ukelli, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Sa po shoh, nuk është as ministri, as deputetja.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministren Dhurata Hoxha. Ministren nuk po e shoh, zonja deputete nëse doni, mund ta shtroni pyetjen.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

I kam parashtruar për këtë seancë dy pyetje, njëra ka të bëjë me zonjën Dhurata Hoxha, ministre e Drejtësisë, dhe është hera e dytë që po e parashtoj këtë pyetje dhe nuk e kuptoj thjesht arsyen se pse ajo nuk vjen në seancë plenare. Nuk e kam pyetur për ndonjë zbulim shkencor, por thjesht për një deklaratë të saj që e ka dhënë në kohën kur e ka marrë përsipër udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë.

Pra, zonja Hoxha, më 13 korrik të këtij viti e ka marrë përsipër udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë. Ndër të tjera, në një konferencë para gazetarëve ka deklaruar se do të angazhohet në forcimin e sistemit të drejtësisë, e po ashtu edhe në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Duke pasur parasysh gjendjen e sistemit të drejtësisë në vend, e po ashtu krimin e organizuar dhe korrupsionin që çdo vit po rritet, e po ashtu edhe zyrtarët e kësaj Qeverie që shumë prej tyre kanë krijuar pasuri të pajustificueshme në kurriz të qytetarëve të varfër, pyetja është se çka saktësisht ka menduar kur ka thënë diçka të tillë, apo cilat do të jenë veprimet konkrete të Ministrisë së Drejtësisë në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe në forcimin e sistemit të drejtësisë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputetja Selviqe Halimi, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Zoti ministër, pyetja ime ka të bëjë me një çështje që po shkakton probleme në komunikacion dhe rrezik potencial për sigurinë e përgjithshme dhe sigurinë e vetë vozitësve.

Shumë rrugë rajonale dhe magjistrale në Kosovë në kohën e të reshurave shndërrohen në ujëmbledhës. A e keni vërejtur këtë dukuri dhe a keni planifikuar të ndërmerrni diçka që rrugët të jenë të pastra edhe në kohën e të reshurave? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,
Kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,
E nderuar deputete zonja Halimi,

Në realitet i kemi konstatuar, për të thënë i kemi vërejtur katër raste, i pari ka të bëjë me Korroticën, i dyti është te nënkalimi apo te ura që e kemi në Vetërnik, i tretë është në Mazgit dhe e kemi rastin e QMI-së.

Për të gjitha rastet deri më tash më lejoni shkurtimisht të njoftoj: Sa i përket rastit në Korroticë me siguri e keni vërejtur që gjatë gushtit e kemi hapur rrugën, e kemi vendos gypin e ri dhe tash besoj që është zgjidhur ajo çështje.

Në anën tjetër, sa i përket rastit në Vetërnik, para dy javësh nën urë është hapur prapë gypi, është zëvendësua FI 200 me 400 dhe besojmë që nuk do të ketë problem.

Sa i përket problemit të QMI-së, aty e kemi një problem më të madh. Në realitet te rekonstruimi i rrugës që tash po bëhet, ne i kemi zgjeruar pusetat dhe i kemi pastrua të gjithë gypat e kanalizimit atmosferik, por në realitet nuk mund të investojmë më shumë për shkak se Komuna e Graçanicës e ka një projekt për bartjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik prej Graçanice deri në lumin Sitnicë. Ne si ministri i kemi dhënë leje për nënkalim apo për vendosjen e gypave nën rrugën nacionale aty te QMI-ja, kështu që besojmë që me realizimin e atij projekti natyrisht që do të përfundohet edhe çështja e ujërave apo mbledhjes së ujërave te QMI-ja.

Jemi dëshmitarë se në shumicën e rasteve këto ngjajnë vetëm kur të ka shira të vrullshme, përndryshe gjatë shirave normale nuk ndodhin. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja deputete, nuk ke pyetje shtesë? Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Në Veriun e Mitrovicës së Kosovës, edhe pse toleranca e tepruar në Marrëveshjen e Brukselit që automjetet atje për një afat të pacaktuar të qarkullojnë me ish-targat e regjistrimit siç janë për shembull PZ, KM, PR, GL e kështu me radhë, atje sot qarkullojnë shumë automjete pa regjistrim fare.

Për mua, në rend të parë siç qytetare, pastaj edhe si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe njëherësh si anëtare e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri e Mbikëqyrje të FSK-së, këto makina paraqesin rrezik në siguri, sepse mendoj që çdo shofer që e nget një makinë të tillë është i predisponuar për të qenë një kriminel i mundshëm, i cili mund ta kryejë krimin dhe të zhduket pa gjurmë. Këtë pyetje parlamentare e kam adresuar para se të arrihet marrëveshja e

fundit në Bruksel, prandaj tanimë e dimë që është një afat i caktuar se deri kur do të tolerohen këto makina me këto tabela.

Por, shqetësimi im nuk është te tabelat e vjetra që përdoren. Kosova po pretendon të jetë pjesë e institucioneve ndërkombëtare, prandaj a mund të na thoni që si Kosovë a do të prosperojnë në institucione ndërkombëtare me Veriun e Mitrovicës apo pa të dhe a do të duhej ndoshta që ky problem të ngrihet si kriter për liberalizimin e vizave që ne ta trajtojmë si problem të domosdoshëm dhe ta zgjidhim?

Pyetja direkte është deri kur do të ndalet kjo dukuri, deri kur do të kemi lëvizje të makinave pa targa në Veriun e Mitrovicës së Kosovës?

KRYESUESI: Zoti Hyseni, ministri e ka fjalën.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuar deputete Musliu,

Të nderuar deputetë,

Në pyetjen që e parashtruat ju u përgjigjët vetë dhe kam pak t'i shtoj asaj që e thatë.

Tashmë e kemi një marrëveshje, e cila presim që në mënyrë efektive do të zbatohet. Natyrisht që të gjithë kemi hapësirë dhe arsye të jemi të pakënaqur me dinamikën e zbatimit të marrëveshjeve që arrihen në Bruksel.

Ndërkohë që mendoj se sa i përket liberalizimit të vizave, Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe nuk do të duhej që ta nxirrte asnjë lloj kriteri shtesë, përpos atyre që mbetet të përmbushen dhe që janë botërisht të ditura. Nuk do të futem më tej në këtë temë.

KRYESUESI: Zonja deputete, pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, ministër!

Unë e theksova që e kam bërë pyetjen më herët, edhe pse nuk e dhashë përgjigjen në pyetjen time. Thjesht, pyetja shumë konkrete është, tash do t'ia shtoj edhe një pyetje tjetër. Pyetja konkrete është: Deri kur do të lëvizin makina pa targa në Veriun e Mitrovicës? Dhe, po ashtu, pyetja shtesë është: Deri kur do të kemi tabela të letrës në Kosovë, në përgjithësi, jo veç në Veri më, sepse, përveç liberalizimit të vonuar të vizave, ne kemi filluar ta pengojmë lëvizjen e lirë të qytetarëve me makina të cilat kanë regjistrime prej letrës dhe që nuk kanë të drejtë të kalojnë kufirin eventualisht ndonjë rast specifik që mund të shkojnë vetëm deri në Shqipëri.

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Tash e zgjeruat pyetjen, por unë do të përgjigjem edhe në pjesën tjetër të pyetjes. Nuk ka asnjë telashe.

Deri kur do të ketë lëvizje me makina pa regjistrim në Veri? Do të doja shumë t'jua jap përgjigjen e saktë, mirëpo edhe ti që e bërë pyetjen e di që s'ka përgjigje të saktë, edhe unë e di se s'ka përgjigje të saktë.

Qeveria e Republikës së Kosovës është duke i bërë të gjitha përpjekjet në dialog me Republikën e Serbisë për normalizim të marrëdhënieve. Prandaj, është proces, kushdo që e kupton me lehtësi shtrirjen e autoritetit shtetëror të Kosovës në të gjitha pjesët e vendit, duke e përfshirë Veriun, është në lajthitje të madhe. Unë do të doja të ishte aq e lehtë siç perceptohet nga disa, do të doja shumë të ishte aq e lehtë. Mirëpo, unë e kam bindjen se nuk është e lehtë, prandaj nuk mund të flas kundër bindjeve të mia këtu.

Ajo që di është: Ministria e Punëve të Brendshme po bënë çdo gjë që është e mundshme që ta shtrijë autoritetin në këtë dikaster në veri dhe për herë të parë kemi inspektorat policor atje, për herë të parë kemi funksionim efikas të Policisë së Kosovës në atë pjesë, për herë të parë kemi qendra të regjistrimit civil në veri të Kosovës dhe për herë të parë qytetarët serbë të asaj pjese të Kosovës lajmërohen në qendra për regjistrim civil të Republikës së Kosovës për të pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, sa u përket tabelave të regjistrimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Salih Salihu, pyetje për ministrin Krasniqi, që nuk është këtu. Salih Salihu, a do ta bësh pyetjen?

SALIH SALIHU: Po kryesues, po e lexoj pyetjen, meqë pyetja ka qenë e parashtruar edhe në seancën e kaluar, por ministri as në seancën e kaluar e as tash nuk është, prandaj po e lexoj pyetjen.

Problemi është rreth sëmundjes gungore që u paraqit sivjet në pranverë dhe që po shkakton gungojën e kafshëve të Kosovës, duke shkaktoar dëme të konsiderueshme fermerëve kosovarë.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, që është nën kompetencën e Kryeministrit, ka dështuar në reagimin me kohë në vaksinimin e kafshëve për ta parandaluar përhapjen e virusit që shkakton kjo sëmundje. Pyetja konkrete për ministrin është se a kanë planifikuar t'i kompensojnë fermerët e Kosovës atyre që u kanë ngordhur kafshët dhe nëse po kur do t'i kompensojnë dhe sa do të jetë kompensimi? Shpresoj që ministri ndoshta do të përgjigjet me shkrim së paku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

VISAR YMERI: Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pyetja ime për kryeministrin Mustafa është e ngjashme me atë që e shtroi deputeti Raif Qela. Po, është vazhdimësi e saj në fakt çka u bisedua edhe deri atëherë. Edhe unë e dëgjova me vëmendje përgjigjen që e dha Mustafa sa i përket “Trepçës” dhe nga kjo besoj, unë të paktën i nxora dy fjali që më bënë përshtypje. Pra, në të parën, Mustafa tha që e kemi shpëtuar atëbotë “Trepçën” nga likuidimi kur është ndryshuar Ligji që i trajton ndërmarrjet e veçanta dhe trajtimin e tyre. Ndërkohë që kjo nuk është e vërtetë, sepse “Trepça” nuk ka shpëtuar nga likuidimi, “Trepça” vazhdon të kërcënohet me likuidim, sepse vazhdon të mbetet nën kompetencën e AKP-së dhe vazhdon të qeveriset me atë ligj. Pra, çka ka ndodhur atëherë, është shtyrë afati, por jo që ka

shpëtuar “Trepça” nga likuidimi. Ndërkohë që fakti që Qeveria deri tash nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim, pra prej atëherë, nënkupton që Trepça vazhdon të kërcënohet me të njëjtin fund.

Dhe, në anën tjetër, Mustafa foli se si është hartuar pra Ligji për “Trepçën” dhe tha që do të jenë në harmoni me interesat e Republikës së Kosovës dhe të punëtorëve, por nuk na tregoi çka ka në atë ligj. Tash duhet të jemi të vetëdijshëm që ka një muaj kohë deri më datën 2 nëntor kur prapë likuidimi i “Trepçës” ose ky afati i dhënë për plotësim-ndryshimin e ligjit skadon dhe rrjedhimisht “Trepça” rrezikon të likuidohet. Ndërkohë që prapë Kuvendi po shihet që do të vendoset nga Qeveria në një pozicion të një miratimi të një ligji të përsheptuar në procedurë të përsheptuar, pa trajtim serioz të tij për një çështje kaq serioze, e kjo tregon në fakt që o Qeveria nuk ka ide fare se çfarë duhet të bëjë në përgjithësi në Kosovë, o që Qeveria, duke pasur parasysh që ligji nuk është i mirë, po do që ta shmangë debatin e mirëfilltë në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti deputet, nuk dëgjuam pyetje, po ti je edhe një herë Visar Ymeri, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, herën e dytë, pyetje tjetër.

VISAR YMERI: E shtroj pyetjen për “Trepçën”. Pra, unë dua të di, jo vetëm kur do ta sjellin ligjin, se atë e tregoi pak a shumë Isa Mustafa, po më mirë të them: A do të bëhet “Trepça” ndërmarrje publike siç ishte ideja në janar 2015?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Atë se çfarë do të përmbajë ligji ju do ta merrni vesh në procedurën kur ta sjellim në Kuvend. Dhe, unë nuk jam i detyruar ta shpjegoj ligjin para se të vijë në Kuvend. Ligjin do ta sjellim këtu, do të jetë transparent, do të keni mundësi ta studioni, ta jepni mendimin tuaj dhe ligji do të vijë në afatin e duhur dhe do të zhvillohet në procedura normale të Kuvendit.

Është e vërtetë se ne në fillim të vitit të kaluar e kemi evituar shkuarjen e “Trepçës” është në likuidim. Është e vërtetë që ju opozita, kur është dashur të votohet ligji, i cili do ta pamundësonte shkuarjen e “Trepçës” në likuidim e keni lëshuar sallën e Kuvendit dhe ka mbetur që ne të vendosim. Prandaj, sikur ta kishit pasur atë brengosje aq të madhe për “Trepçën” do të qëndronit atëherë dhe ju do të merrni pjesë me gjithë të tjerë që ta evitojmë shkuarjen në likuidim.

Është e vërtetë se “Trepça” akoma është nën autoritetin e AKP-së, por tash me këtë ligj ne do ta nxjerrim nga ai autoritet dhe do ta përcaktojmë në mënyrë të veçantë statusin e “Trepçës me ligj, e çfarë do të jetë ai status do ta shpjegojë ligji kur të vijë në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit, kryeministër! Deputet Ymeri, a ke pyetje shtesë?

VISAR YMERI: Së pari nuk mund të procedohet sipas rregullave, sepse Rregullorja e Kuvendit thotë që ka afat dy muaj për t’u trajtuar një ligj ashtu siç e do rendi, ndërkohë që ne e kemi vetëm një muaj, siç thatë ju, pra që ligji të hyjë në fuqi para 2 nëntorit, atëherë e kemi më pak se një muaj që ta trajtojmë në Kuvend.

Në anën tjetër, është e vërtetë që ne nuk kemi marrë pjesë fare në votim, sepse ne e kemi mbrojtur një ide që e mbronte i tërë spektri politik 3 ditë më herët atëbotë kur është miratuar ligji që “Trepça” të shndërrohet në ndërmarrje publike.

Ndërkohë që ju, në fakt, keni ikur nga kjo ide për shkak të trysnisë nga Qeveria e Serbisë dhe, rrjedhimisht, ne nuk kemi dashur të biem pre e trysnisë nga Qeveria e Serbisë siç keni rënë ju. Kjo është e vërteta për atë ditë dhe atë seancë. Pra, ne mendojmë që shpëtimi i “Trepçës” është që ajo të shndërrohet në ndërmarrje publike. Ndërkohë që ju jeni të pavendosur në këtë drejtim, sot më së buti deri tash. Prapë po e pyes kryeministrin, që për sa i përket “Trepçës”...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Qeveria nuk e ka kompleksin e Qeverisë së Serbisë, atë që e keni ju. Prandaj, në atë kompleks jetoni ju dhe jo ne, sepse ne në asnjë rast ligjet tona nuk i vëmë karshi me disponimin dhe vendimet e Qeverisë së Serbisë, por me vendimet tona, me vlerësimet tona dhe me partneritetin ndërkombëtar që ne e kemi ndërtuar këtu në Kosovë.

Ndërkaq prapë po them se ajo që është përmbajtje e ligjit do të vijë në Kuvend edhe Kuvendi do të vendosë lidhur me statusin e “Trepçës”.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Meqë Ganja më herët tentoi të pyesë, pyetje shtesë, edhe meqë ministri nuk u përgjigj, unë po e vazhdoj. Është fjala për targat provuese tashmë në Kosovë, meqë për muaj të tërë qytetarët nëpër qendrat e regjistrimit nuk mund të pajisen me targa normale dhe të duhura. Çka është në pyetje ministër, pse ka ngecur ky proces, pasi shkojnë nëpërmjet ministrisë tuaj dhe është kompetencë e ministrisë tuaj çështja e targave, e qarkullojnë me mijëra sosh nëpër Kosovë?

KRYESUESI: Ministri Hyseni e ka fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Zafir faleminderit që e ke shtruar këtë pyetje, sepse ma jep mundësinë që të përgjigjem edhe në pyetjen shtesë që deputetja e pati më herët.

Dy herë është shpallur tender për pajisje të qendrave të regjistrimit të automjeteve në Republikën e Kosovës me tabela. Kjo është hera e dytë dhe natyrisht që një proces tenderues i stërzgatur është duke ndodhur për shkak të ankesave që kanë bërë në vendimin e Komisionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme disa kompani tenderuese dhe është afati i fundit këto 2-3 ditë kur Organi Shqyrtues i Prokurimit do të duhej ta përmbyllte procesin e trajtimit të ankesave të kompanive ankuese.

Pra, Ministria e Punëve të Brendshme ka kohë që e ka kryer pjesën e vet të punës dhe është në Organin Shqyrtues të Prokurimit të vlerësojë tash nëse ajo punë është përmbyllur në pajtim me

ligjin apo jo, nëse ka pasur çfarëdo dhe ne vetë kemi kërkuar që kjo të shihet me kujdesin më të madh.

Jemi të vetëdijshëm, mirëpo nuk do të bëjmë, nuk do të shkaktojmë një dëm tjetër shumë të madh në një fushë duke u përpjekur që ta parandalojmë një dëm, në këtë rast që është i riparueshëm, me targat provuese shumë të përkohshme dhe ato ju siguroj që do të jenë shumë të përkohshme, mirëpo vetëm me kusht që procesi i tenderimit të përmbyllet deri në fund në pajtim me ligjin.

KRYESUESI: Deputeti Berisha, a ke pyetje shtesë?

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Unë, thënë të drejtën, pyetjen kryesore e kam tash, për shkak se përafërsisht e kam ditur që do të përgjigjeni kështu. Sepse, një nga shumë zëvendësministra sa keni, besoj që s'e di a e dini edhe ju sa keni zëvendësministra?

Mbrëmë e ka dhënë përmes një raporti në një televizion përgjigjen që e dhatë ju. Problemi është se unë, zoti ministër, po dyshoj se grupet politike të krimit të organizuar nuk po merren vesh kush ta fitojë tenderin. A je duke dyshuar edhe ti si unë? Kjo është pyetja që unë pres përgjigje.

KRYESUESI: Ministri Hyseni e ka fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Zoti deputet Berisha!

Asnjëherë nuk do ta marr rolin as të prokurorit, as të gjykatësit. Ajo që ju siguroj unë këtu, ajo marrëveshje nuk ka arritur asnjëherë në tavolinën time për nënshkrim dhe asnjëherë, për aq sa di, nuk do të nënshkruaj diçka që është e dyshimtë, kjo është një.

Dy, dhe nënshkrimi i ministrit, besoj, në rend të parë nënkupton zotimin për t'i siguruar mjetet për atë. Ndërkaq, procesin e tenderimit nga dita e shpalljes deri në përmbyllje do ta bartin komisionet përkatëse dhe në këtë rast Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe cilido që të jetë vendimi i këtij organi, Ministria e Punëve të Brendshme është e obliguar plotësisht ta zbatojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministren Hykmete Bajrami. Unë, sa shoh, ministria nuk është këtu. Zoti Berisha, doni t'i bëni pyetjet?

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë në formë pyetjeje dhe çështjet, sigurisht shqetësuese, do ta bëj të parën lehtësuese dhe të dytën pasuese, të stilit të mëhershëm. Fjala është se një çështje tepër shqetësuese, e cila është dashur deri tash të marrë përgjigje nga Qeveria dhe organet përgjegjëse për qytetarët, ka të bëjë me matësit elektrikë.

Vitin e kaluar, diku në muajin shkurt, në këtë sallë është debatuar dhe stërdebatuar çështja e matësve elektrikë të tipit "Kohler", të cilët vetë ministrja ka pranuar se në bazë të inspektimit të hetimeve që janë zhvilluar, domethënë dhe një instituti në Holandë është konstatuar se ata matës elektrikë bëjnë matjen më tepër sesa duhet. E keqja është se mbi 25 mijë qytetarë, sot e një vit kur është konstatuar kjo, vazhdojnë t'i kenë ata matës elektrikë dhe çka është duke bërë qeveria

që ta parandalojë vjedhjen sistematike institucionale të qytetarëve dhe qytetarët që po vidhen tashmë,që dihet publikisht, është pranuar edhe nga vetë ministria, sepse në ministri të saj ka pasur edhe arrestime për këtë çështje në prill të vitit të kaluar.

Si do të kompensohen vjedhjet që iu janë bërë qytetarëve deri tash,në mesin e tyre edhe shumë deputetëve, edhe mua që i kam të njëjtin tip të orëve. Apo do të vazhdojë Qeveria, domethënë me vetëdije ta lejojë një kompani private t'i vjedhë qytetarët siç i ka vjedhur tash dy vjet e më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Enver Hoti, pyetje për ministrin Skënder Hyseni.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Pyetja për ministrin Hyseni ka të bëjë për çështjen e sigurisë në zonën kufitare. Pyetja është konkrete: cilat janë masat që i ka marrë Qeveria, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, karshi lëvizjeve të Policisë kufitare të Malit të Zi në territorin e Republikës së Kosovës, në një pjesë tashmë e sa kohë të kontestuar? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Republika e Kosovës dhe Republika e Malit të Zi janë vende dhe shtete në marrëdhënie të plota diplomatike dhe absolutisht miqësore.

Më 3 shtator 2011 KFOR-i ia ka kaluar kompetencat, ia ka dorëzuar Policisë së Kosovës kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit me Malin e Zi. Policia e Kosovës sot ka protokolle për patrullimet e përbashkëta me policinë e shteteve që kufizohen me ne, deri tani me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Këta kufij patrullohen bashkërisht nga autoritetet e shteteve përkatëse. Policia e Kosovës mbikëqyr dhe kontrollon kufirin Kosovë - Mali i Zi, atë vijë kufitare, e cila është dorëzuar nga KFOR-i te Policia e Kosovës në pajtim me marrëveshjen teknike ushtarake të 9 qershorit 1999. Kosova ka të nënshkruar po ashtu me Malin e Zi marrëveshjen për trafikun lokal ndërkufitar dhe patrullimet e përbashkëta nënkuptojnë po ashtu që ndonjëherë patrullat e përbashkëta kalojnë në të dyja anët e vijës kufitare, pa asnjë pengesë dhe me mirëkuptim të plotë.

Prandaj, që ta përmbyll, gjendja e sigurisë përgjatë vijës kufitare me Malin e Zi është e mirë, është e qëndrueshme dhe absolutisht stabile.

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Zoti Hoti, urdhëro, e keni fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministër, nuk na e dhatë përgjigjen të cilën e kemi pritur. Ju na treguat disa marrëveshje dhe disa detyra që i ka Policia kufitare e Kosovës, por që nuk janë të mjaftueshme për temën dhe për gjendjen e cila ekziston atje.

Ju e dini, e keni parë një incident që ka ndodhur mes qytetarëve kur kanë dashur të shkojnë në pronat e tyre. Gjendja nuk është e qëndrueshme, është një mashtrim që po e prezantoni këtu para

deputetëve dhe para opinionit, sepse marrëveshja për demarkacionin ka krijuar pasiguri të madhe nacionale dhe rrezikon të jetë akoma më e rëndë. Vetëm edhe pak, të lutem! Prandaj, ju nuk e dhatë përgjigjen që duhet ta jepni. Jeni kreator edhe ju i asaj marrëveshjeje që e keni nënshkruar, së bashku me ish-ministrin, keni rënë në lajthitje në punën e Komisionit Shtetëror dhe gjendja tani për tani është e stabilizuar vetëm për një fakt, sepse ju në seancën e kaluar, më 1 shtator, e keni tërhequr...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Unë u përgjigja saktësisht në pyetjen ashtu siç ju e keni dërguar me shkrim, zoti deputet.

Asnjë nga këto që ju i përmendët në pyetjen shtesë, nuk janë në pyetjen që ju e keni dërguar. Dhe, unë nuk do ta marr kohën e deputetëve tash të flas për një temë të cilën ju e hapët dhe unë jam i gatshëm të flas në çdo kohë absolutisht, pa asnjë hezitim, pa as më të voglin hezitim. Mirëpo, mos u përpiqni të krijoni perceptcion në opinion edhe më keq të dërgonim mesazhe ndërkombëtar që në kufirin Kosovë - Mali i Zi ka pasiguri, sepse nuk ka. Është situatë tërësisht e sajuar, e shpifur dhe nuk ka absolutisht asgjë të bëjë me të vërtetën.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Ministër, numri i qytetarëve që po arrijnë moshën e pensionimit, por që nuk po i arrijnë 15 vjet përvojë pune, për kontribute të paguara paralufte, po rritet për çdo ditë. Disa pensionistë këtë kusht nuk po e plotësojnë madje edhe për disa ditë, javë ose muaj. Kjo është gjithsesi padrejtësi që duhet të korrigjohet.

Andaj, zoti ministër, pyetja për ju është: pse pensionistëve kontributdhënës me 14 vjet përvojë pune, ose edhe më pak, me 13, 12, 10 e më pak vite përvojë pune nuk po iu paguhet pensioni, duke i zbritur pensionin nga viti në vit, e jo të përjashtohen tërësisht nga pagesa e pensionit për kontributdhënësit, ata që nuk i kanë 15 vjet punë, gjegjësisht që nuk i kanë kontributet e paguara për 15 vjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Abrashi e ka fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Deputet Kurteshi, faleminderit për pyetjen, është një shqetësim të cilin edhe ne në ministri dhe në Qeveri besoj e kemi përcjellë. Por, mbi Ligjin në skemat pensionale të lansuar nga shteti, përkatësisht neni 8, ashtu si e cekët edhe ju, përcakton që një pensionist duhet t'i ketë së paku 15 vjet stazh kontributiv ose përvojë pune deri më 31. 12. 1998. Ne e kemi bërë analizat e duhura

rreth kësaj çështjeje, pasi kjo çështje është ngritur qoftë nga përfaqësuesit e pensionistëve, qoftë edhe nga pensionistët, direkt prej tyre, por jemi duke punuar në këtë çështje.

Atë çka kemi bërë gjatë vitit të kaluar në këtë vit është që të punojmë në prioritetet e prioritetëve, e para ka qenë që të mbyllim infrastrukturën ligjore dhe ta zbatojmë atë në tërësi. Kemi filluar me kategorizimin e pensionistëve, tani kjo po funksionon mirë, gjatë ditëve në vijim apo gjatë javëve në vijim përmbyllim obligimet e tjera ligjore, sikurse skema pensionale invalide dhe skema pensionale familjare dhe posa të mbyllen këto, atëherë shkojmë në analizat buxhetore, kostot buxhetore dhe mundësitë e praktikave të tjera, si të reagojmë për këta pensionistë, të cilët nuk arrijnë 15 vjet ashtu siç parashihet me ligj.

Pra, jemi duke punuar në përmbylljen e dy skemave, të cilat i kemi obligim ligjor, pas kësaj hyjmë në diskutime të gjërave publike edhe me Ministrinë e Financave, po pasi që do të nxjerrim kostot e një projekti të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kurteshi, a ke pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: E falënderoj ministrin për këtë përgjigje dhe besoj që do të qëndrojë pas kësaj që e tha dhe do të angazhohet që edhe pensionistët me më pak përvojë pune do ta gëzojnë të drejtën e vet që t'i shfrytëzojnë ato, po tash e kam një pyetje shtesë.

Ministër, para një 3 muaj më patët premtuar për një çështje që pata pyetur për pensionistët e Zvicrës që do të më përgjigjeni privatisht dhe ata pensionistë po më pyesin për çdo ditë se a e kam marrë përgjigjen privatisht. Unë nuk e kam marrë. Prandaj, është mirë të më tregoni kur do të na jepni atë përgjigje, qoftë privatisht, qoftë publikisht, po do të ishte mirë ta jepni një përgjigje. Urdhëroni, ministër!

KRYESUESI: A e do fjalën, ministër? Urdhëro!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit!

Është e vërtetë që ashtu ka qenë premtimi, por tani mund ta themi edhe publikisht, sepse besoj se faza më e ndjeshme ka kaluar. Ne kemi pasur një “pilot marrëveshje” me autoritetet zvicerane, “pilot marrëveshje” që ka nënkuptuar testimin e institucioneve tona karshi kërkesave të tyre sa u përket sigurimeve të përgjithshme shëndetësore, dokumenteve edhe informatave të tjera, të cilat ata mund t'i kërkojnë.

Kjo “pilot marrëveshje” ka mbaruar muajin e kaluar dhe ne kemi kaluar këtë me sukses dhe i kemi dërguar informatat tona tek autoritetet zvicerane. Ato informatat e para që i kemi nga ambasada këtu, por edhe autoritetet atje, janë shumë pozitive, ne presim që shumë shpejt ta përmbyllim edhe marrëveshjen me Zvicrën.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Fadil Beka, pyetje për ministrin Abrashi, kjo është pyetja e fundit për sot. Urdhëro, Beka!

FADIL BEKA: Faleminderit, nënkryetar,
I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I nderuar ministër Abrashi,

Siç jeni edhe ju në dijeni, në kuadër të përfitimeve dhe benefiteve që ua garanton ligji, numër i madh i invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe invalidëve civilë të luftës tash e një kohë të gjatë kanë mbetur pa përcaktimin e shkallës së invaliditetit në mungesë të komisionit mjekësor për vlerësimin e këtyre kategorive.

Prandaj, zoti ministër, pyetja konsiston në këtë: kur pritet formimi i komisionit mjekësor për vlerësimin e shkallës së invaliditetit të kategorive të luftës, detyrë kjo që i takon Qeverisë, gjegjësisht ministrisë që ju drejtoni dhe konsiderojmë që kjo çështje duhet të trajtohet me prioritet nga ana e ministrisë suaj.

KRYESUESI: Urdhëroni, ministër Abrashi!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, nënkryetar,

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Deputet Beka, faleminderit për pyetjen!

Siç jeni të njoftuar, po mendoj, edhe publiku e di, kjo ka të bëjë me një vendim të vitit 2010, kur është ndaluar puna e komisionit dhe pranimi i aplikacioneve për këtë kategori. Ne jemi duke punuar me të gjithë aktorët në kuadër të ministrisë sonë, por edhe jashtë ministrisë që të fillojmë këtë proces.

Procesi ka stagnuar në pikën ku ne presim listat përfundimtare të veteranëve invalidorë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe pasi të marrim këto lista, atëherë edhe fillojmë procesin e aplikimit. Në ndërkohë ne jemi duke punuar në infrastrukturën tjetër përcjellëse ligjore që sapo të fillojë ky proces ose të pranojmë listat, të fillojmë procesin sa më mbarë dhe jemi duke punuar në udhëzimet administrative për procedurat e aplikimit në skemën e pensioneve të beneficioneve të përcaktuara me legjislacionin për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së.

Në Udhëzimin administrativ për kompensimin e shpenzimeve të varrimit për veteranët, luftëtarët, invalidët e luftës së UÇK-së dhe Udhëzimin administrativ për procedurat e lajmërimit, mbikëqyrjes dhe raportimit të përfituesve të pensioneve të skemës pensionale të përcaktuar me legjislacionin për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së. Domethënë, jemi duke punuar paralelisht në udhëzime administrative, në pritjen e listave dhe gjithmonë në koordinim me shoqatat e dala nga lufta. Faleminderit!

KRYESUESI: A ka pyetje shtesë, zoti Beka? Nuk ka! Faleminderit! Kaloi koha më tepër pesë minuta se që e kishim caktuar. Ju njoftoj që pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje për dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Atëherë, vijojmë me pikën tjetër.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Ju pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 22 shtator 2016. Nuk ka, atëherë konsideroj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 22 shtator 2016.

4. Votimi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar, andaj sot vazhdojmë me votimin e rekomandimit të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për emërimin e zotit Abdullah Aliu anëtar në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Të pranishëm janë 67 deputetë, votojmë tash.

Atëherë kanë votuar 51 deputetë, 49 janë për, 2 kanë abstenuar. Nuk ka kuorum për vendosje. Kalojmë tutje.

5. Votimi i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Është detyrimi juaj, i shefave të grupeve parlamentare nëse keni çështje të rëndësishme t'i sillni deputetët këtu, s'është imja. Çka po kërkon ti, urdhëro? Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë e kam të qartë detyrën dhe i ftova edhe njëherë, por është korrekte edhe nga shërbimi që të kërkojmë, s'po them ju, që t'ju thuhet atje të ndërpritet mbledhja e komisionit dhe të vijë në mbledhje, këtë e thashë. Ne s'mund të shkojmë t'i marrim ata për dore, por të kërkojmë nga shërbimi t'u thuhet se tash votohet, le të jenë në seancë, sepse është absurde dhe nuk po mund t'i kuptoj ata kolegë deputetë që janë në mbledhje gjatë seancës.

Këtë po dua ta them si pjesë të përgjegjësisë që e ndjej edhe unë, apo vërtet të papërgjegjësisë. Po i ftojme publikisht, unë do të shkoj tash t'i ftoj, por edhe shërbimi t'ju thotë le të përmbyllet ajo, le të vijë që të votojnë. Kjo është ajo, edhe e kuptoj plotësisht, keni të drejtë sa i përket detyrës sime, po ata e kanë detyrë që të jenë në seancë.

KRYESUESI: Tash ne nuk po bëjmë pedagogji kuvendore, se jemi shumë deputetë moti këtu, shërbimi s'merret me deputetë, janë deputetët që vijë, po nuk merret shërbimi.

Atëherë unë ju jap pesë minuta pauzë derisa t'i sillni këtu.

* * *

KRYESUESI: Atëherë, në sallë janë 74 deputetë. Viojmë me punën. Fjalën e ka kërkuar Ismet Beqiri. Urdhëro!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë kërkoj në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, që pika 5, votimi i Projektligjit për investime strategjike në Republikën e Kosovës dhe pikat 8 dhe 9, nuk po i lexoj, të tërhiqen të shtyhen për seancë tjetër dhe të kalojmë drejtpërdrejt në interpelancat e kërkuara më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Dëgjuam propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Kërkoj deklaratimet e grupeve tjera parlamentare. Nga PDK, Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike pajtohet me propozimin e zotit Beqiri, që këto pika të zhvendosen për një seancë tjetër, në mënyrë që të trajtohen mirë edhe pikat tjera dhe po ashtu, t'i japim kohë edhe Qeverisë që për disa prej pikave të mund të sjellë materiale ose informata shtesë, se këto i kemi pasur edhe kërkesa të deputetëve gjatë takimeve që na i kanë transmetuar prej mbledhjes së komisioneve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! "Vetëvendosje", Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Mirë që po shtyhen këto ligje, por do të ishte mirë që të pezullohen fare, për arsye se, sidomos kjo për rastin e shfrytëzimit dhe hulumtimit të qymyrit. Këtu Qeveria nuk ka pasur kurrfarë transparence dhe deputetët nuk e kanë as informacionin minimal se çka do të jetë kjo.

Krejt çfarë kemi parë është një sllajd, një përmbledhje sllajdesh, 23 sllajde që i ka dërguar kjo kompania e cila e ka një projekt shumë ambicioz të shpjeguar me fjalë, mirëpo për kah sasia e informacionit që kemi nuk është as minimumi i nevojshëm që ne të vendosim në mënyrë transparente se çka do të ndodh me njërin prej pasurive më të rëndësishme të vendit tonë.

Nuk po flitet këtu thjesht ashtu sikurse për hulumtim dhe shfrytëzim të qymyrit dhe për shndërrim të tij, siç po flitet aty, për disa metoda, për hapësirën që e parasheh ligji. Por, rekomandimi i Qeverisë po bie edhe në kundërshtim me vetë ligjet që këta i kanë bërë, pra po flitet për 3100 km², në të cilën ata do ta kenë të drejtën të kenë qasje në territorin e Kosovës, me e shpua territorin e Kosovës dhe të shohin e të hulumtojnë për rezervat e qymyrit.

Kjo nuk është çështje e vogël, kjo është çështje shumë serioze, për të cilën është shumë mirë që po tërhiqet, po është mirë që të pezullohet tërësisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet tjera, a dëshirojnë të deklarohen? Nëse jo, atëherë kërkoj që propozimi të kalojë me votim formal.

Kush është për që të shtyhen këto pika? Faleminderit! Shumica. Kush është kundër? Një është kundër. Abstenim? Pra, nuk ka. Në sallë janë 77 deputetë. Kalojmë te pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 6 deputetë nënshkrues, lidhur me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës

Deputeti Visar Ymeri i mbështetur edhe nga 6 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit Interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë.

Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në dhjetë minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në pesë minuta. Ky është neni 44.7 i Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit kryeministri Isa Mustafa paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutave.

Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar është si vijon:

- Grupi Parlamentar i PDK-së - 34 deputetë ka 50 minuta, minus 6 minuta për kryeministrin, që bëjnë 44 minuta.
- Grupi Parlamentar i LDK-së ka 33 deputetë, ka 49 minuta, minus 6 minuta që i jepen kryeministrit, që bëjnë 43 minuta.
- Grupi “Vetëvendosje” ka 16 deputetë dhe ka 24 minuta.
- Grupi LS ka 11 deputetë, 16 minuta, minus 2 minuta për kryeministrin, që i bie 14 minuta.
- Grupi i AAK-së ka 18 deputetë, 12 minuta.
- Nisma 9 minuta,
- Grupi “6+” - 9 minuta, 1 për kryeministrin.
- pa grup parlamentar 9 minuta.

Ftoj Visar Ymerin, deputet dhe kryetar i Lëvizjes “Vetëvendosje” në cilësinë e propozuesit të interpelancës, e ka fjalën 10 minuta. Urdhëro!

VISAR YMERI: Faleminderit!

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Duhet ta themi që në fillim edhe ta themi troç, se kodi telefonik sipas marrëveshjes së nënshkruar na Isa Mustafa me Vuçiqin e më herët Hashim Thaçi me Daçiqin, i ndahet Serbisë, sepse Kosova nuk po bëhet anëtare e ITU-së e Serbia ia cakton këtë kod Kosovës. Pra, kështu është marrëveshja.

Serbia do të ishte pronare e kodit telefonik. Për këtë fakt u pat rënë dakord, që të mos bëhet publike. Publikisht do të thuhej, pra që vetëm teksti i marrëveshjes, i paraqitur në marrëveshje,

pra që Austria do të aplikonte për këtë kod, pa saktësuar se cila palë do të ishte pronare e kodit tonë telefonik.

Duket absurde, që pas kaq shumë përpjekjesh edhe vitesh të përpjekjeve për shkëputje nga Serbia dhe pas tetë vjetësh nga shpallja e Pavarësisë së vendit tonë, të ketë hije dyshimi se Serbia do të jetë pronar i kodit telefonik. Në këtë absurditet na kanë futur Qeveria Thaçi 2 dhe e ka finalizuar kjo Qeveri e tashme, Qeveria Mustafa.

Çfarë ndodhi një vit më parë? Qeveria e Republikës së Kosovës njoftoi se më 25 gusht të vitit 2015 kryeministri Isa Mustafa kishte nënshkruar midis të tjerash në Bruksel dhe planin e përbashkët të veprimit për telekomunikacionin, midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e komisionares për politikë të jashtme Frederika Mogerini. Sipas marrëveshjes, Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit, pra ITU, do t'ia alokonte shtetëror plus 383, ndërsa aplikimin do ta bënte Austria, siç ishte dakorduar në marrëveshje.

Citoj nga teksti i marrëveshjes: “Kam nderin...”, pra ky është citim, “...të kërkoj në emër të Serbisë dhe të Kosovës, që Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve të fillojë procesin e alokimit të kodit thirrës treshifror për Kosovën” - aneksi 2 i kësaj marrëveshjeje, teksti i letrës së Austrisë për ITU-në.

Ndërsa, sa i takon dhënies në përdorim të kodit telefonik, pra botimit në buletin e ITU-së, thuhej se, citoj prapë, “...teksti i buletinit të ITU-së, me pajtimin e administratës së Republikës së Serbisë, drejtori i Telekom-Serbia i cakton Kosovës kodin ndërkombëtar si në vijim...” dhe pastaj tregon për kodet që do të caktohen, aneksi 1 i marrëveshjes.

Paralelisht me këtë hap Mustafa pati rënë dakord me kryeministrin e Serbisë, që Qeveria e Kosovës në kundërshtim me ligjin, të urdhëronte ARKEP-in, pra Autoritetin Rregullator për Tregun e Telekomunikacionit, që të lejonte brenda territorit të Kosovës operimin e një kompanie të re, që do të regjistrohej deri në hapjen e tenderit ndërkombëtar për operatorin e radhës. Ai operator që do t'i lejohej që përkohësisht të operonte në Kosovë është Telekom i Serbisë.

Ne si lëvizje, por edhe opozita në përgjithësi, menjëherë pas nënshkrimit kemi bërë thirrje për zmbropsje nga kjo marrëveshje. Midis tjerash, këtë marrëveshje e kanë kundërshtuar edhe 205 mijë firmëtarët e Peticionit të mbajtur para një viti në Kosovë.

Po ashtu, kemi mbajtur dhjetëra konferenca e tryeza përgjatë viteve 2011 - 2015, me theks të veçantë këtë rrezik për kodin telefonik të Kosovës. Të gjithë specialistët e telekomunikacionit në Kosovë, siç e pamë gjatë tryezës së mbajtur më 27 janar të vitit 2016 në Prishtinë, e kundërshtonin hapur këtë marrëveshje.

Republika e Kosovës është shtet i pavarur, i njohur nga 111 vende të Botës, ose më shumë se gjysma e anëtarësisë së ITU-së. Serbia, jo vetëm që nuk e njeh, por Kushtetuta e saj e konsideron Republikën e Kosovës të jetë territor i saj. Ky fakt e përjashton Serbinë për të pasur ndonjë rol në caktimin e numrave ndërkombëtar për shërbime telefonike për Republikën e Kosovës. Në marrëveshje me Serbinë, kësaj të fundit i njihet kompetenca në qeverisjen me sektorin e telekomunikimit në Kosovë. Posta dhe Telekom i Kosovës është ndarë nga Serbia 55 vjet më

parë, tani për herë të parë, pas 55 vjetëve, me nënshkrim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, operatori shtetëror serb kthehet në Kosovë. Dhe, kjo bëhet kinse për kodin telefonik, për të cilin aplikon Austria me pëlqimin e Kosovës dhe të Serbisë.

Tek kodet kemi aplikuesin, titullarin, pra pronarin dhe shfrytëzuesin. Aplikuesi në këtë rast është Austria, shfrytëzuesi është Kosova, ndërkohë që titullari, pronari mbetet Serbia. Operatori i ri në Kosovë do të jetë një operator që është regjistruar në dhjetorin e vitit të kaluar dhe që quhet Telefonia Mobile e Serbisë. Marrëveshja për telekomunikacionin, fazat e saj si dhe forma e aplikimit për kod kanë qenë jotransparente dhe në kundërshtim me interesin shtetëror të Republikës së Kosovës.

Në kundërshtim me këtë, duke pranuar rolin e Serbisë në këtë proces, në mënyrë të pashmangshme do të interpretohet nga ana e Serbisë, se edhe ITU e ka pranuar qëndrimin e Serbisë në lidhje me Republikën e Kosovës.

Pasojat e përfshirjes së Serbisë në këtë proces shihen në planin e zbatimit, të cilin e ka nënshkruar kryeministri Mustafa për këto kode. Ky dokument e tregon qartë çmimin e rëndë, që Republika e Kosovës ka për të paguar, për shkak të autoritetit të dhënë në Serbi për të caktuar kodet. Serbia përdor një autoritet të tillë, që ta diktojë politikën e telekomunikacionit, funksionet rregullative dhe operacionale në sektorin e telekomunikacionit të Republikës së Kosovës, të tilla siç janë: licencimi, tarifat, e të tjera... Kjo është një arsye pse kodet ndërkombëtare duhet të caktohen nga ITU direkt me Republikën e Kosovës e jo përmes Serbisë.

Sipas kësaj marrëveshjeje Kosova betonohet nën Rajon, që formalisht gjendet nën sovranitetin e Serbisë, të paktën në sektorin e telekomunikimeve, nga se kodi merret me leje të Serbisë dhe Kosova vetëm do ta shfrytëzojë atë. Me këto negociata vetëm sa është kompromentuar mundësia e aplikimit vetjak të Kosovës ose bashkëpunimit me Shqipërinë. Praktikisht dhe politikisht edhe lobimi me këtë platformë do të kishte qenë më i thjeshtë dhe më pak i kushtueshëm, që ishte kompensuar me përfitime nga marrja e pakushtëzuar e kodit ndërkombëtar telefonik.

Plani i numeracionit i Kosovës sot e në të ardhmen rrezikon, nëse nuk ndërrojmë kurs si shtet, të mbetet peng i marrëveshjeve me Serbinë. Paralelisht me këtë do të duhej që të vijohej largimi i operatorëve ilegalë, kudo në territorin e Republikës së Kosovës. Diçka e tillë është bërë me shumë sukses vite më parë me operatorët e telefonisë mobile, pra kjo dëshmon që është e mundshme të bëhet një gjë e tillë. Pastaj, këto zona do të kaloreshin në shërbim të operatorëve legalë me një kalim të paralajmëruar dhe pa ndërprerje, veçanërisht për shërbimet e emergjencave shëndetësore.

Argumenti bazë i Serbisë në këto negociata ka qenë, që vetëm Telekom Srbija mund t'i sigurojë minoritetit serb në Kosovë shërbime të telekomunikacionit, që janë bashkë me ato postare, pjesë e të drejtave elementare njerëzore. Por, kjo nuk qëndron, pasi që në ato zona ku nuk operon mobili i Telekom Serbisë, popullata shërbehet fare mirë me Vala dhe IPKO. Vala dhe IPKO për thirrjet në Serbi kanë vendosur rata shumë të volitshme, si dhe u japin mundësi operatorëve nga Serbia që të sjellin trafik tek Vala dhe IPKO me çmime të privileguara, për çka ata vetë e përballojnë humbjen. E njëjta ka mundur të vazhdojë edhe me telefoninë fikse dhe me shërbimet postare.

Duhet ta kemi parasysh, se Republika e Kosovës ka mundur të aplikojë vetë në ITU, sipas nenit 2, pika c e Kushtetutës së ITU-së. Po ashtu, Republika e Kosovës ka mundur ta shfrytëzojë kodin +355 të Republikës së Shqipërisë duke e zbatuar Rezolutën e Kuvendit, që ishte nxjerrë më herët për këtë çështje.

Republika e Kosovës ka pasur mundësi të aplikojë nëpërmjet Republikës së Shqipërisë në ITU, nëse për dy mundësitë e para paraqiteshin pengesa. Por, jo! Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur në kundërshtim me vullnetin e Kuvendit, në kundërshtim me dokumentet e nxjerra në këtë Kuvend në formë rezolutash, të votuara nga të gjithë deputetët, siç u potencua më herët nga deputetë këtu, që këtë ta bëjë bashkë me Serbinë dhe kështu ta rrezikojë sovranitetin e Republikës së Kosovës në fushën e telekomunikimeve, duke vendosur sistemin e komunikimeve të Kosovës në pozitë inferiore karshi atij të Serbisë dhe duke ia hapur derën që ky sistem dhe ky territor komunikimesh të konsiderohet si vazhdimësi e sovranitetit të Serbisë dhe integritetit të saj territorial.

Pra, në këtë interpelancë do të duhej ta diskutonim dhe në fund ta votonim Rezolutën, me të cilën kërkohet që kjo rrugë të ndërpritet, në mënyrë që Kosova të sovranizohet në fushën e telekomunikimeve dhe në mënyrë që tregu i telekomunikacionit në Kosovë të jetë në shërbim të qytetarëve e jo në shërbim të, në këtë rast, interesave të Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me çështjen e shtruar për interpelancë.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë besoj se për të gjithë ne është e qartë, se kodi ndërkombëtar telefonik i Kosovës ka rëndësi të madhe shtetërore, sepse i jep Kosovës sovranitet ndërkombëtar në sektorin e telekomunikacionit dhe përbën një prej simboleve të rëndësishme për vendin dhe për shtetin tonë.

Kosova në Bruksel në dialog me Serbinë ka arritur marrëveshjen për telekomunikacionin, e cila i siguron Kosovës kodin telefonik shtetëror. Derisa ne po diskutojmë sot këtu, në Bruksel ministrja jonë për dialog, Edita Tahiri, po merr pjesë në bisedat për implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Kosova do ta ketë kodin e vet telefonik shtetëror nga ana e ITU, Unitetit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve, dhe ky kod do të jetë 383. Ky do të jetë një lajm i mirë për të gjithë ne, për qytetarët e Kosovës, për institucionet e Republikës së Kosovës. Ndërkaq, kodi shtetëror i Kosovës do ta bëjë Kosovën me kod të vetin telefonik duke u dhënë fund tre kodeve ekzistuese: 377, 386 dhe 381.

Marrëveshja për telekomunikacion e arritur në Bruksel në shtator të vitit 2013 është një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga tre palë, nga Republika e Kosovës, nga ajo e

Serbisë dhe nga Bashkimi Evropian, përkatësisht nga dy kryeministrat e dy shteteve dhe përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian.

Ndërsa, më 25 gusht të vitit 2015 është nënshkruar plani i veprimit për zbatimin e marrëveshjes për telekomunikacionin, nga kryeministrat e dy shteteve dhe nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian. Kjo marrëveshje, si dhe të gjitha të tjerat në dialogun e Brukselit, janë arritur në një bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë, me Bashkimin Evropian, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat njëherësh janë edhe garantuese për zbatimin e plotë të këtyre marrëveshjeve, në këtë rast të kësaj marrëveshjeje, nga të gjitha palët.

Marrëveshja për telekomunikacionin derivon nga marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve e datës 19 prill 2013 dhe baza e saj ligjore, po ashtu derivon nga Ligji për ratifikimin e marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve, e cila është miratuar në këtë Kuvend me mbi 2/3-at e votave.

Me këtë marrëveshje Republika e Kosovës ka forcuar sovranitetin shtetëror dhe integritetin e saj territorial dhe ka avancuar pozicionin e saj ndërkombëtar, sidomos në fushën e telekomunikacionit, me faktin se Organizata Ndërkombëtare e Telekomunikacionit do t'ia alokojë Kosovës kodin e saj telefonik ndërkombëtar, jo Serbia, por Organizata Ndërkombëtare e Telekomunikacionit.

Austria tashmë ka aplikuar në janar të këtij viti, në emër të Kosovës, për të kërkuar nga ITU të ndajë kodin telefonik Kosovës. Arsyeja pse është dashur Austria të aplikojë, lidhet me faktin se Bashkimi Evropian pas shqyrtimit të të gjitha mundësive ligjore dhe politike, që Kosova ta marrë kodin e saj telefonik nga ITU-ja, ka ardhur në përfundim se në këtë mënyrë mund të largoheshin pengesat, sepse Kosova ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Ndërkaq, pengesat që mund t'i bënte Serbia janë hequr përmes marrëveshjes së Brukselit për telekomunikacionin.

Kosova do të ketë të gjitha të drejtat shtetërore, që të administrojë me kodin e vet telefonik, sikurse të gjitha shtetet tjera. Autoriteti Rregullator i Kosovës, ARKEP, do të bashkëpunojë me ITU-në për realizimin e kodit telefonik për Kosovë. Në këtë rast do të hapen rrugët e bashkëpunimit institucional në mes Republikës së Kosovës dhe ITU-së, që do të kontribuojë në forcimin e pozicionit ndërkombëtar të shtetit tonë.

Marrëveshja për telekomunikacionin kontribuon në normalizimin e gjendjes në sektorin e telekomunikacionit, sepse shuhet të gjithë operatorët ilegalë të telefonisë mobile e fikse të Serbisë në Kosovë, për herë të parë pas përfundimit të Luftës në Kosovë, në vitin '99.

Do të ofrohet një lejim i përkohshëm për një fushëveprim të kufizuar, për një kompani të re, që është regjistruar në Kosovë dhe e cila do të veprojë sipas ligjeve të Kosovës. Ky nuk do të jetë një operator i tretë mobil në Kosovë, sepse për një gjë të tillë duhet të bëhet tenderim ndërkombëtar, me konkurrencë shumëpalëshe, ashtu siç e përcakton ligji i Republikës së Kosovës. Ky lejim i përkohshëm për këtë kompani do të vlejë deri në hapjen e tenderit ndërkombëtar për operatorin e tretë të telefonisë mobile në Kosovë.

Do të jetë, po ashtu, një marrëveshje roamingu dhe e interkoneksionit në mes dy shteteve, përkatësisht në mes operatorëve të telefonisë mobile të dy shteteve, për të ulur çmimet e shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e të hyrave të përgjithshme për vendin tonë. Zgjidhen pengesat për kalimin e transmetimit nga ai analog në atë digjital, ku Republikës së Kosovës i hapet rruga për mbulimin adekuat të tërë territorit të vendit tonë, pa asnjë pengesë. Marrëveshja e Brukselit për telekomunikacionin mundëson vendosjen e kufirit të telekomunikacionit dhe brezit frekuencor ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, duke i dhënë fund ndërhyrjes ilegale dhe uzurpimit të pjesëve të brezit frekuencor nga Serbia.

Vendosja e kufirit ndërshtetëror në telekomunikacion, mundëson po ashtu, që Kosova të realizojë programin e digjitalizimit sipas standardeve ndërkombëtare, duke u bërë një vend kompatibil dhe konkurrent në rrjedhat bashkëkohore të telekomunikacionit botëror.

Po ashtu, kjo marrëveshje hap rrugën e anëtarësimit të Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Telekomunikacionit në kuadër të synimeve tona strategjike, që shteti ynë të bëhet anëtarë e BE-së, anëtarë e NATO-së dhe anëtarë e Organizatës së Komeve të Bashkuara, si anëtarë e organizatave tjera ndërkombëtare.

Përfitimet ekonomike janë të mëdha, pasi që operatorët në radhë të parë nuk do të jenë të detyruara të paguajnë kosto të larta financiare, të cilat direkt i atribuohen mungesës së kodit e që reflektohen edhe me ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe më të lira ndaj konsumatorit. Kostot e përgjithshme të shkaktuara deri më tani nga mungesa e kodit telefonik arrijnë shifrën prej mbi 200 milionë euro dhe tani këto humbje do të përkthehen në përfitime financiare. Po ashtu, kjo marrëveshje hap rrugë për arritjen e marrëveshjes ndërshtetërore në fushën e shërbimeve postare në mes dy vendeve.

Dëshiroj të përkujtoj, se Qeveria e Republikës së Kosovës është angazhuar, që në bashkëpunim me Shqipërinë të realizojë Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për të marrë kodin e përbashkët me Shqipërinë 355, mirëpo pas angazhimeve të shumta të Qeverisë së Shqipërisë, që të arrihet ky qëllim, ITU-ja nuk e ka miratuar një kërkesë të tillë.

Jam informuar se Kuvendi është i njoftuar zyrtarisht lidhur me këtë çështje, megjithatë për ata të cilët shtrojnë pyetje e dilema në këtë drejtim, duhet ta kenë të qartë se ka ekzistuar vullneti për të implementuar Rezolutën e Kuvendit, por kjo rezolutë nuk e obligon edhe ITU-në dhe nuk e obligon as Shqipërinë, prandaj zgjidhja është të respektojmë marrëveshjen për telekomunikacionin dhe ligjin, të cilin e ka aprovuar Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në përfundim, më lejoni të theksoj se dialogu dhe marrëveshjet e Brukselit kontribuojnë për paqe, fqinjësi të mirë dhe stabilitet rajonal, duke i dhënë fund ndërhyrjes së Serbisë në Kosovë përmes shuarjes së strukturave paralele në veri të vendit dhe heqjen e pengesave për integrimin e serbëve në sistemin shtetëror të Kosovës.

Marrëveshjet janë me dobi politike, me dobi ekonomike dhe me dobi të sigurisë dhe përmirësojnë mirëqenien dhe stabilitetin në vendin tonë.

Politikat e fqinjësisë dhe të bashkëpunimit rajonal janë pjesë e rëndësishme e politikës së jashtme të Kosovës në kuadër të vizionit tonë euroatlantik për shtetin e Kosovës. Duke dëshmuar vizionin tonë në praktikë, nëpërmjet reformave evropiane dhe dialogut për fqinjësi të mirë, ne arritëm që Kosova të hapë kapitullin zyrtar të integritetit evropian, duke e nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim.

Kosova së shpejti do ta ketë mundësinë që t'u sigurojë qytetarëve të saj lëvizje të lirë pa viza, por po ashtu edhe për këtë duhet të kemi kurajën, të gëmi guximin dhe të marrim vendime në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Sa i përket rezolutës, të propozuar nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, mendoj se ajo duhet të shndërrohet në tekst përkrahjeje për Marrëveshjen për telekomunikacionin, përkatësisht për kodin telefonik të arritur në Bruksel dhe përkushtimin tonë që ne të zbatojmë Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së parë, i cili është aprovuar nga ky Kuvend i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Tash do të dëgjojmë paraqitjen e deklaratave në emër të grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Besim Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Është diskutuar shumë herë në Kuvend çështja e kodit shtetëror dhe alternativave të cilat duhet t'i ketë shteti ynë, në mënyrë që të ofrojë shërbime sa më të përballeshme dhe sa më cilësore në fushën e telekomunikimit.

Ky kod shtetëror, siç u tha edhe nga ana e kryeministrit, është i lidhur ngushtë me anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe dua të them se ka pasur komunikime me ITU-n, ka pasur angazhime me Shqipërinë në drejtim të gjetjes së rrugëve ligjore që një kod i tillë të merret, si dhe për zbatimin e rezolutës, e cila është aprovuar nga ky Kuvend.

Ajo rezolutë, përveç angazhimit që ka paraparë për Qeverinë, ka prodhuar edhe një trup - komision parlamentar, i cili, së bashku me Qeverinë, kanë bërë takime edhe në Shqipëri dhe kanë pasur mundësinë e diskutimit rreth bazës ligjore dhe rreth asaj që një rezolutë e njëanshme të një Kuvendi a mund të jetë vendimtare për të marrë një kod shtetëror për një shtet tjetër.

Sa i përket kodit shtetëror, për të cilin ne po flasim, unë dua të shtroj qëndrimin e grupit, ku ky kod do të na mundësojë të kemi trafik të drejtpërdrejtë. U tha edhe këtu, dhe në dokumentacion kemi thënë se kush është pronari i kodit, por unë dua t'ju them për qytetarët dhe për të gjithë të pranishmit se ky kod do të mundësojë që trafiku ndërkombëtar i telekomunikacionit të shkojë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Kosova dhe drejt vendit tonë.

Deri më tani ky trafik është bërë përmes Monakos, Sllovenisë dhe Serbisë. Pra, po hiqet mundësia e trafikut nëpër Serbi përmes kodit shtetëror, të cilin ne duhet ta marrim.

Pra, Kosova me kod shtetëror bëhet subjekt i trafikut ndërkombëtar dhe bëhet pjesë e rëndësishme e të gjitha zhvillimeve në të ardhmen sa i përket ITU-së.

Për më tepër, Kosova ka rregullatorin e vet ARKEP, i cili ka për obligim të rregullojë tarifat, t'i japë frekuencat e brezave frekuencore, të cilat duhet të jepen në shfrytëzim për operatorët e telefonisë, i cili përcakton kufirin e telekomunikacionit, i cili bën licencimin e të gjitha atyre kompanive që dëshirojnë të operojnë dhe bën monitorimin e aktiviteteve të drejtpërdrejta të kompanive të komunikimit.

Pra, kemi një rregullator, i cili në mënyrë sovranë rregullon tërë procedurën dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjshmërisë në Kosovë sa i përket telekomunikimit të Kosovës brenda dhe jashtë.

Pra, çdo ndërmarrje e regjistruar në Kosovë është ndërmarrje e cila parimisht, jo vetëm se operon në Kosovë, por është edhe e obliguar t'i respektojë të gjitha ligjet e Kosovës.

Për më tepër, efektet financiare të një marrëveshjeje të tillë, efektet ekonomike janë të shumta. Qytetarët tanë, tarifat të cilat nganjëherë i kanë pasur më të larta se sa tarifat nëpër vendet e tjera, përmes kodit telefonik shtetëror do të kenë mundësi që të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo të paguajnë taksa të ndryshme për shfrytëzim të kodeve të tjera.

Pra, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ne e përkrahim Qeverinë në marrjen sa më të shpejtë dhe vendosjen sa më të shpejtë të rregullave përmes rregullatorit dhe funksionimin e plotë të kodit shtetëror, sepse kjo do të jetë një ngjarje e madhe për shtetin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër Mustafa,

Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës sigurisht se mirëpret çdo diskutim që do të duhej të ishte në interesin e vendit.

Megjithatë, konsiderojmë se çështja e kodit ndërkombëtar, kodit shtetëror, pra telefonik të Kosovës, është në rrugë të mbarë të zgjidhet përmes dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel dhe sot si temë nuk është ajo që mund ta zgjedhim këtu, të debatojmë e të flasim, mund të kemi dëshira të njëanshme, por fatkeqësisht të pa realizueshme në mënyrën se si janë paraqitur nga vetë kërkuesit e kësaj interpelance.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për përfitimet nga kodi ndërkombëtar telefonik për Kosovën nuk po flas, e tha kryeministri Mustafa, por ky kod telefonik nuk është çështje që mund të zgjidhet me vullnete e dëshira të njëanshme. Kjo është çështje, pse jo, ndërkombëtare, sepse ne duhet të kemi përkrahje nga ata që janë kompetentë dhe ku dëshirojmë të bëhemi pjesë integrale e tyre.

Duke qenë të vetëdijshëm se çështja e kodit telefonik është pjesë e dialogut në Bruksel dhe sigurisht se së shpejti priten rezultate pozitive në këtë drejtim për ta pasur kodin telefonik, kodin e vet, pra Kosova ta ketë kodin shtetëror nga ITU dhe ky kod, siç u tha, do të jetë 383 dhe pa dyshim se nuk mund të injorohet ky si një rezultat dhe si një lajm i mirë për të gjithë qytetarët tanë.

Pra, kodi do të fitohet si rezultat i dialogut dhe marrëveshjeve në Bruksel.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah veprimet dhe angazhimet konkrete, të cilat po i ndërmerr Qeveria në sigurimin e këtij kodi shtetëror.

Po ashtu, konform kësaj përkrahim edhe qasjen e vetë kryeministrit dhe kabinetit qeveritar rreth punës që ka të bëjë me sigurimin e këtij kodi telefonik, dhe konsiderojmë se rekomandimet pikërisht prej Kuvendit do të duhej të ishin në këtë drejtim dhe të përkrahjes së kësaj, që është në interes të vendit dhe të përmbillet sa më shpejt me sukses edhe ky proces, gjithmonë në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Pa dyshim se çdo qasje tjetër, për mendimin tonë, shpreh bindjen se nuk i kontribuon realizimit të kësaj të drejte që është shumë afër të bëhet realitet. Çdo qasje tjetër është ndoshta një, të themi pse jo, politikë ditore, populliste, por pa efekt ose e padobishme, e pamundësisë së realizimit në aspektin e interesave, në këtë rast shtetëror, dhe pa mbështetje të atyre që bashkë me Qeverinë tonë po punojnë dhe janë afër realizimit dhe bërjes realitet, pra që me dialogun që po zhvillohet në Bruksel Kosova të sigurojë kodin e vet telefonik. Kod ky, të them edhe një herë, i pranuar, sepse është shumë e qartë se kjo nuk është çështje e brendshme, vetëm e brendshme, nuk është çështje në mes dy shtetesh në këtë rast, sikur që u tha, Kosovës e Shqipërisë, sepse sqarimet u dhanë pse kjo nuk mund të bëhet ashtu siç ka qenë edhe më herët e përcaktuar dhe shprehur në dëshirë dhe vullnet tonin në rezolutën e mëhershme të miratuar, sepse gjërat janë të qarta. Kjo mund, do të bëhet dhe do të zgjidhet vetëm me dialogun në Bruksel, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Jo ndryshe, kjo nuk është punë, edhe një herë po e përsëris, dëshire, por është punë realiteti, mundësie dhe përkrahjeje.

Ne besojmë thellë që së shpejti do të kemi këtë kod shtetëror telefonik dhe kjo temë do të përmbillet në të mirën e vendit dhe me këtë të kemi edhe një temë më pak, pse jo, ditore politike, kuaziprofitabile, partiake nga kushdo qoftë.

Pra, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i përkrah angazhimet dhe veprimet që po i bën Qeveria që të kemi sa më shpejt kodin telefonik nëpërmjet dialogut që po bëhet në Bruksel dhe urojmë kjo të ndodhë sa më shpejt, pse jo, edhe gjatë këtyre ditëve. Faleminderit, zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Tash janë dy të “Vetëvendosjes”. Në emër të Grupit, kush do fjalën? E ka fjalën Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit!

Në fjalën e tij të mëparshme kryeministri nuk e di sa herë, nuk i numërova saktë, por shumë herë iu referua marrëdhënieve shumë të mira me Serbinë, të cilat po përmirësohen vazhdimisht, të

fqinjësisë së mirë, që është qëllimi i Qeverisë së Kosovës për këto marrëdhënie të mira me Serbinë, kurse ne mbrëmë, hiq më larg, e kemi arrestimin e drejtorit rajonal të policisë për rajonin e veriut nga Serbia, hiq më larg se mbrëmë, në orën 8, dhe asnjë fjalë këtu nuk u tha as nga kryeministri për këtë ngjarje, as nga ministri i Punëve të Jashtme.

Unë prita bile prej tyre që përpara deklaramit të pikave jashtë rendit të ditës, të deklarohet qoftë kryeministri, qoftë ministri i Punëve të Brendshme për këtë normalizim kaq të shkëlqyeshëm të marrëdhënieve që i paskemi me Serbinë, e cila na e kthen neve këtë mirësi dhe këtë dashamirësi të kryeministrit dhe të Qeverisë tonë me arrestime të autoriteteve më të larta të Policisë së Kosovës dhe me çfarë aktakuza se, me aktakuza për terrorizëm, vetëm pse kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kjo është fqinjësia e mirë me Serbinë, ky është normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë deri më tash.

Sa i përket telefonisë, telefonja hiq nuk është më mirë se këto që po na ndodhin, me arrestimet që po i bën Serbia. Pra, gjithnjë ka qenë një rrugë shumë e qartë e Kosovës për t'iu qasur kodit të pavarur të telefonisë në Republikën e Kosovës. Kjo rrugë ka qenë anëtarësimi i Kosovës në ITU.

Dhe, Qeveria e Kosovës, dhe të gjitha qeveritë prej vitit 2001, ato deri në vitin 2008 e kanë pasur arsyetim UNMIK-un. Domethënë, nuk jemi të pavarur, jemi administratë, e cila qeveriset nga një mision i huaj, por prej vitit 2008 të gjitha këto tri qeveritë, e treta është kjo me radhë që e kemi këtu ulur, e kanë parë si arsyetim që nuk mund të anëtarësohemi në ITU, sepse nuk jemi anëtar i Kombeve të Bashkuara.

Sa për ashtu, nuk është dashur të konkurrojmë as në UNESCO, apo me arsyetimin që na lufton Serbia, që Serbia e pamundëson anëtarësimin tonë nëpër këto organizata. Ne e kemi ditur gjithmonë që Serbia do ta pengojë anëtarësimin tonë në këto organizata.

Atëherë shtrohet pyetja, pse në disa kemi konkurruar, duke e ditur se Serbia nuk pajtohet e do të na luftojë, e në disa të tjera ka pasur marrëveshje xhentëlmene me Serbinë që të mos konkurrohet në ato organizata.

Përgjigjen mund ta gjeni, dhe nuk e di bash saktë, te cilët zyrtarë politikë, të cilëve u ka konvnuar që prej vitit 1999 Serbia të përfitojë qindra miliona euro, bash qindra miliona euro, nga kjo varësi e telefonisë së Kosovës, e cila ka qenë nën tutelën e plotë dhe nën hapësirën, apo të themi, nën ombrellën e plotë të telefonisë, e cila ka qenë e kontrolluar nga Serbia.

Pra, ashtu sikur u përmend prej Visar Ymerit këtu më herët, kushtetuta e ITU-së, neni 2, pika c e mundëson për të pasur kod telefonik të pavarur edhe ato vende, të cilat ende nuk janë anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Qeveria e Kosovës kurrë nuk e ka aprovuar këtë rrugë. Nuk e di pse. Nuk e di kujt i ka konvnuar, e me siguri do të zbulohet më vonë se kujt i ka konvnuar.

Tjetra është që këta gjithmonë e kanë ditur se ekziston kjo mundësi dhe kanë hyrë në negociata me Serbinë si rrugë për ta fituar në kodin tonin të pavarur të telefonisë mobile.

Mirëpo, a e dini cili është kompromisi kryesor i kësaj rruge, që e ka zgjedhur Qeveria e Kosovës? Unë do të thosha, me një çmim shumë të madh. I bindur jam se nuk ia ka vlejtur, nëse kjo është rruga e vetme.

Cili është çmimi shumë i madh? Operatori i telefonisë serbe në Kosovë. Shikoni, kryeministri na tha më herët që janë zhdukur operatorët ilegalë. Unë nuk pajtohem me deklarin e tij. Unë mendoj se janë legalizuar operatorët ilegalë.

Nëse operatori i Serbisë deri tash ka vepruar në mënyrë ilegale, këta e kanë nxjerrë tash e tutje marrëveshjen në Bruksel që kompania e re e telefonisë mobile që do të hyjë në Kosovë, e cila do të jetë e Serbisë, tash do të veprojë në mënyrë legale në Kosovë. Ky është kompromisi.

Tash dikush do të thoshte, ka qenë rruga e vetme. Unë nuk pajtohem se ka qenë çmimi që është dashur ne ta paguajmë. Është çmim shumë i madh, i papërballueshëm për Kosovën. Pse? Sepse, telefonia, prefiksi ndërkombëtar i pavarur, kjo është predispozitë e sovranitetit. Kjo nuk mund të ndahet me asnjë shtet.

Ne po hyjmë tash edhe në probleme politike përmes kësaj. Ju mund të thoni: po shikoni, ky është kod i pavarur. Kjo është njësoj sikur të thuhet se edhe me Rezolutën 1244 Kosova i ka pasur kufijtë e vetë. Kosova i ka pasur kufijtë e vet, por do të shtrohet pyetja çfarë kufijsh? Edhe me këtë kod do të jetë 383, nuk do të jetë 381. Mirë, po cili është statusi i këtij kodi? Kjo është më e rëndësishme. Kjo është tema dhe argumenti për të cilin duhet të flasim, jo ajo që u tha prej Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të LDK-së, e as nga kryeministri.

Pra, atë që e ka fituar Kosova, nën thonjëza, atë që e ka fituar është degradimi i tregut të telekomunikacionit në Kosovë.

Merreni, për shembull, edhe nëse e analizoni planin e veprimit dhe komentet e ARKEP-it që mund t'i gjeni në planin e veprimit. Unë po e lexoj vetëm pikën 1.6, pra vetëm pikën 1.6 të raportit që ka të bëjë me planin e veprimit. Aty thuhet: "ARKEP-i duhet të përkujdeset që në planin e ri të numeracionit të mos ketë mbulim, anglisht "overlev", të planeve nacionale të numeracionit në mes të palëve, dhe që konsumatorët e kompanisë së re, do të thotë të këtij operatori të Serbisë që po lejohet tash të hyjë në Kosovë që të mund të telefonojë në Serbi pa prefiksin ndërkombëtar. Pra, thirrjet prej kësaj kompanie të operatorit të Serbisë me Serbinë nuk do të jenë ndërkombëtare.

Pra, në emër të kësaj, krejt hapësira telefonike e Kosovës po futet në një bashkëveprim me telekomunikacionin e Serbisë, në të cilin shkëmbimet mes tyre nuk do të jenë ndërkombëtare. Kjo është shumë me rëndësi. Kjo nuk mund të fshihet.

Prej Qeverisë thuhet: jo, kurrë nuk ndodhi! Shikoni, ky është problem shumë serioz. Shkëmbimet në mes të Serbisë dhe Kosovës të mos jenë ndërkombëtare! Kjo është sikur puna e pasaportës. Bash sikur puna e pasaportës. Marrëveshjet po e ndjekin të njëjtën linjë, të njëjtën

logjikë, që në Serbi të mos ketë nevojë të përdoret pasaporta, vetëm letërnjoftimi, se ky është qarkullim i brendshëm. E njëjta logjikë edhe me telekomunikacionin. Ky është shkëmbim i brendshëm në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Nëse ju e thirrni Serbinë, nuk keni nevojë ta thirrni me prefiks ndërkombëtar, kur serbët thërrasin në Serbi, sepse në emër të kësaj krejt Kosova po futet në këtë që shkëmbimet të mos jenë me prefiks ndërkombëtar. E kur e thërrisni Maqedoninë, kur e thërrisni Slloveninë, kur e thërrisni Kroacinë, ato janë thirrje ndërkombëtare, po jo e njëjta me Serbinë.

Atëherë, pse ky dallim? Çka na duhet dhe çka tregon ky dallim, në fund të fundit? Po tregon se diçka prej sovranitetit po rrjedh. Po rrjedh diçka prej shtetësisë. Po rrjedh diçka prej sovranitetit. Nuk është e fiksuar si me vendet e tjera. Po kemi zgjidhje sui generis.

Të gjitha këto duhet të shtrohen, e jo të fshihen, qysh po thotë kryeministri në fjalimin e tij.

Pra, konsumatorët e operatorëve të Kosovës telefonojnë në Serbi duke përdorur 381, mirëpo konsumatorët e kompanisë së re telefonojnë në Serbi pa kod ndërkombëtar.

Kjo e krijon situatën asimetrike të trajtimit nga ana e të gjithë serbëve në Kosovë e në Serbi, se mbetet një rrjet nacional, pra në të cilin veprojnë të dy telekomunikacionet.

Së dyti, Telekomit të Serbisë i është dhënë ajo që quhet “full-llajsens”, domethënë licencë e plotë për mobil dhe fiks, që është degë e operatorit qendror në Serbi dhe ky operator do të përdorë asetet publike të Republikës së Kosovës. Tash ky është halli im, se kjo po përdor asete publike. Ky operator po përdor pasuritë tona publike për të krijuar shërbime, të cilat do të jenë nën ombrellën e Telekomit të Serbisë.

Pra, këto pse janë të rrezikshme? Se e lënë derën çelë të negociohen edhe disa pasuri të tjera publike. Serbia tash, në negociata, do të thotë: nëse shqiptarët, nëse Kosova, autoritetet e Kosovës janë të gatshme të negociojnë frekuencat ajrore, që janë pasuri e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pse nuk qenka e mundshme të negociohet për Trepçën. Nëse negociojmë për ajrin, pse nuk është e mundshme të negociojmë për minerale.

Nëse Kosova është e gatshme të bisedojë për frekuencat ajrore, që janë të sovranitetit shtetëror, pse nuk është e mundshme të bisedohet dhe hapen negociata për ujin, për Ujmanin, për “Trepçën”. Domethënë, tash do të na vijë ky presion prej Serbisë. Ata nuk ia huqin kurrë për të bërë presion kur kanë penallti, kështu qysh po bën Qeveria e Kosovës. Ata gjithmonë i kanë shfrytëzuar këto penallti. Pra, pse po ia leni Serbisë derën çelë, me këto gabime?

Edhe një çështje në fund. Telekomit të Serbisë, përmes kësaj që ia keni mundësuar, a e dini ju që mund të shfrytëzojë edhe shërbime televizive? Nuk i ka shkuar në mend kjo Qeverisë së Kosovës.

Kush e rregullon aspektin medial? Sepse, mos harroni, se kjo, nëpërmjet shërbimeve që janë të integruara në rrjet, e sidomos në atë mobil, është mundësi.

Te ne këtë e rregullon KPM, pra i rregullon operatorët e radio-televizioneve me radio-difuzion dhe ato që janë të modalitetit kabllor.

Operatorët që punojnë me IPTV nuk i trajton, pasi që nuk janë të listuar me ligjin që e përfshin edhe KPM-në.

Pra, të gjitha këto po fshihen nga Qeveria e Kosovës dhe kjo nuk është mirë, nuk i kontribuon transparencës publike, përkundrazi këto janë dështime të Qeverisë së Kosovës, të cilave nuk u është dhënë përgjigje dhe zgjidhje e duhur, prej të cilave do të lëngojë, mendoj, në të ardhmen telekomunikacioni i Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, cili e do fjalën? Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar.

E kam një shpjegim, le të dihet. Kjo është koha juaj, njëri mund ta shfrytëzojë krejt. Domethënë, s'ka kufi, është koha juaj, sikur Glauku që foli 13 minuta. Pra, është koha juaj, mos e ndërprisni, mund të flisni sa të doni.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Media dhe gjithë ju të pranishëm,

Kur e dëgjoj kryeministrin e Kosovës, zotin Mustafa, mendoj që vërtet ne kemi një shtet që duhet të na ketë lakmi çdo qytetar i Evropës apo i tërë rruzulli tokësor.

Por, në praktikë, është e kundërta.

E them këtë se jemi mësuar me refrenin që çdo marrëveshje që nënshkruhet nga zonja Tahiri është në të mirën e Kosovës. M'i numëro, zoti kryeministër dhe Kabinet qeveritar, një nga një, cilat janë ato të mira që i ka përfituar qytetari i Kosovës apo që është forcuar shteti i Republikës së Kosovës?

Dhe, lind pyetja tani: Edhe me këtë marrëveshje të telekomunikimit, a thua prapë, sikur që e dëgjuam kryeministrin e Kosovës dhe grupet parlamentare të LDK-së dhe të PDK-së, Kosova prapë është shteti që askënd nuk e pyet.

Por, në realitet, pse diskutohet atëherë në Bruksel për pasuritë e Kosovës? Pse atëherë i jepet në shfrytëzim e tërë infrastruktura e Kosovës për telekomunikim. Pse e bëni pjesëmarrëse Serbinë në këtë marrëveshje dhe ajo që mund të them para qytetarëve dhe para jush, dita-ditës shtetësia e Kosovës po zbehet me këto marrëveshje që mendoj që u keni hyrë pa ndonjë platformë politike, pa ndonjë caktim kohor dhe pa ndonjë impakt për qytetarët dhe për shtetësinë e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Marrëveshja për telekomunikimin, e emëruar si plan aksionar, në mënyrë të qartë definon se rregullimi i telekomunikacionit në Republikën e Kosovës sipas ligjeve të Kosovës kalon në rregullimin e përbashkët të Kosovës dhe Serbisë.

Kompetencat e Rregullatorit të Kosovës u kalojnë grupeve të përbashkëta të rregullatorëve të Kosovës dhe të Serbisë, e të cilat me këtë plan aksional do ta rregullojnë gjithë sektorin e telekomunikacionit duke përfshirë telefoninë fikse, mobile, spektrin frekuencor, transmetimin televiziv e të tjera.

Marrëveshja në mënyrë të qartë e definon krijimin e një kompanie të re, kompani degë e Serbisë, që do të regjistrohet në përputhje me kornizën rregullatore të Kosovës.

Marrëveshja parasheh që të gjitha asetet t'i transformohen kësaj kompanie, e cila do t'i ketë të gjitha të drejtat e operimit.

Në këtë mënyrë, gjendja ekzistuese, infrastrukture në veriun e Kosovës dhe në disa pjesë tjera të saj kornizohet me legjitimitetin si pjesë e Serbisë.

Marrëveshja për kodin nuk precizon se është fjala për kod shtetëror apo territorial që e keni dëgjuar edhe nga përfaqësuesit e Serbisë.

Për shkak të jotransparencës së palës kosovare nuk është sqaruar kjo pikë, derisa zyrtarët shtetërorë të Serbisë kanë qartësuar se flitet për kod gjeografik që i jepet Kosovës nëpërmjet Serbisë.

Është e qartë se kjo marrëveshje e legalizon uzurpimin e infrastrukturës telekomunikuese në veriun e Kosovës dhe operimi i mëtutjeshëm i lihet në duart e kompanisë së Serbisë duke e bërë pronare dhe duke ia dhënë të drejtën legale të operimit.

Zoti kryeministër,

Prandaj ju kishim lutur si grup parlamentar që të keni kujdes dhe këtë sovranitet që është fituar me djersë e gjak dhe me ndihmën e ndërkombëtarëve të mos ia servojmë diku që nuk e meriton. Ne do të ju përkrahim çdo herë kur është në të mirën e forcimit të shtetit, në të mirën e qytetarëve, por mos pritni që në këto marrëveshje që pothuajse është bërë praktikë që me një telefonatë mund të shkoni dhe të harxhoni mjete të qytetarëve, djersën e qytetarëve, dhe të mos i ktheni në të mirën e qytetarëve, por në të keqen e tyre.

Prandaj, ne nuk do të ju përkrahim në këto marrëveshje që janë në dëm të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lekaj! Për Grupin Parlamentar “Nisma”, deputeti Enver Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Tanimë është bërë e qartë se marrëveshjet dhe bisedimet që janë duke u zhvilluar në Bruksel vetëm po prodhojnë krizë në secilën fushë dhe në secilën marrëveshje Kosova po humb shumë

dhe për pasojë u tha dhe duhet të përsëritet se edhe marrëveshja për telekomunikimin po shkon nëpërmjet Serbisë dhe atë vetëm si hapësirë gjeografike dhe pronar do të mbetet Serbia.

Pasojat e marrëveshjes janë tepër të mëdha dhe jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në aspektin politik, si dhe në aspektin e sigurisë kombëtare, që këto tema shumë të ndjeshme është dashur të trajtohen shumë më herët nga institucionet e Kosovës, në mënyrë që të bëjnë zgjidhje dhe të mos lejojnë që Kosova, një vend kaq i vogël, t'i ketë tri kode telefonike të shteteve të huaja, siç janë Monako e Telekom, Telekom i Sllovenisë, si dhe operimi ilegal i Telekomit të Serbisë që i ka shkaktuar dëme të larta ekonomike e të sigurisë kombëtare të shtetit të Kosovës.

Kosova deri më tani, në mungesë të kodit telefonik, sipas disa prej ekspertëve, llogaritet që i ka humbur diku në mes 600 deri në 800 milionë euro, pavarësisht se ARKEP e jep një shifër më të vogël, pra rreth 220 milionë euro.

Marrëveshja e fundit në Bruksel me kushtëzimin nga pala serbe e rëndon dhe cenon rëndë sovranitetin e shtetit në segmentin ekonomik, politik dhe atë të sigurisë kombëtare, e cila është edhe e dënueshme me Kushtetutën e Kosovës.

Është e papranueshme marrëveshja e fundit, kur pala e Kosovës ka pranuar kompromis politik që të legalizohet përmes autorizimit të përkohshëm kjo paligjshmëri.

Të nderuar, kjo nuk është asgjë tjetër përpos agresion në sovranitetin e Kosovës përmes rrjetit të telekomunikacionit që për pasojë dëmton edhe më shumë operatorët e licencuar, sidomos ata publikë, Vala dhe Telekom.

Ne konsiderojmë se kjo marrëveshja e arritur në Bruksel duhet të mos fillojë të zbatohet pas sanimit e dëmeve financiare për vitet e kaluara, si dhe pa licencimin e operatorit të tretë.

Në asnjë rrethanë, autorizimi i përkohshëm s'ka bazë ligjore, madje ARKEP s'ka mandat as autorizim ligjor të lëshojë për askënd licencat e përkohshme për operatorë të telefonisë.

Nëse ndodh diçka e tillë, atëherë këtu kemi të bëjmë vetëm me legjitimitetin e shtetit të Serbisë përmes strukturave paralele serbe të operimit të saj në sistemin e telekomunikacionit si segment kyç në shtetbërje.

Ne si "Nismë për Kosovën" kërkojmë që të anulohet marrëveshja e tillë dhe që të aplikohet një kod telefonik shtetëror pa asnjë kusht dhe kushtëzim nga asnjë shtet, e për më pak nga Serbia.

Prandaj, ne edhe këtu duhet të pyesim edhe një herë se deri kur do të shtrihet në aspektin territorial të Kosovës shteti serb përmes operatorit të saj të përkohshëm në Kosovë?

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Unë dua t'i shtroj 2-3 çështje. Një pyetje për kryeministrin, pse duhet që të bisedohet me Serbinë për kodin telefonik kur kjo është çështje e raporteve mes Kosovës dhe ITU-së?

Tjetra është që kryeministri dhe deputeti Beqaj kanë thënë se kanë biseduar me Republikën e Shqipërisë për kodin telefonik, e këtë nuk e vërteton asnjë dokument zyrtar dhe unë do të shtroja pyetjen, me kë keni biseduar kryeministër, kur keni biseduar dhe pse nuk e keni informuar Kuvendin për këto bisedime, por e dezinformoni opinionin në kohën kur Lëvizja “Vetëvendosje” shtron një çështje për ta diskutuar.

Për ta menaxhuar këtë sektor ekonomik ka një potencial, mirëpo është menaxhuar jashtëzakonisht keq ky sektor dhe ne kemi humbje diku rreth 250 milionë euro nga buxheti, e këtë e tha në njëfarë mënyre edhe vetë kryeministri. Këto humbje janë më të mëdha sesa të gjitha fitimet që janë bërë nga privatizimi në Kosovë dhe shkaktarë për këtë janë të gjithë kryeministrat, duke filluar nga kryeministri i parë tek OKB-ja, pastaj deri tek kryeministri Mustafa, të cilët e kanë dëmtuar jashtëzakonisht shumë Telekomin në Kosovë.

Unë kërkoj nga kryeministri që të përgjigjet në fjalën e tij rreth pyetjeve që i shtrova. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë jua tërheq vërejtjen, sepse janë disa, më duhet të ju them që “Nisma” i ka edhe 5 minuta, AAK-ja i ka 6 minuta, “Vetëvendosje” i ka 10 minuta, që t’i pjesëtoni nëse doni të flisni më shumë, përndryshe është çështje juaja.

Fjalën e ka Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kjo interpelancë e kryeministrit për sot për kodin telefonik dhe për veriun e Kosovës mbahet në një kohë të rëndë për vendin.

Këtë javë Banka Botërore e publikoi raportin për Evropën Juglindore, ku konstatoi një rënie të theksuar të investimeve të huaja direkte, papunësi të madhe, sidomos në radhët e të rinjve, largimi i fuqisë punëtore nga Kosova, rritja e importit dhe tkurrja e arritjes ekonomike.

Qeveria jonë mund të mburret me shifrat pozitive në rritjen ekonomike, por me 3% rritje vjetore është më se e qartë se nuk do të ketë vende të reja punës, nuk do të ketë investime të huaja, nuk do të ketë fuqizim dhe prodhimtari vendore, si rrjedhojë jeta e qytetarëve të Kosovës do të përkeqësohet.

Kosova me një ekonomi të dobët vazhdon të humbë qindra miliona euro, sepse nuk e ka një kod të vetën telefonik për shkak të bllokadës nga Serbia.

Edhe pse në vitin 2013 është arritur marrëveshja për Telekomin, në vitin 2015 është bërë një plan aksionar, pala serbe vazhdon ta mbajë të bllokuar kodin për Kosovën.

Ministrja për Dialog, Edita Tahiri, tha se nga gushti i këtij viti kemi një zhbllokim të procesit dhe bisedimet gjatë kësaj jave pritet të sjellin rezultate, e duket e qartë se këto janë thjesht propagandë e Qeverisë dhe mungesë e thellë e transparencës.

Kryeministri duhet të na sqarojë në Kuvend se cila është e vërteta rreth marrjes së këtij kodi duke pasur parasysh deklaratat e zyrtarëve serbë, të cilët shprehen se kodi do t'i jepet Kosovës si pjesës territoriale e Serbisë.

Qeveria duhet të bëjë transparencë se çka po bisedon me Brukselin, me Beogradin sa i përket çështjes së frekuencave dhe antenave.

Ju e dini fare mirë se edhe pse mund të konsiderohet e paligjshme dhe shkelje flagrante e rregullave të konkurrencës, një kompani e re serbe e regjistruar në Kosovë si rezultat i marrëveshjes do ta marrë një licencë për shërbimin mobil me fushëveprim të kufizuar për një periudhë të përkohshme.

Serbia duhet t'i shkruajë një letër ITU-së me të cilën njofton se e nuk pengon ITU-në që t'i ndajë Kosovës kodin telefonik +383, për të cilin në emër të Kosovës ka aplikuar Austria në fillim të këtij viti, në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit për telekomin, por nuk e ka bërë këtë.

Kryeministër duhet gjithashtu të përgjigjeni para deputetëve se çfarë fshihet pas kushtëzimeve të çështjes së kodit telefonik me Asociacionin e Komunave Serbe për çka flet edhe vetë ministria Tahiri.

Unë shpreh shqetësimin tim si deputet për jotransparencën e bisedimeve në Bruksel dhe kërkoj urgjentisht që të rishikohet tërë puna e delegacionit kosovar, ndërsa ministria, nëse nuk është në gjendje ta kryejë punën e saj, atëherë le të japë dorëheqje dhe t'ua hapë rrugën njerëzve kompetentë.

Fare në fund kërkoj shpjegim nga kryeministri në lidhje me pasojën e moszbatimit të marrëveshjes që ka dalë si rezultat i dialogut Kosovë Serbi në zbatimin e MSA-së, që është marrëveshja e parë kontraktuale e Kosovës me Bashkimin Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Shukri Buja e ka fjalën.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryesues,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Paksa e çuditshme, por në bazë të këtyre marrëveshjeve është hyrë në bisedime për çështje të brendshme të shtetit, e dihet që kodi telefonik është çështje që e rrezikon edhe sigurinë e brendshme të shtetit. Ai që posedon frekuencat e telekomunikimit rrezikon edhe institucionet e sigurisë, sepse mund t'i përgjojë shumë lehtë.

E pse të mos hyhet edhe bisedime siç ka ndodhur me të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë, ato që kanë dalë si produkt i ish-republikave jugosllave - të hyhet në bisedime për ndarjen e pasurisë siç janë objektet e ambasadave, mjetet luftarake për të cilat ka dhënë kontribut edhe babai im dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, pse të mos hyhet në bisedime për kompensimin e dëmeve të luftës, për kthimin e fondeve të vjedhura, siç është Fondi Pensional i Kosovës, por po ndodh e kundërta.

Thjesht, ne duhet ta krijojmë një strategji për këto bisedime, sepse na është thënë që këto bisedime janë bisedime për çështje teknike, por që në vazhdimësi po dalin se janë bisedime për çështje politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

E thanë edhe parafolësit e mi se të gjitha marrëveshjet në Bruksel janë bisedime politike, të mos u themi më bisedime teknike me Serbinë nga Qeveria, e edhe kjo marrëveshje për kodin telefonik e ka përcjellë të njëjtën gjendje - e dëmshme për Kosovë, aspak transparente për të mundur që ta fshehin dëmin e shkaktuar.

Në pjesën që ITU-ja do t'i alokojë kodin telefonik +383 nëpërmjet aplikimit të Austrisë, por me pronësi të Serbisë, në territorin e saj sa është e dëmshme, po aq e rrezikshme për sovranitetin e vendit karshi Serbisë.

Këto negociata në Bruksel vazhdimisht po i kontribuojnë humbjes së sovranitetit të vendit tonë dhe është momenti i fundit që t'u thuhet stop këtyre marrëveshjeve, sepse po futemi në një rrugë pa kthim dhe me plotë rreziqe për të ardhmen.

Marrja e kodit telefonik +383 në pronësi të Serbisë dhe dhënia në shfrytëzim për Kosovën praktikisht për industrinë telefonike po e kthen në pronësi të Serbisë, sepse tani edhe dy operatorë mobilë do ta shfrytëzojnë këtë kod dhe në mënyrë indirekte do të jenë në pronë të Serbisë. Shtoja kësaj mundësinë e operimit edhe të një operatori tjetër po nga Serbia.

Pra, me këto marrëveshje Kosova po shkakton dëme materiale dhe dëmtim të sovranitetit.

Një pyetje për kryeministrin: Cili është roli i Serbisë në këtë telefoni? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Shumë shkurt, vetëm dua t'i ngre disa çështje për atë që tha kryeministri në fjalën e tij hyrëse.

Marrëveshja për telekomunikacionin, e arritur në shtator 2013, asnjëherë nuk është diskutuar në Kuvend. Pra, kjo marrëveshje u tha këtu që derivon nga Marrëveshja e 19 prillit, e cila pastaj ka kaluar përmes një procesi të votim, mirëpo në atë marrëveshje me një fjali, njëra prej pikave thotë që "palët do të merren vesh për energjinë dhe telekomunikacionin". Ndërkohë që teksti i marrëveshjes, modaliteti i marrëveshjes e kështu me radhë për telekomunikacionin, asnjëherë as nuk është diskutuar, e as votuar, e as informuar Kuvendi siç është dashur të ndodhë, e aq më pak për planin e aksionit, i cili është nënshkruar në bazë të kësaj marrëveshjeje. Pra, kjo ishte një e pavërtetë që e tha kryeministri në fjalën e tij.

E dyta është që këtu i dëgjuam disa fjalë edhe nga kryeministri, edhe nga deputeti Beqaj, se si paska pasur një proces të diskutimit me Shqipërinë, e Shqipëria një proces diskutimi me ITU-në,

e në fund ITU-ja nuk i paska dhënë leje Shqipërisë që t'ia japë Kosovës kodin telefonik, kështu pak a shumë po e parafrazoj atë që e thanë.

Por, asnjë dokument nuk u prezantua prapë. Pra, kryeministri e ka ditur për këtë interpelancë shumë më herët, e asnjë dokument informativ për Kuvendin e Republikës nuk e ka sjellë për këto çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt, siç po thotë, në këtë rast kryeministri, me pamundësinë e zbatimit një rezolute të nxjerrë nga ky Kuvend. Dhe Kuvendi asnjëherë nuk është informuar, ose të paktën Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk është i informuar për ecurinë e këtij procesi, e aq më pak për dokumentacionin e prodhuar nga kjo.

Por, unë e kam një pyetje për kryeministrin: Nëse Shqipërisë nuk ia paska dhënë pëlqimin ITU-ja që të na japë kodin +355 të aplikojmë, kur e ka marrë pëlqimin Monakoja a Sllovenia për një kod që e kemi aplikuar dhe vazhdojmë të aplikojmë tash?

Dhe, edhe një herë po e pyes kryeministrin: Cili ose kush është pronari i kodit +383, nëse ai aplikohet për Kosovën? Kush do të jetë pronari, sepse kjo është shumë e rëndësishme nga dokumentacioni i marrëveshjeve në këto detaje, të cilat po duket që për një pjesë të këtij Kuvendi nuk kam fare rëndësi, por që janë të rëndësishme askund nuk përmendet që Kosova do të jetë pronar dhe vazhdimisht kur flitet për kodin telefonik për Kosovën thuhet që në emër të Serbisë dhe të Kosovës, me pëlqimin e Administratës së Serbisë, e kështu me radhë, që i bie praktikisht që Serbia po jep leje që një kod t'i ndahet Kosovës, pra leje jep ai që e pronëson kodin dhe rrjedhimisht ia dedikon një vendi.

Dhe, për fund, edhe një çështje për sa i përket asaj që e thashë në fillim, e që e shpjegoi më detajisht edhe deputeti Glauk Konjufca, kryetar i grupit, te çështja e numeracionit.

Pra, është në planin e aksionit të konfirmohet më së mirë ajo që e thashë unë që në fakt çfarë po ndodh është që sistemi i telekomunikimit të Kosovës po bëhet bashkë me atë të Serbisë, duke iu nënvendosur Serbisë për shkak të kodit telefonik, sepse kodi telefonik ndërkombëtar është unik. Kur ta aplikojë këtë kod, atëherë numeracioni i brendshëm i vendit nuk mund të ketë mbi përcaktim me një numeracion të një vendi tjetër.

Pra, për ta shpjeguar më thjesht, ta zëmë në njërin prej kodeve të telefonisë mobile që përdoret në Serbi është 063, e dinë të gjithë. Po ta kishte një kompani e Kosovës 063 dhe kur të thirrësh në telefon prefiksin +383 63, atëherë nuk ka këtu kurrfarë pengese me të njëjtin numeracion në Serbi. Mirëpo, meqenëse kjo nuk po ndodh, pra me qenë se sistemi po bëhet bashkë, atëherë natyrisht që mund të ketë pengesë. Natyrisht që dy kompani përbrenda një territori të telekomunikimeve nuk mund ta kenë numrin fiks ose prefiksin e njëjtë, sepse pastaj nuk dihet se në cilën kompani po shkon thirrja. Pra, 063 nuk mund të ketë në Kosovë për shkak të këtij unifikimi të sistemit të telefonisë së Kosovës bashkë me atë të Serbisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Teuta Haxhiu, nga AAK, i ka tre minuta për fjalë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Ia rikujtoj kryeministrit Mustafa i cili po ndihet shumë komod ngase në pikën e parë jashtë rendit të ditës e shtrova çështjen e rezolutave se sa janë të obligueshme për Qeverinë e Kosovës, prita

ndoshta edhe një përgjigje nga nënkryetari i Kuvendit si më ekspert në këtë drejtim, por nuk mora. Prandaj, po e shoh që me të vërtetë rezolutat në Kuvend po shihen nën ombrellën e Qeverisë së Kosovës, ngase e kemi pasur edhe një rezolutë pikërisht për kodin telefonik, të nxjerrë më 6 shtator 2012 në Parlamentin e Kosovës.

Ia rikujtoj Qeverisë së Republikës së Kosovës se operatorët ilegalë të telefonisë mobile, pra MTS dhe Telenor, kanë vepruar në pjesën veriore të Kosovës në kundërshtim me të gjitha ligjet në fuqi. Në një mënyrë pra, operatorët në fjalë po shpërblehen për dëmet e tanishme që i kanë shkaktuar Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe operatorëve tjerë mobilë, të cilët veprojnë në përputhshmëri me ligjet e Kosovës.

Sipas Ligjit të telekomunikimeve elektronike, frekuencat dhe numeracioni janë resurse të kufizuara. Prandaj, pyetjet e mia për kryeministrin janë:

Në cilin brez frekuencor do të veprojnë operatorët në fjalë, në brezin 900 megahercë apo 1 800 megahercë, dhe sa kanale do t'i open këtij operatori?

Pyetja e dytë, a është e vetëdijshme kjo qeveri se lejimi i ofrimit të shërbimeve nga këta operatorë po e dëmton konkurrencën në tregun e telekomunikimit?

Dhe pyetja e tretë, pse kjo Qeveri nuk ka kërkuar në Bruksel që ta organizojë ankandin për telefonin e tretë mobile, ku do të mund të konkurronin edhe të tjerë të interesuar të përfshirë në këtë çështje?

Prandaj, edhe një herë, kryeministri Mustafa dhe Qeveria e tij do të duhej që urgjentisht t'i ndërpresin bisedimet të cilat po shkaktojnë vetëm dëm në Republikën e Kosovës, ngase ky Kabinet si i paaftë për t'i implementuar pra, ose për t'i zbatuar marrëveshjet e arritura deri më tani, ngase përmendi që kemi garanci edhe nga shumë shtete të BE-së dhe faktorë ndërkombëtarë në zbatimin e tyre, këto rezultate nuk po i sheh qytetari kryeministër, nuk po i shohim as ne, është mirë të na tregoni se ku janë ato të arritura. Pra, qytetarët po shohin vetëm dëmtimin e buxhetit me ekipet të cilët po shkojnë për negociata në Bruksel vetëm për akomodimin e tyre, sepse me të vërtetë ky buxhet, edhe ashtu i varfër, po varfërohet çdo ditë me këtë humbje kohe dhe dëmet e shkaktuara shumë të mëdha në Buxhetin e Kosovës.

Andaj, edhe një herë duhet të reflektoni dhe t'ia vini gishtin kokës, mjaft më me këto bisedime që janë vetëm në dëm të Kosovës dhe në interes të shtetit të Serbisë.

Prandaj, kërkojmë edhe një herë përgjegjshmëri të plotë në zbatimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Po përpiqem t'i ngre edhe dy shqetësime tjera që dalin nga kjo marrëveshje.

E para është që kur dihet që në Kosovë ka për të operuar Telekom i Serbisë dhe kur dihet që në një anën kemi edhe Ligjin e miratuar për përgjimet, i miratuar në këtë Kuvend, atëherë vihet dilema çka nëse ky operator nuk do t'i respektojë detyrimet që dalin nga ky ligj? Dihet, nuk do t'i lejohet qasja as e AKI-së, as Policisë, as Prokurorisë në ato segmente ku operon.

Por, çka edhe nëse i respekton, atëherë dihet që ekziston njëkohësisht edhe rreziku i madh i nxjerrjes së të dhënave pra jashtë vendit dhe i atyre të dhënave që i përfiton kjo kompani.

Ka ndodhur rasti i ngjashëm me licencimin e një kompanie bankare, që ka qenë Banka Komerciale, ku për formalitet që e pati licencuar Banka Qendrore, pastaj asnjëherë të vetme, kurrë asnjëherë kjo bankë nuk i ka raportuar Bankës Qendrore dhe nuk ka qenë e inspektuar dot. Po ashtu, edhe hapur ata punonin me dinarë, hapnin llogari me standarde dhe nuk i raportonin kurrë BQK-së.

Prandaj, do të them edhe një herë që edhe në fushën e përgjimeve do ta kemi shumë problem të madh pranimin e licencimit të një kompanie serbe, aq më tepër të një kompanie, e cila vepron në territorin edhe të Kosovës tash si degë e Serbisë.

KRYESUESI: E ka fjalën Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Rruga për t'u pajisur Kosova me kod ndërkombëtar të telefonisë është aplikimi për anëtarësim në ITU në Gjenevë. Pra, Gjeneva është adresa dhe kjo rrugë nuk kalon as nga Beogradi dhe as nga Vjena, ashtu sikur që kemi aplikuar për UNESCO pa qenë anëtarë të OKB-së, e njëjta ka mundur që të përsëritet edhe për ITU-në. Ka shtete që nuk janë anëtare të OKB-së, mirëpo janë anëtare në ITU, për shembull Tajvani është një shtet i tillë, Vatikani, Palestina, Sudani Jugor ka qenë anëtar në ITU para se të bëhet anëtar në Kombet e Bashkuara, e posaçërisht e dimë shembullin e vetë Zvicrës, ku ndodhet Gjeneva, e cila nuk ishte anëtare në Organizatën e Kombeve të Bashkuara deri në qershor 2002, por ishte anëtare në ITU.

Gjatë negociimit Qeveria e Kosovës e ka ditur shumë mirë qëndrimin e "Vetëvendosjes", e posaçërisht të ekspertit tonë Ismet Hamiti se kjo çfarë thashë deri më tash është e mundur. Pra, ata e kanë ditur që ka qenë e mundur që drejtpërdrejt ne të aplikojmë për anëtarësim në ITU, por nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Arsyeja pse nuk e kanë bërë një gjë të tillë është se në negociata me Serbinë, në fakt e kanë maskuar zgjerimin e operatorit të Serbisë në Kosovë. Ky ka qenë qëllimi kryesor, legalizimi i Serbisë në Kosovë, e që maskohet me një negociatë edhe për kodin telefonik të Kosovës, që mund të jetë kod telefonik, por nuk do të jetë i Kosovës.

Dhe, dihet që Austria mund të aplikojë për resurse plotësuese numerike me çfarëdo preteksti, edhe me pretekstin që po e bën këtë në emër të Kosovës dhe të Serbisë, por ai kod që do të përfitohej në këtë mënyrë realisht nuk është i Kosovës. Kjo sepse kodet nuk janë as të transferueshme, e as të tregtueshme.

Pra, me një kod që pritet ta marrë Austria nuk do të zgjidhet asnjë problem që aktualisht ka Kosova për shkak të mungesës së kodit të vet.

Kodi telefonik ndërkombëtar është çështje e sovranitetit shtetëror, ashtu qysh është çështje e sovranitetit shtetëror toka si territor shtetëror, apo ajri si zonë fluturimi, njësoj është edhe numeracioni dhe brezi frekuencor.

Por meqë kanë hyrë në Pazar, atëherë çështja është se a ka provuar delegacioni i Kosovës që ta zbatojë parimin e reciprocitetit? Pra, a ka provuar që t'i kërkojë minimalisht të njëjtat resurse ose të njëjtat kushte, sepse licenca pra i ka dy elemente, e ka numeracionin dhe e ka frekuencën, që kjo t'i jepet edhe Valës së PTK-së në Serbi. Pra, a ka provuar, a ka një kërkesë të tillë nga Qeveria e Kosovës mbi bazën e parimit të reciprocitetit, se në fund të fundit nuk ka më pak shqiptarë në Serbi sa që ka serbë në Kosovë.

Në planin e veprimit të telekomunikacionit, në pikën 3.5 vërtetohet ajo që e tha kryetari ynë i Grupit Parlamentar, Glauk Konjufca. Thotë që Bashkimi Evropian do të lehtësojë transferin e asetëve fikse që do të përdoren nga ndërmarrja e re. Më tutje asetet, të cilat aktualisht përdoren nga ndërmarrja serbe do të transferohen te ndërmarrja e re. Pra, me fjalë të tjera bëhet legalizimi i asaj që ishte ilegale.

Në këtë mënyrë bëhet e pamundur që të luftohet ilegaliteti. Në njërën anë, komprometohet mënyra e drejtë që Kosova të aplikoj drejtpërdrejt në ITU, ndërkaj në anën tjetër komprometohet mundësia që të luftohet ilegaliteti, meqenëse ai po legalizohet.

Dhe, më tutje, në aneksin e tretë, që mban titullin Denominimi i Kosovës në anekse teknike të ITU-së, thuhet “në anekset teknike të buletineve të ITU-së, Kosova do të referohet si Kosovo” me fusnotë, dhe kjo do të thotë që atje nuk do të jemi të përfaqësuar ashtu siç jemi të shpallur këtu. Pra, ka një lloj deformimi që bëhet nëpërmjet kësaj fusnote, e cila jo vetëm që e bën Kosovën sui generis pa qenë realisht e tillë, por, në anën tjetër, edhe na e heq fjalën ‘republikë’, e cila është element thelbësor i shtetësisë dhe i pavarësisë sonë.

Përgjegjësish shtetet janë ose monarki ose republika, e ne me këtë fusnotën, e cila nuk ishte fjollë bore që të shkrihet, nuk u bëmë as republikë, as monarki, rrjedhimisht jemi më pak se shtet, jemi më pak se të pavarur dhe për pasojë nuk jemi plotësisht sovranë, gjë që u vulos edhe me këtë marrëveshje për telekomunikacionin në Bruksel, me të cilën, po e përsëris edhe një herë, kodi i ri telefonik mund të jetë kod i ri telefonik, por nuk është i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Janë kryer të gjitha diskutimet. Kryeministri, nëse do e merr fjalën, dhe në fund paraqitësi ose kërkuesi i interpelancës e ka fjalën e përmbylljes. Urdhëro, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë ju falënderoj për kontributin në këtë interpelancë, por edhe për mendimet dhe qasjet të ndryshme të cilat u dhanë lidhur me kodin telefonik.

Unë bëra përpjekje që në vërejtjet hyrëse ta prezantoj atë që është qëndrim i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe atë që Qeveria e Republikës së Kosovës mendon që është mënyra më racionale dhe e mundshme që ne tani ta zgjidhim problemin e fitimit të kodit telefonik.

Këtu u shtruan disa çështje, u shtrua çështja e pronësisë mbi kodin e ri telefonik, çështja e saj se kush e ndan këtë kod, është Serbia apo ITU-ja, çështja e kodit telefonik me Shqipërinë, pastaj çështja e ndërlidhjes me rezolutën që e ka nxjerrë Kuvendi.

Unë do të bëj përpjekje që shkurtimisht të jap mendimet lidhur me këto:

Kodi telefonik do të jetë kod telefonik i Kosovës dhe Kosova do të jetë pronare e këtij kodi telefonik. Prandaj, ne do ta kemi këtë kod telefonik, ne do të jemi pronar të këtij kodi telefonik. Ne do ta administrojmë me këtë kod telefonik, serveri do të jetë në Kosovë dhe Telekom i Kosovës lidhet direkt me botën nëpërmjet këtij serveri. Ndërkaq deri më tani kjo është bërë nëpërmjet Beogradit.

Kodin telefonik nuk e ndan Serbia për Kosovën, por kodin telefonik për Kosovën e ndanë ITU-ja, ndërkaq neve nuk na kanë pranuar si Kosovë. Mirë do të ishte të na kishin pranuar që ne të aplikojmë, por nuk na kanë pranuar që ne të aplikojmë, prandaj e kemi gjetur zgjidhjen që për Kosovën të aplikojë Austria. Do të thotë kjo ka qenë zgjidhja, sepse nuk kemi gjetur zgjidhje tjetër, mirëpo jo Austria që ky kod pastaj të jetë kod i Serbisë, ose kod i Austrisë, por që Austria ta kryejë vetëm shërbimin e aplikimit për kod, ndërkaq kodi të jepet në pronësi të Republikës së Kosovës dhe të administrohet nga Republika e Kosovës.

Ndryshe, edhe ne kishim pasur dëshirë që të pranohet aplikacioni ynë në ITU dhe që ne pastaj drejtpërdrejt ta zgjidhim këtë çështje.

Sa i përket rezolutës e cila ka qenë më parë, para kësaj Qeverie, unë jam i informuar se ka pasur kontakte me Shqipërinë, jam informuar nga ministria për Dialog, se janë zhvilluar kontaktet me Shqipërinë, se nuk është arritur të realizohet kjo dhe se për këtë është njoftuar Kuvendi. Unë as nuk kam qenë në Shqipëri vetë, as nuk kam biseduar me Qeverinë shqiptare për këtë, sepse ka qenë punë e përfunduar përpara, mirëpo këtë informatë e kam dhe këtë informatë po ia përcjell Kuvendit.

Ndërkaq ne nganjëherë po hyjmë në kolizion ndërmjet ligjeve që ne i aprovojmë në Kuvend dhe rezolutave të cilat i aprovon Kuvendi. Unë e respektoj mendimin e deputetes lidhur me atë se ne duhet t'i respektojmë edhe duhet t'i implementojmë rezolutat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, por edhe duhet të kemi kujdes që gjithmonë këto rezoluta të jenë në harmoni me ligjet që ne i aprovojmë këtu.

Në qoftë se me Ligj për ratifikimin e marrëveshjes së parë kemi thënë se çështja e komunikacionit është çështje e cila do të zgjidhet nëpërmjet dialogut me Brukselin, që nënkupton edhe çështjen e kodit telefonik, atëherë vjen në pyetje se si mund ta sjellim ne një rezolutë më vonë dhe të themi se kjo duhet të bëhet nëpërmjet Shqipërisë. Unë tash nuk po i hap këto tema në mënyrë të veçantë, por dëshiroj që në të ardhmen t'i adresojmë çështjet, t'i bëjmë që rezolutat të jenë të zbatueshme dhe që Qeveria mund t'i zbatojë këto rezoluta, sepse nuk ka asnjë arsye që ne

të mos e kemi vullnetin dhe përgjegjësinë që t'i zbatojmë rezolutat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Unë ju lus që në përfundim të kësaj të pajtohemi që të ecim rrugës së aplikimit të kodit telefonik për të cilin ne jemi marrë vesh. Nuk ka qenë e lehtë kjo çështje, nuk është vetëm çështje e kodit telefonik dhe e infrastrukturës telefonike, e cila është problematike, është edhe infrastruktura tjetër për të cilën ne tani po bëjmë përpjekje që atë ta nxjerrim dhe ta qeverisim vetë, e që ka të bëjë kryesisht me marrëveshjen për energji, sepse na ka mbetur transmissioni i energjisë elektrike me Shqipërinë i pafunksionalizuar për shkak të këtij problemi. Prandaj, po duhet që hap pas hapi t'i zgjidhim këto çështje.

Do të thotë, unë mendoj se Kosova përfiton me këtë kod telefonik, mendoj se ne duhet ta pranojmë, edhe ky Kuvend ta përkrahë këtë aktivitet i cili po ndërmerret, mirëpo mendoj që ne duhet të kërkojmë edhe sot nga Bashkimi Evropian që ata të jenë të përkushtuar, edhe të jenë rigorozë, edhe të jenë të vendosur që të ushtrojnë presion mbi Serbinë, që Serbia t'i zbatojë vendimet dhe marrëveshjet për të cilat ne jemi marrë vesh, sepse një gjë e tillë po na dëmton edhe materialisht, por po na dëmton edhe në pikëpamje të sovranitetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Fjalën e merr paraqitësi i interpelancës, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Mendoj se atë që e tha edhe në fjalën e fundit Mustafa, e shpërfaq më së mirë mbase edhe logjikën qeverisëse që e ka kjo Qeveri këtu. Për shembull, një fjalë që e dëgjova, që m'u duk shumë interesante nga Mustafa, tha kështu: "nuk na kanë pranuar të aplikojmë". Unë qysh e di, në botën moderne aplikon për t'u pranuar, pra në këtë rast Qeveria pret që të pranohet e të aplikoj dhe mendoj që kjo është ajo përmbysja e një logjike qeverisëse të një shteti sovran.

Pra, së pari duhet të pranohet aplikimi, që pastaj për të aplikuar për të na pranuar, që për t'u pranuar për të aplikuar, e kështu me radhë dhe natyrisht i kemi 17 vjet prej se jemi çliruar nga Serbia dhe po presim të na pranojnë të aplikojmë që të aplikojmë për të na pranuar. Kjo është e vërteta e vetme që e dëgjova sot nga kryeministri.

Por mendoj që kjo aplikohet pastaj në një situatë shumë më të keqe dhe që prodhon efekte të jashtëzakonshme dhe të rrezikshme politike kur bëhet me Serbinë, sepse këtu u tha që po tentojmë ta çlirojmë infrastrukturën e uzurpuar nga Serbia. Pra, edhe këtu po presim të na pranojnë të aplikojmë. Po presin që Serbia të na thotë 'ejani merreni këtë infrastrukturë që ua kemi uzurpuar', e ne pastaj ta marrim. Pra, edhe këtu jemi josovranë në mendim, e po ashtu edhe veprim, sepse shteti sovran e ka nën kontroll territorin e vet. Ndërkohë që ky shteti ynë, i Isa Mustafës në këtë rast, pret që ai që ia ka pushtuar territorin t'ia japë nën kontroll, pra pret që t'ia pranojë aplikimin që ky të aplikojë për t'u pranuar. Dhe, prandaj jemi ku jemi.

Dhe, në këtë drejtim, konsideroj që ne e kemi parë disa herë veçanërisht kohëve të fundit se si kryeministri Mustafa tërhiqet. U tërhoq për demarkacionin, u tërhoq më herët për Ligjin për "Trepçën", u tërhoq tash për këto licencat e kështu me radhë. Po duhet t'i bëjë të gjitha këto tërheqje të mëdha për të mos bërë një dorëheqje të vogël - dorëheqjen e tij. Pra, tërhiqet nga çdo

gjë tjetër në vend se të tërhiqet vetë, me çka do t'i kishte zgjidhur krejt këto probleme, pastaj s'do të kishte pasur nevojë për këto tërheqje të të gjitha projekteve, e kështu me radhë.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ju që nuk keni pritur të jua pranojnë aplikacionin për t'u pranuar, ju këtu në këtë sallë të Kuvendit, ju ftoj që për ta ndihmuar Republikën e Kosovës, për ta ndihmuar zhvillimin e tregut dhe komunikacionit dhe për ta ndihmuar përafrimin e Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë si rruga e vetme përpara, ta votoni këtë rezolutë, që po e propozojmë këtu tash, e cila, në fund të fundit, nuk kërkon asgjë më shumë e asgjë më pak, vetëm që ta konfirmoni edhe një herë votën tuaj të dhënë para disa viteve, për të cilën keni votuar me vullnet të lirë për ta kërkuar aplikimin e kodit telefonik +355 për Republikën e Kosovës. Pra,

Në mbështetje të nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, propozojmë dhe kërkojmë që ta votoni këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës t'i nisë menjëherë dhe pa vonesë negociatat me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë për zëvendësimin e kodeve telefonike sipas Rezolutës numër 04/R-07 e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e datës 6 shtator 2012, e cila quhet "Për zëvendësimin e kodeve telefonike aktuale në Kosovë".

2. Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës i raporton në seancë plenare Kuvendit të Republikës së Kosovës jo më larg se përfundimi i muajit të parë pas votimit të kësaj rezolute, dhe

3. Ngarkohet Kryesia e Kuvendit t'ia përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë këtë kërkesë dhe rezolutë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, në sallë nuk ka kuorum për të marrë vendim ose për të votuar. Unë jap pushim deri në orën 15:30, atëherë do të provojmë të votojmë dhe të vazhdojmë me pikën tjetër.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Deputetë të nderuar!

Momentalisht këtu brenda janë 50 deputetë, unë propozoj që të vazhdojmë me punë në pikën tjetër të rendit të ditës.

7. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës

Deputeti Ismajl Kurteshi, i mbështetur nga 7 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë.

Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje prej 10 minutash dhe mbyllje deri në 5 minuta.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, kryeministri Isa Mustafa e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë kohëzgjatje prej 15 minutash, ndërsa koha është njësoj e ndarë për madhësinë e grupeve parlamentare, siç e patëm në interpelancën tjetër.

E ftoj zotin Ismajl Kurteshi, deputet i Lëvizjes “Vetëvendosje”, që në cilësinë e propozuesit të interpelancës ta merr fjalën, 10 minuta i ke.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Derisa shqiptarët e dëbuar me dhunë nga paramilitarët e organizuar dhe të paguar nga shteti i Serbisë para e pas lufte nuk mund të kthehen në banesat dhe shtëpitë e tyre të uzurpuara e të shkatërruara, nuk lejohen as t'i rindërtojnë shtëpitë e tyre të shkatërruara në pjesën veriore të Kosovës, Serbia e papenguar nga Qeveria e Kosovës po ngre koloni për kolonët e rinj serbë si ato të ngrehura ndërmjet dy luftërave botërore nga Mbretëria Jugosllave, pastaj kolonit e ngrehura pas luftës së dytë botërore nga Tito dhe Rankoviçi, e deri te ato të viteve të '90-ta, të ngrehura nga regjimi i Milosheviqit.

Edhe pas përfundimit të luftës së fundit, në të cilën janë djegur mbi 120 mijë shtëpi të shqiptarëve në Kosovë, dhe disa shtëpi të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Republikën e Kosovës. Nga buxheti i saj i varfër Kosova ka ndërtuar 1 mijë e 352 shtëpi, prej të cilave 883 për pjesëtarët e komunitetit serb, 226 për komunitetin ashkali, 71 për shqiptarët, 65 për romët, 36 për egjiptianët, 32 për boshnjakët, 25 për goranët dhe 2 shtëpi për pjesëtarët e komunitetit malazez.

Në anën tjetër, strukturat ilegale të Serbisë veprojnë lirshëm dhe mbajnë nën uzurpim gjithë jetën publike dhe private të banorëve me kombësi serbe, boshnjake dhe më së shumti të atyre me kombësi shqiptare të asaj zone, duke pamundësuar të drejtën e fituar nga neni 35, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës mbi lirinë e lëvizjes në vendin e tyre.

Strukturat e Qeverisë së Serbisë dhe institucioneve të sigurisë, në shpërfillje të plotë të institucioneve të Kosovës, po ashtu diktojnë jetën e përditshme, jetën politike e ekonomike në katër komunat veriore. Këto janë të konkretizuara për gjithë opinionin publik vendës dhe ndërkombëtar gjatë kohës së fushatës së zgjedhjeve të Serbisë, ku dhe herën e fundit pamë se në çfarë gjendjeje janë këto katër komuna të Kosovës.

Ata kanë të shtrirë jashtëligjshëm atje postën, bankën, telefoninë e deri te platformat e TV, si dhe të gjitha shërbimet e tjera shtetërore të Serbisë. Madje, edhe pse furnizohen me rrymë e me shërbime të ujit të pijshëm e kanalizimeve nga kompanitë e Republikës së Kosovës, pra të shtetit të tyre, as nuk paguajnë e as nuk janë të regjistruar me kontrata si të gjithë qytetarët e tjerë. Këto shpenzime i paguajnë për ta, në fatura, secili qytetar tjetër i Kosovës, pra në përgjithësi shqiptarët.

Krejt e kundërta ndodh me shqiptarët, të cilët tashmë janë pakicë në këto komuna pas spastrimit etnik që ndodhi gjatë vitit 2000, ku mbi 11 mijë shqiptarë u përzunë nga shtëpitë e tyre dhe vetëm në netët e 3 dhe 4 shkurtit u ekzekutuan 10 shqiptarë brenda nëpër shtëpi, u plagosën me armë zjarri 25 të tjerë dhe u keqtrajtuar rëndë fizikisht 93 shqiptarë. Të njëjtën skemë spastrimi, shtëpi për shtëpi, e ndoqën grupe të organizuara të Serbisë, “Rojat e Urës”, përgjatë muajve mars, prill, maj e qershor, ku mes të tjerash ndodhi dhe masakra e 14 prillit 2000 në lagjet “Bair” dhe “Qendra 1”, kohë në të cilën sipas dëshmitarëve u pushkatuan ose u vranë 31 shqiptarë.

Për 17 vjet me radhë qindra shqiptarë nuk janë lejuar të kthehen në shtëpitë e tyre, nga të njëjtët grupime ilegale dhe kriminale të mbështetura financiarisht dhe me armatim nga Qeveritë e Serbisë. Ende sot ky problem i kthimit të shqiptarëve në banesat e tyre, në pronat e tyre, nuk është zgjidhur, njëjtë si edhe për rindërtimin e shtëpive të djegura gjatë dhe pas luftës.

Teksa kjo situatë paraqitet çdo herë e më e paadresuar, Qeveria e Kosovës keqadministroi problemin e barrikadës në urën e Ibrit dhe rrezikun për zhdukjen e padrejtë të vijës administrative të Mitrovicës, përkatësisht për lagjen “Suhodoll”. Kjo nëpërmjet nënshkrimit më 25 gusht 2015 në Bruksel të Marrëveshjes për heqjen e barrikadës nga ura e Mitrovicës.

Paralelisht me strategjinë plotësisht të gabuar të Qeverisë së Kosovës, është paralajmëruar nga autoritetet e Serbisë se në territorin e Republikës së Kosovës, midis Mitrovicës dhe Zveçanit, po përgatiten të ndërtojnë një lagje të pastër etnikisht, që e kanë quajtur “Lugina e Diellit”.

Qytetarët e asaj zone dhe opozita ka njoftuar me kohë për këtë problem, por Qeveria e Kosovës as nuk e ka trajtuar seriozisht këtë çështje.

Së fundmi, u bënë publike qëndrimet e Kryeministrit, të cilat e cilësojnë si të paligjshme ngritjen e një lagje të tillë në territorin e Kosovës nga ana e Serbisë. Por, përkundër këtij qëndrimi, ministrat nga Lista Serbe në Qeverinë Mustafa morën pjesë në inaugurimin e fillimit të punimeve në këtë territor dhe e përshëndetën iniciativën.

Po ashtu dhe qëndrimi zyrtar i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor saktëson paligjshmërinë e kësaj lagjeje kolonizuese. Në të thuhet se fillimi i ndërtimit të kësaj lagjeje nuk mund të bëhet pa leje ndërtimore të lëshuara nga organet komunale në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale Komunale. Komunitet në veriun e Kosovës nuk i disponojnë këto dokumente të planifikimit hapësinor komunal, të përcaktuara me Ligjin për Planifikimin Hapësinor.

Por, përveç këtyre deklaratave, Kryeministri ende nuk ka marrë masa ndaj ministrave. Si rrjedhim dhe Ministria e Pushtetit Lokal që duhet të merrte masa ndaj kryetarëve të komunave që me iniciativat e tyre shkelin ligjin, në vend të kundërshtimit dhe veprimit, është orientuar nga mbështetja e nismave në kundërshtimin me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e saj.

Zyrtarisht nuk kemi të dhëna nëse zyrtarët përgjegjës për kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjit të kenë inspektuar në vend situatën.

Në raportimet dhe deklaratimet e shpeshta zyrtare dhe publike përmendet si një nga arritjet e negociatave 2011–2015 me kryeministrin e Serbisë zgjedhja sipas ligjeve të Kosovës të kryetarëve të komunave të veriut të vendit dhe këshilltarëve komunalë, si dhe zbatimi nga ana e tyre e normave dhe rregullave të Republikës së Kosovës.

Sigurisht që kjo as nuk është e vërtetë, e as nuk pritet të jetësohet në këtë format që kanë zgjedhur deri tash drejtuesit e Kosovës. Rasti me Luginën e Diellit na e konfirmoi katërcipërisht këtë situatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurtoshi! Ftoj kryeministrin Isa Mustafa të paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës lidhur me çështjen që është shtruar në interpelancë.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Nuk është gjë e panjohur për të gjithë ne se gjendja në veri të vendit nuk ka qenë e mirë për një kohë të gjatë që nga fundi i luftës. Këtë gjendje e kemi trashëguar nga UNMIK-u, i cili nuk ka arritur të shtrijë administrimin në veri të vendit dhe të mos lejojë ndërhyrjen e Serbisë dhe strukturave paralele.

Kosova ka shpallur pavarësinë e shtetit në vitin 2008, mirëpo vetë shpallja e pavarësisë nuk i zgjidhi me automatizëm problemet e trashëguara në veriun e vendit. Prandaj, njëra nga sfidat më të mëdha ishte vendosja e normalitetit në veri dhe integrimi i popullatës serbe që jeton atje në institucionet e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e saj ka vendosur si prioritet strategjik çështjen e normalizimit të gjendjes, shtrirjen dhe konsolidimin e sovranitetit të shtetit në tërë territorin, përfshirë edhe katër komunitet në veri të vendit. Vlerësoj se edhe përkundër vështirësive, progresi në këtë drejtim është substancial dhe është shumë i dukshëm. Qeveria e Kosovës ka arritur të vendosë sovranitetin dhe ligjshmërinë në shumë fusha relevante, duke nisur nga vendosja e kufirit me Serbinë, funksionimin e komunave legale, vendosja e autoriteteve shtetërore në dy

pikëkalimet kufitare në veri, vendosja e Policisë së Kosovës në komunat e veriut, zhbërja e disa strukturave paralele dhe deri te hapja e Urës së Ibrit për t'u rikonstruktuar dhe për të qenë e kalueshme në të dy anët e lumit që lidh komunikimin e pjesës jugore dhe veriore të Mitrovicës.

Është punuar në renovimin e shkollave në veri të vendit, në njohjen e diplomave. Tashmë edhe tatimet doganore janë duke u grumbulluar, ndërsa kompanitë në veri janë regjistruar legalisht dhe janë fiskalizuar. Duke e konsoliduar sovranitetin shtetëror në tërë vendin, shteti ynë po forcon në planin politik dhe të sigurisë autoritetin e vet, duke krijuar kushte të favorshme për zhvillimin ekonomik dhe për mirëqenie qytetare. Gjendja e sigurisë në veri është përmirësuar dukshëm dhe mund të them se kemi të bëjmë me një gjendje të qetë dhe stabile, gjë e cila dëshmohet edhe përmes statistikave të institucioneve përkatëse.

Ne po ashtu kemi ndërmarrë masa për të ndihmuar zhvillimin ekonomik, duke akorduar një fond për zhvillim, duke marrë për bazë rrethanat atje që demonstroi përkushtimin e Qeverisë dhe institucioneve të Republikës së Kosovës që të ndihmojnë zhvillimin ekonomik të Leposaviqit, Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut dhe Zveçanit, sepse konsiderojmë se zhvillimi ekonomik është parakusht i stabilitetit politik dhe i krijimit të kushteve për jetë normale dhe prosperitet atje dhe në tërë vendin tonë.

Ministritë e linjës vitin e kaluar dhe këtë vit kanë lidhur një numër të madh të marrëveshjeve të mirëkuptimit me kryetarët e komunave të Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut për projekte në fushat e infrastrukturës rrugore, të sportit, kulturës, ambientit, arsimit, shëndetësisë, pushtetit lokal dhe mund të them se këto projekte po implementohen me sukses.

Këto përparime janë rezultat i angazhimeve maksimale të Qeverisë së Kosovës dhe po ashtu rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar që i ka realizuar Qeveria dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Ndryshimet pozitive, arritur në veri të vendit, janë rezultat i drejtpërdrejtë i dialogut të Brukselit. Dialogu i Brukselit, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është duke kontribuar për ndaljen e ndërhyrjes së Serbisë në Kosovë, si dhe po ndihmon të bëjmë integrimin e pjesëtarëve të komunitetit serb të asaj pjese të Kosovës në institucione dhe jetën politike të Republikës së Kosovës.

Ky dialog po kontribuon në konsolidimin dhe forcimin e shtetit përmes normalizimit të gjendjes në veri, si dhe përmes përpjekjeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes Kosovës dhe Serbisë sipas parimeve euroatlantike. Që nga viti 2011, kur ka nisur dialogu në Bruksel, ne kemi arritur hap pas hapi të vendosim demokracinë, sundimin e ligjit dhe rendit në veri. Ne kemi zgjedhur rrugën e dialogut për të zgjidhur problemet e trashëguar në veri të vendit dhe mendoj se me mençuri iu kemi shmangur rrugës së konfrontimeve dhe si alternativë kemi zgjedhur rrugën e dialogut për t'i zgjidhur problemet e mbetura.

Ne nuk shohim alternativë tjetër për t'i zgjidhur këto probleme përpos dialogut dhe bashkëpunimit me partnerët tanë, të cilët e kanë ndihmuar çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës. Vlerësoj se politikat që i ndoqi udhëheqja e Kosovës ishin me objektiva strategjike dhe vizionare, ato u përkrahën nga aleatët tanë, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga partnerët evropianë, të cilët janë së bashku me ne në zhvillimin dhe forcimin e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur.

Duhet theksuar se problem kyç akoma mbetet moszbatimi i marrëveshjeve nga ana e Serbisë dhe sipas një arsye po prolongohet implementimi i marrëveshjeve. Problem kyç mbetet edhe mënyra e trajtimit të marrëveshjeve, sepse ne po humbim kohë të gjatë në arritjen e marrëveshjeve dhe pasi që këto marrëveshje po arrihen, pastaj po detyrohem që edhe njëherë të ulemi e të diskutojmë lidhur me mënyrën e implementimit të këtyre marrëveshjeve, që është një qëllim i Serbisë që të zvarritet, përkatësisht të prolongohet zbatimi i tyre.

Ndërhyrja e Serbisë përmes strukturave paralele është akoma evidente, për çfarë nevojitet një reagim shumë i qartë i bashkësisë ndërkombëtare. Mirëpo, të nderuar deputetë, funksionimi i komunave legale në veri të vendit ka krijuar mundësinë që shërbimet legale publike t'u ofrohen qytetarëve atje që nga fillimi i vitit 2014.

Policia e Kosovës është duke funksionuar në mënyrë normale, po sigurohet rendi dhe qetësia në nivel gjithnjë më të mirë, sidomos kemi arritur të përmirësojmë gjendjen e sigurisë, si dhe të ulen veprimet kriminale dhe kontrabandë. Autoritetet shtetërore të Kosovës funksionojnë në pikën kufitare që nga viti 2012, ndërsa grumbullimi i tatimeve në kufi po zhvillohet gjithnjë e më suksesshëm, po i rrit të hyrat buxhetore të Kosovës dhe po ullet evazioni fiskal dhe informaliteti.

Sipas informatave që i kemi nga Administrata Tatimore e Kosovës, janë mbi 1000 firma në veri të vendit, të cilat janë të regjistruara pranë institucioneve të Kosovës dhe që paguajnë tatim në Kosovë. Mund t'ju them po ashtu se besueshmëria e qytetarëve të asaj pjese në institucionet e shtetit të Kosovës është në rritje të vazhdueshme, ndërsa bashkëpunimi mes Qeverisë qendrore dhe katër komunave veriore është i rregullt. Unë rregullisht i takoj kryetarët e katër komunave për të diskutuar për problemet dhe nevojat e tyre, për projektet të cilat realizohen dhe me ministrinë e linjës, si dhe për implementimin e buxhetit sipas rregullave dhe ligjeve të Kosovës.

Ka pasur vizita të ministrave të linjës në disa nga komunat në veri dhe ka bashkëpunim të mirë me kryetarët e komunave. Sot jam i informuar se katër komunat në veri të vendit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë aprovuar buxhetin sipas kornizës buxhetore të Kosovës, që është një hap shumë i rëndësishëm në integrimin e tyre. Ajo që vlerësojmë më të rëndësishme është që po ndryshon mendësia politike dhe gatishmëria e qytetarëve tanë nga veriu i vendit për të kuptuar dhe pranuar realitetin e shtetit të Kosovës. Çdo ditë pranojmë kërkesa nga qytetarët, të cilët dëshirojnë të inkuadrohen në sistemin e Kosovës apo edhe të kthehen në vendet e punës të mëhershme nga të cilat janë larguar pas shpalljes së pavarësisë për shkak të presioneve apo kërcënimeve nga Serbia.

Së shpejti, ditët në vijim do të vendosim sistemin unitar të drejtësisë në veri të vendit, ku do të veprojnë një gjykatë themelore dhe një zyrë e prokurorie për shtatë komuna, ashtu siç i përcaktojnë ligjet e Kosovës dhe që vjen si rezultat i marrëveshjes së Brukselit për drejtësi. Tashmë strukturat paralele të drejtësisë janë shuar, ndërsa ne kemi rekrutuar kandidatë për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ. Vendosja e sistemit shtetëror të drejtësisë në veri të vendit forcon sovranitetin e shtetit, ndërkohë që qytetarëve u mundëson qasje në drejtësi dhe zgjidhje të problemeve që ata mund t'i kenë.

Në veri po ashtu janë vendosur qendrat për punë sociale që një vit më parë edhe ato po veprojnë në mënyrë normale. Në janar të këtij viti ne kemi shuar strukturën e ashtuquajtur "Mbrotjtje

civile” dhe pjesën më të madhe të ish-pjesëtarëve të saj, të cilët i kanë përmbushur kushtet ligjore, i kemi integruar në institucionet qendrore civile të vendit. Në këtë periudhë jemi para finalizimit të objekteve për zyrat ku do të vendosen rreth 22 agjenci të ndryshme, përkatësisht zyrat e ministrive, të cilat kryejnë punë për nevojat e qytetarëve dhe komunave në veri të vendit.

Më 14 gusht kemi hapur urën e Ibrit për rekonstruktim, e cila tashmë simbolizon bashkimin dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe automjeteve nga dy anët e lumit, ndërkohë që revitalizimi i urës po realizohet nga Bashkimi Evropian dhe pritet të përfundojë pas pesë muajsh.

Zyrat e Agjencisë së regjistrimit civil dhe zyrat e gjendjes civile do të hapen së shpejti në komunat veriore, për t’i pajisur qytetarët tanë me dokumente të shtetësisë, gjendjes civile, tabelat e automjeteve, e të tjera, duke u dhënë fund dokumenteve dhe tabelave ilegale dhe duke shuar strukturat paralele që kanë lëshuar dokumente ilegale. Sa i përket kufirit të pjesës veriore dhe jugore të Mitrovicës është konfirmuar qartë se kufiri është ai që është përcaktuar me Pakon e Ahtisarit dhe se nuk do të ketë asnjë ndryshim kufiri ndërmjet këtyre dy komunave. Prandaj, është e paqëndrueshme konstatimi këtu se në Bruksel është arritur ndonjë marrëveshje tjetër, sepse askush në Bruksel nuk e ka cenuar dhe s’e ka prekur Pakon e Ahtisarit, kufiri mbetet në përpikëri ai që është përcaktuar më herët.

Gjatë muajve nëntor dhe dhjetor do të nisim ndërtimin e objekteve të përhershme të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, të cilat do të financohen nga Bashkimi Evropian, në pajtim me marrëveshjen e Brukselit për Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Natyrisht se mbetet edhe shumë për të bërë, për të krijuar një gjendje siç ne dëshirojmë, prandaj si Qeveri po punojmë në bashkëpunim me përfaqësuesit serbë në Kuvend dhe në Qeveri, si dhe me kryetarët e komunave të komunitetit serb për të zgjidhur problemet e mbetura atje, përfshirë edhe këtu shuarjen e strukturave paralele, të cilat në rend të parë po i pengojnë këto komuna dhe funksionimin e tyre.

Sa i përket vendbanimit “Lugina e Diellit”, e cila është e destinuar për personat e zhvendosur nga Kosova, Ministria e Mjedisit ka marrë masa menjëherë pas informacionit dhe ka autorizuar Inspektoratin e ndërtimit dhe planifikimit që të kryejë inspektim në këtë komunë dhe të njoftohet për rastin. Ekipi, më 6 prill 2016 ka bërë vizitën inspektuese në Komunën e Zveçanit, është kërkuar të ndërpriten të gjitha aktivitetet derisa të përgatitet dokumentacioni sipas ligjeve të Republikës së Kosovës.

Ministria po ashtu ka hartuar një udhëzues, i cili është përcjellë në të gjitha komunat, përfshirë edhe komunat në veri dhe janë përcaktuar kriteret, të cilat do t’i plotësojë çdo komunë në mënyrë që të lëshojë leje për ndërtime në territorin e tyre, që përfshin Planin zhvillimor komunal, Hartën zonale të komunës dhe planet rregulluese të hollësishme.

Është përgjegjësi e autoriteteve komunale që menaxhimin hapësinor ta zhvillojnë në harmoni me objektivat e deklaruara dhe dokumentet hapësinore, të cilat përputhen me Planin hapësinor të Kosovës, me Hartën zonale të Kosovës dhe me planet hapësinore të zonave veçanta.

Unë kam biseduar edhe me ministrin për Kthim dhe po ashtu kam kërkuar që të mos merret asnjë veprim atje, përderisa të mos plotësohen kushtet ligjore, ndërkaq mbi bazën e kushteve ligjore, atëherë komunat duhet të respektojnë procedurat e veçanta për çdo ndërtim në territorin e tyre.

Konsideroj se shuarja e strukturave paralele, të cilat akoma nxiten dhe stimulohen nga Serbia, është njëra prej çështjeve substanciale e situatës në veri të vendit. Këto struktura akoma janë numerikisht të mëdha, prandaj nevojitet një përkrahje më e madhe e komunitetit ndërkombëtar për shuarjen e tyre dhe për pengimin e funksionimit të tyre, sepse ato po shkaktojnë probleme mjaft të mëdha në ato komuna.

Ka probleme edhe me respektimin e simboleve shtetërore, por për fat të keq problemet të tilla të respektimit të simboleve nuk i kemi vetëm në veri të vendit, por i kemi edhe te disa komuna këtu në Kosovë. Në përfundim dua të theksoj se progresi i konsolidimit të sovranitetit në veri të vendit do të vazhdojë me hapa të shpejtë, përkushtimi ynë është të fokusohemi në vendosjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së plotë, duke punuar që qytetarët tanë të jetojnë të lirë, të barabartë dhe të gjithë të kthehen në shtëpitë e tyre sikurse shqiptarët, ashtu edhe serbët.

Ne kemi biseduar me komunat në veri, kemi biseduar edhe me dy kryetarët e pjesës jugore dhe veriore të Mitrovicës, në mënyrë që të gjendet zgjidhja sa më shpejt për t'iu mundësuar që shqiptarët të kthehen në pronat e tyre dhe për t'i ndihmuar ata në rekonstruktimin dhe ndërtimin e shtëpive të tyre, në mënyrë që ato të aftësohen për banim.

Unë konsideroj se sa i përket rezolutës, ne duhet të kërkojmë implementimin e gjitha marrëveshjeve që i kemi arritur, të kërkojmë përkrahje më e madhe e komunitetit ndërkombëtar për të bërë tryzni që të shuhen strukturat paralele dhe po ashtu të kërkojmë që të gjitha komunat t'i zbatojnë ligjet me rastin e ndërtimeve që kanë të bëjnë edhe me të zhvendosurit nga Kosova. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër, për këtë paraqitje rreth situatës në veri të Kosovës. Është koha e deklarimeve të grupeve parlamentare, për PDK-në kush flet? Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues,
Zoti kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë

Padyshim që veriu mbetet ende sfida kryesore në vend dhe është shumë pozitive që të kemi debate të tilla, e konsiderojmë shumë pozitive po ashtu edhe kërkesën e Lëvizjes “Vetëvendosje” të ketë interpelancë. Pa dyshim që kjo është edhe një rast i mirë të krijojmë një imazh më të mirë në këtë vend që të debatohet, të dëgjojmë dhe kryeministri të ketë mundësinë hapur të tregojë për arritjet, për sfidat dhe për ato që kërkohen nga deputetët.

Mendoj që ky është një shenjë e mirë, një lajm i mirë, një pamje e mirë për qytetarët e vendit. Ne ka kohë që sfidohemi në mënyra të ndryshme me funksionalizimin e jetës në veri, në funksionalizimin e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe pa dyshim që ka pasur edhe sfida dhe arritje. Për neve të gjithë që jemi këtu si komunitet i politikës nuk mund të merremi vetëm me sfidat pa e parë edhe një situatë çfarë ka qenë. Pra, të gjithë e dimë që kemi një përparim, por asnjë prej nesh ndoshta nuk jemi gjithaq të kënaqur me arritjet që jemi atje, derisa gjithë vendi të mos funksionojë njëjtë, pa dallim se cili komunitet jeton aty.

Dhe, duhet të kemi kujdes po ashtu të mos krijohet një perceptim sikur e patëm gati edhe në debatin e kaluar, kur flasim sidomos për sovranitetin, sikur po krijohet njëfarë ose duam ta krijojmë një përshtypje sikur ne e kemi gjetur këtë vend me sovranitet dhe ne tash po japim pak sovranitet, pak përgjegjësi, pak kompetenca, pak të drejta ose diçka nga shteti ynë. Në fakt, ne nuk mund ta krijojmë këtë perceptim sikur që edhe nuk mund të abuzojmë me krejt kontributet tona që i kemi arritur pa dallim deri më tash.

Gjithsesi, ajo që ishte në fjalën e kryeministrit dhe për çka ne duhet të pajtohemi gjithsesi është se dialogu duhet të mbetet si alternativa kryesore e vetme për normalizimin e gjendjes në veri. Fundi i fundit, ne kemi marrë edhe zotimet tona që përmes një procesi të tillë të normalizojmë gjendjen atje dhe të rregullojmë jetën e njerëzve atje. Në veri padyshim që marrëveshjet ose dialogu ndikojnë në përmirësimin, madje jo vetëm një marrëveshje, gati të gjitha marrëveshjet kanë ndikimin në normalizimin e gjendjes në veri.

Ne jemi të vetëdijshëm që procesi i shtetndërtimit përnjëherë nuk mund t'i mënjanojë të gjitha padrejtësitë historike, sikur që këtë nuk e bëri as shpallja e pavarësisë, por duhet angazhimi i të gjithëve, normalisht më shumë i atyre që kanë përgjegjësi. U përmendën këtu disa nga arritjet dhe është për t'i veçuar, për t'i përmendur, por në gjitha këto duhet të kërkohet edhe më shumë. Është e vërtetë që kemi pasur probleme serioze me kontrabandën, me trafikimin dhe me çështje të tjera atje dhe është mirë që kemi një instalim normal të doganave dhe të kufirit, por gjithashtu, edhe pse po luftohet në baza ditore, luftimi i këtyre dukurive mbetet ende për t'u bërë, sepse siç e dimë, gati dy dekada ajo pjesë, ajo zonë, ka mbetur e izoluar dhe nevojitet një angazhim permanent i institucioneve tona atje.

E ngjashme është edhe me doganat e Kosovës, e ngjashme është me institucionet e drejtësisë, edhe me zyrat e gjendjes civile. Madje, mendoj që në funksionimin e këtyre zyrave të institucioneve tona duhet të jemi pak më inventiv si institucione të Kosovës, të shohim çka mund të ofrojmë edhe më tepër. Për shembull, në këto zyra të ofrojnë informacione shtesë edhe për institucionet e tjera të Republikës së Kosovës, në mënyrë që qytetarëve atje, e një pjesë e madhe e qytetarëve atje, ju e dini që gati se nuk e kanë idenë se çka ofron Prishtina zyrtare, shoqëria e Prishtinës, shteti ynë, ndoshta duhet dhe mund t'u ofrohen informacione të tjera shtesë për sa i përket mundësive që i ofrojmë ne për t'i integruar të gjithë ata qytetarë në Republikën tonë, në institucionet e Republikës së Kosovës.

Dhe, padyshim që ne këtu flasim më shumë për sfidat dhe të shohim çka mund të bëjmë ne këtu si Parlament për t'i tejkaluar këto sfida edhe nga ana jonë si deputetë, por edhe si institucione pozitive dhe opozitive. Respektimi i lirive dhe i të drejtave të njeriut atje mendoj që duhet të jetë prioritet, është mirë që tash nuk po flasim për pengesat në lëvizjen e lirë, siç është dashur të flitet para disa vjetëve, por ende duhet të investohet në këtë drejtim dhe dëshiroj t'i ftoj po ashtu dhe institucionet ndërkombëtare që të mos heqin dorë që ta kenë praninë e tyre në këtë lëmi.

Po ashtu, zhvillimi i demokracisë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike duhet të shtohet. Është mirë që ne i kemi edhe deputetë në Parlament, kemi edhe përfaqësues në institucionet tona të përfaqësuesve serbë sidomos, por duhet të ketë edhe më shumë qasje edhe të shqiptarëve, edhe të serbëve, të kenë praninë e tyre kudo në institucionet e Republikës së Kosovës, në mënyrë që gjendja atje të jetë po ashtu sikur edhe në pjesët e tjera.

Ajo që është kërkuar, e që u tha nga deputeti Kurteshi, mendoj që është shqetësimi kryesor, investimet që po bëhen për t'u ndërtuar shtëpitë atje. Patëm edhe sqarimin e kryeministrit, unë mendoj që duhet të ketë një involvim shumë më të madh jo vetëm të institucioneve vendore atje, të komunës, por edhe të EULEX-it, edhe të OSBE-së, në mënyrë që të mos bëhen investime për të plotësuar agjenda politike dhe për të krijuar momente të cilat historikisht në Kosovë kanë dalë të dështuara dhe kanë nxjerrë probleme të tjera.

Mendoj që këtu duhet të kenë një pjekuri politike edhe përfaqësuesit serbë në jetën politike atje, në mënyrë që normalizimi i jetës të bëhet për të gjithë qytetarët pa dallim dhe investimet të mos orientohen në diçka që mund ta përkeqësojnë situatën, por të ndikojnë realisht në jetën më të mirë të njerëzve, qoftë në strehim, qoftë në kyçjen e tyre në jetën e përditshme.

Për fund, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet procesin e dialogut në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Kërkojmë nga kryeministri sa më shpesh edhe herëve të tjera pa interpelancë, përmes njerëzve që janë të kyçur në këtë proces, të vijë në Parlament që ky proces të jetë sa më transparent. Do të na ndihmonte shumë, edhe opinionit që të kemi pamje më të mirë në këtë proces që nuk është i lehtë dhe shfrytëzoj rastin të kërkojmë nga institucionet e BE-së që meqenëse marrëveshjet janë, si të thuash, elementi kryesor që sigurojnë përmirësimin e gjendjes në veri, të jenë të zbatueshme, të zbatohen.

BE-ja ka qenë edhe garant, ka marrë përsipër të jetë garant i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, të na ndihmojë, të na mbështesë më shumë që këto marrëveshje të bëhen dhe të zbatohen me kohë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Pajaziti! Ismet Beqiri, kryetar i Grupit të LDK-së e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Nuk ka dilemë që për Lidhjen Demokratike të Kosovës, edhe si grup parlamentar, veriu i Kosovës jo vetëm sot, por që nga paslufta, ashtu siç u tha nga shumica e diskutuesve, por edhe në fjalën e kryeministrit, mbetet të themi problemi akut, i veçantë, sfidë e veçantë për shtetin dhe qytetarët e Kosovës, shtetin tonë dhe qytetarët e Kosovës.

Padyshim që Lidhja Demokratike e Kosovës vazhdimisht ka shprehur brengosjen dhe përkushtimin e saj për përmirësimin e gjendjes në veri të vendit. Kemi kërkuar në vazhdimësi që në veri të funksionalizohen ose të funksionojnë institucionet e Republikës së Kosovës dhe të ushtrohet sovraniteti shtetëror. Lidhja Demokratike e Kosovës edhe më herët, por edhe tani mendon dhe është e bindur se mënyra më e mirë e tejkalimit të gjendjes në veri të vendit është përmes dialogut, prandaj edhe e kemi përkrahur dialogun si alternativën më të mirë për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme, e cila integron popullatën serbe në institucionet e Kosovës, krijon mundësi për zbatimin e ligjeve të Republikës së Kosovës në veri dhe para se gjithash, krijon mundësi për zhvillim ekonomik dhe social të kësaj pjese të Republikës sonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjendjen në veri mund ta shikojmë dhe ta vlerësojmë nga kënde të ndryshme, me një vlerësim krejtësisht negativ, ashtu siç e prezanton kërkuuesi i interpelancës, gjegjësisht Lëvizja “Vetëvendosje” dhe me aspektin e ndryshimeve, të cilat kanë ndodhur nga gjendja në të cilën ne e kemi trashëguar pas lufte, e që ishte një diskomunikim i thellë, humbje e besimit, mungesë e integritetit dhe prezencë e elementeve paramilitare dhe strukturave paralele të instruara dhe të përkrahura nga Serbia në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin-Potokut dhe të Leposaviqit.

Nuk ka dyshim që si grup parlamentar shohin ndryshime pozitive, të cilat janë rezultat i drejtpërdrejtë i dialogut në Bruksel, i cili ka mundësuar dhe po mundëson shuarjen graduale të strukturave paralele të Serbisë, të cilat kanë vepruar në vendin tonë që nga përfundimi i luftës.

Dialogu i Brukselit, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe pse padyshim jo në përmasa të nevojshme, megjithatë ka dhënë kontribut në integrimin e komunitetit serb dhe në konsolidimin dhe forcimin e shtetit përmes normalizimit të gjendjes në veri të vendit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë nga ato zhvillime që janë edhe pozitive, u thanë në fjalën e kryeministrit dhe do të mundohem të mos i përsëris, por disa janë evidente, të cilat padyshim bëjnë të ndihemi mirë si shtet që megjithatë ajo pjesë e dalë tërësisht më herët nga kontrolli i institucioneve tona, gradualisht është rritur shkalla e integritetit dhe këtë nuk mund ta mohojë askush. U përmendën, po i them shumë shkurt kalimthi, menaxhimi i integruar i kufirit, funksionalizimin e pikave kufitare, grumbullimin e taksave dhe tatimeve në kufi, padyshim punën mjaft të mirë që e bën Policia e Kosovës në veri të vendit, shuarjen e Mbrojtjes civile dhe integrimin e një pjese të kësaj strukture, e cila i ka plotësuar kushtet në institucionet e vendit, si dhe, siç u tha, pritet që edhe gjyqësori, gjegjësisht funksionalizimi i gjyqësisë dhe prokurorisë në veri dhe puna e tyre të jetë e plotë, plotësisht në harmoni me ligjet e Republikës së Kosovës.

Sigurisht, që edhe ne si subjekt politik, deputetë dhe si institucione na brengos vazhdimi i funksionimit të elementeve të caktuara të strukturave paralele dhe përkundër dialogut në Bruksel dhe marrëveshjeve të nënshkruara, Serbia po vazhdon me struktura të caktuara edhe në komunat, të cilat drejtohen nga kandidatët e dalë që i takojnë Listës serbe.

Kjo flet për një tendencë që ne asnjëherë s’e kemi dyshuar, se Serbia bën përpjekje të pengojë funksionimin normal të këtyre komunave, me qëllim të destabilizimit të Kosovës dhe institucioneve të saj.

Të dhënat flasin për prezencë të këtyre strukturave edhe në komunat në jug të vendit, pa marrë parasysh se a janë me shumicë serbe apo shqiptare. Si Kuvend duhet të kërkojmë me ngulm zhbërjen e këtyre strukturave, karshi implementimit të marrëveshjeve të Brukselit apo arritjes së marrëveshjeve të reja që mbetet sfida e vazhdueshme, posaçërisht implementimi i marrëveshjeve të arritura.

LDK-ja e përkrah procesin e kthimit të qytetarëve të Kosovës, të cilët janë shpërngulur si pasojë e luftës. Duhet të krijohen kushtet për kthimin e qytetarëve serbë në pronat e tyre, si dhe të atyre shqiptarë. Ky proces duhet të jetë proces i trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës, veçmas në pjesën e veriut. Ne nuk mund të pajtohemi që në kundërshtim me ligjet e Kosovës dhe me rregullativën hapësinore të ndërtohen lagje të reja, qoftë në Zveçan apo në komuna të tjera.

Ne respektojmë të drejtën e komunave dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë për të rregulluar aspektet urbane të tyre, por ato duhet të bëhen në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës dhe procedurave ligjore. Me ligj, qoftë edhe në veri, apo edhe në jug të vendit apo kudo qoftë duhet të rregullojmë edhe çështjen e ngritjes, pse jo edhe të monumenteve të ndryshme të personaliteteve apo për periudha të ndryshme historike. Nuk duhet të lejojmë ngritje të monumenteve për ata që kanë bërë terror ndaj popullatës sonë, për njerëzit që kanë ushtruar gjenocid, për momentet dhe akte të periudhave historike, të cilat na kthejnë në errësirën e krimeve dhe veprimeve për zhbërjen e shqiptarëve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne jemi të bindur që nuk mund të gjendet ndonjë qytetar racional dhe i arsyeshëm, veçmas shqiptar, po edhe besojmë të tjerët, po edhe nga ne deputetët, i cili nuk dëshiron stabilizim dhe përmirësim edhe më të madh të gjendjes në veri të vendit. Por, po ashtu, mendojmë dhe jemi të bindur që dialogu është rruga e vetme, është rruga më e mirë, është rruga e duhur për tejkalimin e problemeve që janë evidente dhe kjo nënkupton edhe nevojën e angazhimit edhe më të madh në implementimin e marrëveshjeve të arritura, ashtu siç u tha edhe në fjalën e kryeministrit që të mos kthehemi te këto marrëveshje, pse këto s'po zbatohen dhe të mos them të ridiskutojmë përsëri, sepse kjo tregon një papërgjegjshmëri, në këtë rast të palës serbe, në rastet kur nuk i implementon ato që arrihen në Bruksel.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron që rekomandimet që janë dhënë nga parashtruesi i interpelancës nuk ndihmojnë për tejkalimin e gjendjes në veri të vendit dhe sigurisht si të tilla edhe nuk mund t'i përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Për GP të "Vetëvendosjes" flet Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Prej qeverisë në qeveri, duke filluar nga viti 2001, ka pasur dallim të gabimeve, po një dështim konstant i të gjitha qeverive, si emëruesi i përbashkët i tyre, padyshim që është gjendja në veriun e Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka dështuar në disa rrafshë në veriun e Kosovës, së pari gjendjes në veri të Kosovës i duhet një kategorizim i saktë institucional. Pra, në përputhje me këtë kategorizim pastaj rrjedhin planet, strategjitë dhe veprimet adekuate. Për shembull, nëse ju duket situata në veri normale, atëherë në përputhje me këtë koncept Qeveria sillet thuajse atje gjithçka është në rregull. Por nëse e konceptoni situatën në veri të vendit si jonormale dhe si diçka të jashtëzakonshme, atëherë pastaj prej kësaj rrjedhin dhe veprimet e strategjitë e caktuara.

Unë mendoj që kategorizimi i saktë që duhet t'i jepet veriut të Kosovës është që kjo pjesë e territorit zyrtarisht duhet të quhet "pjesë e pushtuar nga strukturat e paligjshme të Serbisë".

Koncepti i saktë pastaj, qysh e definojmë situatën atje, e determinon edhe morinë e veprimeve që duhet t'i ndërmarrim si shtet apo si qeveri.

Së dyti, Qeveria e Kosovës kurrë nuk e ka adresuar veriun e Kosovës si çështje të spastrimit etnik. Veriu i Kosovës është problem i spastrimit etnik, kjo nuk ka kurrfarë dyshimi dhe ky spastrim etnik është kryer prej Serbisë. Ky përcaktim duhet të përdoret zyrtarisht nga Qeveria e Kosovës kudo që shkon, prej Kombeve të Bashkuara, atje në Këshillin e Sigurimit, kur po e marrin fjalën, e deri në Bruksel, në Bashkimin Evropian, duhet të përdoret një kategori e saktë, një kategorizim institucional dhe shtetëror i këtij territori, i këtij rajoni. Ky është territor i pushtuar dhe i spastruar etnikisht prej Serbisë.

Gabimi trashanik i Qeverisë së Kosovës është që veriun e Kosovës shumë më shumë e sheh si territor të kontestueshëm mes dy palëve, pra të dy palët luftojnë për një territor, është i kontestuar, se sa si çështje të pushtimit, pra të okupimit me dhunë, si çështja, për shembull, rasti i shkurtit të vitit 2000, kur u spastrua etnikisht veriu i Kosovës nga "Rojat e Urës", në krye me Oliver Ivanoviqin.

Dëgjoni, nëse Oliver Ivanoviqi po akuzohet sot për spastrim etnik nga drejtësia, atëherë në të njëjtën mënyrë duhet të veprojë edhe politika, dhe në terren duhet të jenë efektet e njëjta. Nëse njeri po akuzohet për spastrim etnik, atëherë duhet të kthehen mbrapa edhe efektet që i ka shkaktuar ai spastrim etnik, ato veprime të caktuara politike të Oliver Ivanoviqit e të rojave të urës, e të bandave të dikur Koshtunicës, e Daçiqit, e sot të Vuçiqit.

Problemi është që Qeveria e Kosovës është dorëzuar, le të themi, përpara dhunës që është përdorur prej strukturave të Serbisë në veri të Kosovës. Pas çdo dhune që Serbia e ka ushtruar atje me këto struktura të veta ka arritur, për shembull, të ndalë kthimin e shqiptarëve dhe ndërtimin e shtëpive atje në veriun e Kosovës. Dhe, kur Qeveria është zbrapsur, çfarë mesazhi ka treguar? Ka treguar që dhuna funksionon dhe është efektive, nëse dëshironi të ndalni kthimin e shqiptarëve në veri të Kosovës.

Pra, me gabimet e veta, me mosguximin e vet, me mungesën e vullnetit për veprim të qartë, Qeveria e Kosovës ka inkurajuar krimin e organizuar të bandave, të strukturave të paligjshme të Serbisë. Nuk është dashur të ndodhë kjo. Qeveria e Kosovës ka dështuar t'i shpërbëjë këto struktura paralele të Serbisë dhe, thënë të drejtën, këta shumë po e bëjnë një dallim të madh, i cili nuk ekziston, Qeveria e Kosovës, mes strukturave zyrtare të komunave zyrtare dhe të komunave paralele të paligjshme. Pse po them kështu? Qe, shumë thjesht pse: atë barrikadën që mezi e hoqën tash përpara dy jave, e cila na mbeti 4-5 vjet e kush e di sa kompromisi është bërë për atë barrikadë, atë barrikadë nuk e kanë vendosur strukturat paralele, Komuna paralele e veriut të Mitrovicës, atë e ka vendosur Goran Rakiqi, ajo është strukturë zyrtare, nuk është strukturë paralele.

Pra, këtu s'ka dallim mes strukturave të paligjshme të Serbisë dhe atyre që janë zgjedhur në mënyrë të ligjshme atje. Ju shikoni veprimet, nuk është e mjaftueshme të thuhet ky është zgjedhur prej votuesve në proces të Kosovës, e ai tjetri është më i keq, se ai tjetri po vjen nga Serbia. Ti shikoja veprimet! Ky po e vendos barrikadën, ai tjetri po e vendos barrikadën. Të njëjtë, po veprojnë njëjtë.

Çfarë dallimi ka këtu?! Këtu ka bashkëpunim, këtu ka bashkëveprim në mes të strukturave të paligjshme dhe mes strukturave zyrtare që janë kryetarët e komunave, kurrfarë dallimi nuk po e shoh unë. Së paku nëse ua analizojmë veprimet çka ka ndodhur me Republikën e Kosovës. Aq pak ka kontroll Qeveria jonë në veri të Kosovës, aq pak ka kontroll, aq e papranishme është sa që krimet kryesore, vrasjet kryesore që kanë ndodhur në veri të Kosovës kanë mbetur të pazbardhura. Nuk janë zbardhur ato vrasje, nuk ka qartësi për ato vrasje, nuk janë nxënë kriminelët që i kanë kryer këto vrasje. Vetëm kujtojeni vrasjen e Enver Zymberit, policit të nderuar të Kosovës, heroit të Kosovës, i cili u vra atje dhe dorasit e tij nuk janë zënë kurrë.

Kujtojeni vrasjen e Selver Haradinajt, pastaj jo vetëm të këtyre, po edhe të ndërkombëtarëve, një pjesëtar i EULEX-it u vra atje nga bandat e Serbisë, një pjesëtar tjetër i UNMIK-ut është vrarë po ashtu atje. Cila vrasje është zbardhur, tregomani një vrasje që është zbardhur në veri të Kosovës në këto vitet e fundit? Pse ndodh kjo? Pse nuk kemi zbardhje të vrasjeve, të krimeve atje? Po shteti nuk është i pranishëm. Nëse nuk e ke inteligjencën, nëse nuk e ke policinë, nëse nuk i ke resurset shtetërore, qysh doni ta zbuloni një krim, një vrasje që ndodh atje?

Kjo tregon se sa të pranishëm jemi ne në veriun e Kosovës. Dua t'i numëroj shpejt e shpejt edhe disa dështime të tjera të Qeverisë së Kosovës atje. Sepse dështimet atje në veri të Kosovës janë partneritet vendor dhe ndërkombëtar. Së pari, goditjen veriut të Kosovës ia ka dhënë Plani i Ahtisarit. Ndarja e Mitrovicës në dy komuna ka qenë projekt shumë i dëmshëm, se u legalizua atje dhuna e Serbisë, spastrimi etnik dhe u nda Mitrovica përmes linjave natyrore, përmes lumit Ibër është ndarë Mitrovica zyrtarisht në vitin 2008, me Planin e Ahtisarit.

E dyta, negociatat e Brukselit veç sa e kanë çuar ndarjen përtej Planit të Ahtisarit. Shikoni, produkt i negociatave të Brukselit është Asociacioni i komunave me shumicë serbe, kjo është zgjidhje përtej Planit të Ahtisarit. Plani i Ahtisarit serbëve u jep vetëm komuna, ama t'i bashkojë ato komuna, ato komuna të krijojnë qeverinë e tyre, simbole të tyre, buxhet të tyre, këtë nuk ua jep Plani i Ahtisarit, këtë po ua japin negociatat e Isa Mustafës dhe Hashim Thaçit.

Tjetra, Suhodolli. Suhodolli po i jepet komunës veriore të Mitrovicës, atje ka marrëveshje. Edita Tahiri e ka nënshkruar këtë marrëveshje, Suhodolli i ka tri zona kadastrale, dy janë dhënë me Planin e Ahtisarit, por aty ku janë banesat e shtëpitë e shqiptarëve, aty ku është vendbanimi i përqendruar, ku banojnë shqiptarët, ajo i përket jugut. Po Serbia ka dashur ta marrë tërësisht përmes lumit Ibër, vetëm kjo pjesë i ka penguar, se vetëm kjo pjesë futet atje në komunën e veriut. As atë nuk duan ta lënë, edhe atë duan ta marrin. Dhe, aq më keq që Qeveria e Kosovës është përgjigjur pozitivisht në këto ambicie hegjemoniste të Serbisë.

Pastaj, për çfarë integrimi po flasim për serbët. Po ti nuk e ke të integruar ministrin e Qeverisë së Kosovës! Ministri Stojanović shkon atje në “Luginën e Diellit”, në luginën e kolonizimit, e bashkë e prenë atje shiritin me strukturat e Vuçiqit, kryeministri del kundër “Luginës së Diellit”, ministri i tij që e ka në Qeveri shkon dhe e përshëndet. Çfarë moskonsistence është kjo! Kjo është shumë joserioze për një shtet, për një qeveri të dalë kësisoj.

Tjetra është që, për shembull, ajo çka i ndodhi ministrit Hoti. Kurrë nuk kam dëshirë ta shoh një ministër të Kosovës ashtu. Është pikëlluese ajo pamje, o ministër! Të të shohim aty përpara bandave të Vuçiqit, të ndalin e ta ndalojnë qarkullimin e lirë në Republikën e Kosovës! Edhe

integrimi i policëve, po thonë këta, veç pse i kanë veshur uniformat e Policisë së Kosovës. Po çfarë integrimi, ata policë të Kosovës rrinin 50 metra larg ministrit që e kishin ndaluar bandat e Vuçiqit, e policët e shikonin bandat e Vuçiqit edhe kishin mirëkuptim për ato. Çfarë integrimi është ky, a më tregon dikush? Çfarë integrimi i policëve që po punuakan për Kosovën është ky? Aty ka bashkëjetesë ndërmjet bandave dhe strukturave të Vuçiqit dhe Policisë, që tash veç prej MUP-it i kanë veshur teshat e Policisë së Kosovës.

Prandaj, edhe e fundit është që ky kryeministri ynë po thotë që “unë rri me këta të komunave zyrtare të Kosovës, tri-katër komunave atje të veriut, të Shtërpçës, të Klllokotit... e kështu me radhë”. Desha ta pyes, por më iku, a ka ndenjur edhe me këtë kryetarin e Klllokotit, se ia pata lënë këtu një fotografi, para nja dy muajsh, se si ushtron ai me armë nëpër poligone ilegale të veriut të Kosovës, që janë të ndërtuara prej Serbisë dhe që ushtrojnë me armë aty. Se, ky shumë mirë po di t’i marrë aktivistët e “Vetëvendosjes” e t’i mbajë nga dy-tre muaj nëpër burgje, veç pse Policia ua ka gjetur disa armë. E, desha ta pyes edhe për këtë kryetarin e Klllokotit, thashë mos rastësisht e ka takuar e mos ia ka përmendur këtë, që ai ka bërë vepër penale dhe duhet të përgjigjet para drejtësisë. Por, jo ai ka shumë mirëkuptim për këta që ushtrojnë me armë nëpër poligone ilegale në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pal Lekaj e ka fjalën, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ne sot po flasim për shtrirje të sovranitetit në veri, lëvizje të lirë, kur fatkeqësisht koïncidon marrja e drejtorit, një zyrtari të lartë të Policisë së Kosovës dhe askush nuk jep sqarim. E pyes kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Brendshme, a jemi shtet apo s’jemi?! A jemi duke bërë hajgare me shtetin tonë dhe me zyrtarët tanë?! Nuk e kam as axhë, nuk e njoh personalisht, por është zyrtar i lartë i Policisë së Kosovës.

Dhe, ju vini këtu, mbronin dhe thoni para qytetarëve, mashtroni e rreni, që në Kosovë kemi shtet! Po, çfarë shteti, bre?! Mua do të më vinte turp të rri në këta kolltukë. Dhe, askush nuk e merr përgjegjësinë për ta dhënë një sqarim. Drejtor i Policisë në Mitrovicë! Prandaj, këtu s’di pse bëjmë llafë me këtë Qeveri dhe unë mendoj se kjo është e keqja më e madhe e vendit tonë.

Të nderuar qytetarë,

Kosova për kaq vjet, sa udhëhiqet nga PDK e LDK, për ironi të fatit po ndeshet me një kontradiksion midis sovranitetit, që buron nga populli dhe bisedimeve dhe marrëveshjeve, herë teknike e herë politike, që e kanë rrëzuar vendimmarrjen sovranë. Kjo të bën të kesh dilema se kush është, në fakt, mbrojtësi i vërtetë i sovranitetit të Kosovës, populli apo Qeveria e cila ka lëshuar rrënjë në karriget dhe vetëm hedh nënshkrime, që shkojnë në favor të Serbisë. E, këtë e bëjnë në emër të sovranit popull të Kosovës.

Kosova, falë kësaj Qeverie, asaj dhe kësaj, vazhdon të ballafaqohet me sfida politike, ekonomike e të sigurisë së përgjithshme e, në veçanti, kur bëhet fjalë për pjesën veriore të Kosovës. Krimi i organizuar në kushte kur nuk kemi institucione demokratike të konsoliduara në atë pjesë ka

gjetur hapësirë për t'u zhvilluar në masë të madhe. Ekzistenca edhe më tutje e grupeve kriminele serbe, që janë edhe struktura paralele në një situatë të përshtatshme për Serbinë mund të kthehet në një rrezik të madh për sigurinë e shtetit të Kosovës.

Këto dyshime i bazojmë, sepse Serbia qëllimisht po ndërmerr hapa që shkaktojnë ndjenjën e frikës, pasigurisë dhe mosbesimin te qytetarët shqiptarë. Presion e detyrim për t'i lëshuar pronat private e gjëra të tjera, të cilat po shihen se me çfarë idesh janë bërë, për të ndërtuar lagje e fshatra, që do të jenë të pastra vetëm me serbë. Kjo do të duhej të ishte e mjaftueshme për Qeverinë e Kosovës për të kuptuar se çfarë po përgatitet të bëjë Serbia, në një të ardhme jo të largët, me atë pjesë të Kosovës.

Komunat paralele në veriun e Kosovës ende quhen “Organet e Përkohshme Administrative” nga serbët. Këto organe nxjerrin vendime për sektorin e arsimit, administratës, shëndetësisë, urbanizmit, shërbimeve publike, e tjera..., të gjitha në bazë të ligjeve të Serbisë. Kryetarët që kanë dalë nga zgjedhjet lokale të Kosovës qëndrojnë në objektet e komunave paralele dhe nuk pranojnë të identifikohen me ndonjë shenjë apo simbol të shtetit të Kosovës.

Statutet dhe vulat e këtyre komunave, edhe përkundër që s'e përmbajnë asnjë simbol të Kosovës, janë pranuar si të ligjshme nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, rrjedhimisht nga Qeveria e Kosovës.

Kolegë të nderuar,

Entuziazmi fillestar për një Kosovë të zhvilluar e për një veri të integruar, që ishte kur e shpallëm Kosovën të pavarur në vitin 2008, çdo ditë e çdo vit po kalon në një skepticizëm të përgjithshëm, kjo për fajin e një qeverie e cila ndodhet në një pikë të vdekur. Sa herë që Qeveria ka nënshkruar marrëveshje me Serbinë, në Bruksel apo kudo tjetër, na kanë thënë se me këtë po e largojmë ndikimin e Serbisë mbi Kosovën, por gjendja reale, sidomos në pjesën veriore, e thotë të kundërtën - është ende e përkeqësuar. Fatkeqësisht, nga këto bisedime po krijoni rregulla, që veriun po e largojnë çdo ditë e më shumë nga tërësia e rregullimit ligjor politik të Kosovës.

E tërë energjia e shtetit, e cila do të duhej të shpenzohej në përmirësimin e temave të brendshme e që janë në interes të qytetarëve të Kosovës po shpenzohet në këto bisedime. Sot, falë hutisë suaj për të integruar Serbinë në BE, se Kosova jo se jo, qytetarët e Kosovës përdorin tabela prej letre në makinat e tyre, shëndetësinë e kemi në kolaps, ku mungon çdo gjë. Pastaj, shkollat lëre që nuk pajisen me libra, edhe pse ndahen miliona euro për to, por edhe kushtet e punës në disa prej tyre janë për të ardhur gjynah, e rendin e ligjin e ka marrë krimi në dorë, në veri të Mitrovicës.

Por, realiteti për pjesën veriore është krejt e kundërta çfarë thotë Qeveria e Kosovës. Ëndërrojnë kinse po bëjnë diçka me veriun, prandaj me të drejtë themi se kjo qeveri e ka shndërruar këtë pjesë në një “pus të ndotur” që nuk do t'i dihet fundi e për të cilën nuk do të përfundojnë problemet kurrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash për “Nismën” kush flet në emër të grupit. Mirë, deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Më vjen keq që kryeministri është në bufe, por edhe atje është një televizor, ndoshta na dëgjon, së paku.

Trajtohet njëra nga çështjet më serioze për shtetin, pra një pjesë e territorit të Kosovës, e cila vazhdon të jetë e okupuar nga Serbia dhe subjekti më i madh parlamentar prej 36 deputetëve vetëm 5 i ka këtu. Edhe vetë kryetari i Parlamentit vjen nga ai rajon dhe kjo tregon se sa jemi seriozë në trajtimin e këtyre problemeve shqetësuese në vazhdimësi, që nga lufta për liri që është zhvilluar në Kosovë.

Realiteti i krijuar, tashmë tragjik, për vendin, që nuk respekton ligjet dhe Kushtetutën e vendit dhe që quhet “pjesa veriore e Kosovës” fillon që nga paslufta dhe, në fakt, pas dërmimit që i bëri UÇK-ja dhe forcat e NATO-s regjimit fashist të Serbisë, në vitin 2000 në shkurt u bë rimobilizimi i bandave kriminele të Serbisë dhe në fillim të shkurtit të vitit 2000 filloi realizimi i një projekti, që ne tash e llogaritim si një “realitet i hidhur” që është krijuar. Pra, u vranë dhjetë qytetarë, në atë kohë u shpërngulën 1 564 familje shqiptare nga ajo pjesë dhe afër 12 mijë qytetarë shqiptarë e lëshuan atë pjesë të Kosovës. Kjo pra ka qenë strategjia mbi të cilën shumë vasalë dhe servilë, pakurrizorë e butakë të politikës nënshtruese të Serbisë, që janë në institucionet e Kosovës, e realizuan këtë projekt me mjeshtri. Pra, situata që filloi në shkurtin e vitit 2000 e vazhdon edhe sot, me djegie e vrasje edhe të fëmijëve, edhe të qytetarëve, edhe të zyrtarëve institucionalë, vazhdoi për vite të tëra.

Pas shpalljes së pavarësisë ne menduam, se gjërat do të bien në vendin e vet, por për fatin e keq të vendit, në krye të institucioneve vendoset Hashim Thaçi, një njeri për të cilin tashmë kanë dilemë edhe fëmijët në Kosovë, i cili për ta vazhduar projektin e copëtimit të Kosovës e realizoi një projekt shumë djallëzor, më 25 korrik 2011, kur e çoi një pjesë të djemve dhe vajzave të Kosovës, të Policisë, ku u vra një djalë i mirë i Policisë së Kosovës, Enver Zymberi. E dini pse ndodhi kjo? Për t’i arsyetuar pastaj bisedimet në Bruksel që pasojnë, që fillimisht u quajtën “teknike” dhe ato rrodhën më shumë se politike. Pra, vazhdimësia e krijimit të një realiteti, një bosnjëzimi në atë pjesë të vendit, tashmë kaloi në një etapë tjetër. Dhe, kjo fazë e dytë, që po vazhdon edhe sot me Isa Mustafën, unë mendoj se duhet të ndalet.

Bisedimet që filluan në Bruksel, që fillimisht, siç e thashë, janë trumbetuar si “bisedime teknike”, ato ishin një projekt i bërë më herët dhe për fatin e keq të vendit, aktorët politikë të politikës kosovare në institucione me gjasë u bënë edhe figura shahu në një lojë që luhet nga shahistë, për të cilët këta nuk e dinin se kush i lëvizën.

Dëmi më i madh që vazhdoi ta “trashë” të zezën për Kosovën rreth asaj pjese ishte Marrëveshja e Brukselit. Marrëveshja e 19 prillit 2013 është në vazhden e copëtimit të Kosovës, tashmë në forma dhe në legalizimin e atij realiteti, duke rehabilituar bandat kriminele të Serbisë, që bazën e ka te politika shoviniste serbe dhe që është bartur deri te Qeveria aktuale e Serbisë.

Në ato pika të marrëveshjes, në pikën 1, 2, 5, 6 dhe 9 sigurisht se flitet për Asociacionin, pra për “Zajednicën”, e cila tash do ta institucionalizojë ndarjen e Kosovës dhe aktorët të cilët i kanë

prirë asaj ndarjeje, që kanë masakruar e detyruar shqiptarët që të ikin nga ajo pjesë. Dhe, nga kjo marrëveshje derivojnë edhe marrëveshje tepër të dëmshme, antikushtetuese, siç është marrëveshja për Drejtësinë, ku krijohen organe të Drejtësisë mbi baza etnike, ku bëhet marrëveshja për Policinë dhe të gjithë ata banditë, në vend se të shkojnë në burg, sot i ke në Policinë e Kosovës dhe është shumë normale, siç tha Glauku, bile çudi qysh s'e kanë burgosur ministrin atje. Pra, me marrëveshjen e Brukselit po legalizohet, për mendimin tim, copëtimi i Kosovës.

Këto marrëveshje me këmbëngulësinë më të madhe të Parlamentit duhet të ndërpriten, sepse në rast se nuk ndërpriten sot, dikur do të jetë vonë. Siç e thashë, bandat paramilitare të Serbisë, që janë quajtur “Rojat e Urës” e lloj-lloj emrash, sot i ke në Policinë e Kosovës. Ke edhe një projekt, i cili përkohësisht është ndaluar, kolonizimi i asaj pjese në “Luginën e Diellit”. Pra, copëtimi i Kosovës po bëhet edhe me ndihmën e të zgjedhurve të qytetarëve të Kosovës, kushtimisht po them të komunitetit shqiptar, të filluar nga Hashim Thaçi dhe po vazhdon nga Isa Mustafa.

Në rast se nuk ndalet kjo, ne do të kemi një Bosnje të dytë, ose realisht një Krime të Ukrainës, sepse parakushtet që janë filluar me vrasje të bandave të Serbisë ndaj qytetarëve shqiptarë me shpërnguljet masive dhe me kolonizimin e asaj pjese janë duke u krijuar parakushtet për këtë situatë tepër të pakëndshme, që mund t'i vijë vendit.

Unë mendoj se ky Parlament ka përgjegjësi që të gjitha këto që kanë ndodhur t'i rikthejë në pikën zero. Realitetin për okupimin dhe copëtimin e asaj pjese, që është krijuar nga bandat e Milosheviqit dhe qeverive pasuese, të ndihmuar nga Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa, duhet të ndalen, sepse unë mendoj se kështu nuk i kontribuojmë as perspektivës së Kosovës, as të rajonit, as edhe të Evropës. Ne e lëmë një vatër të hapur, një mosmarrëveshje, e pse jo edhe një luftë të re me Serbinë, sepse ne kemi parasysh politikën shoviniste të Serbisë, ambiciet për territore të Serbisë dhe inspiruesit e kësaj politike, ne e dimë se e kanë adresën në Moskë, ata janë në atë pjesë duke praktikuar diçka të këfillë dhe që, natyrisht, ajo shkollë do të praktikohet edhe nga Serbia.

Ne, natyrisht, se e duam një Serbi ndryshe, po ja që nuk është ajo Serbi ndryshe. Serbia është një shtet që Kosovën ende e llogarit provincë të saj edhe me Kushtetutë dhe ne të bisedojmë me një shtet që na llogarit si provincë është më shumë se nënshtrim që i bëjmë atij shteti, në emër të shtetit të Kosovës, çdo centimetër i të cilit shtet është i larë me gjak. Unë besoj se zoti Isa Mustafa, po i referohem përafërsisht, diçka që tha “Jemi përcaktuar për dialog, por marrëveshjet e arritura nuk respektohen nga Serbia”. Asnjëherë, s'do të respektohen. Edhe në rast se respektohen, respektohen deri në atë shkallë, sa që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zafir, e harxhove kohën. S'ka koleg, kaq e ke, Zafir! Faleminderit!

Atëherë, për t'ua bërë pak më të qartë, sepse... Unë e lexova herën tjetër, por po harrojnë njerëzit. AAK-ja i ka edhe 5 minuta, kushdo që të flasë. “Vetëvendosja” i ka edhe 12 minuta e 22 sekonda. LDK-ja i ka edhe 36 minuta, PDK-ja i ka 37, “6+”-i s'është paraqitur, e tjera...

Fjalën e ka kërkuar Armend Zemaj. S'është këtu. Atëherë, LDK-ja e humb rendin dhe rendin e merr "Vetëvendosje", Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Një nga segmentet kryesore të sovranitetit është edhe përbërja dhe funksionimi i pushtetit gjyqësor. Mosfunksionimi i pushtetit gjyqësor nënkupton se rendi juridik është inekzistent në hapësirë dhe kohë brenda një territori të caktuar.

Dorëzimi i Qeverisë së Kosovës karshi Serbisë në aspektin e instalimit dhe funksionalizimit të pushtetit gjyqësor në gjithë vendin nënkupton edhe dorëzimin e territorit nën sovranitetin e një shteti tjetër.

Në vitin 2013, ky Kuvend, ose thënë më saktë deputetët e PDK-së dhe LDK-së e votuan Ligjin për amnisti, që më pas u parapriu zgjedhjeve lokale të po atij viti në Republikën e Kosovës. Sot nuk ka askush më dyshim se ndërlidhshmëria e këtyre dy fenomeneve është pjesë e kolazhit të marrëveshjes Thaçi-Daçiq, nga ku u prodhua Lista serbe.

Pas formalizimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, procesi i legalizimit të strukturave paralele dhe legalitetit të krijesës së quajtur "Asociacion i Komunave Serbe", pra "Zajednicës" i ka paraprirë amnistia e të gjithë bartësve të institucioneve paralele ilegale, të cilat ende sot janë duke u financuar nga Serbia dhe nuk po pengohen fare nga Qeveria e Isa Mustafës.

Siç e kemi thënë edhe në atë kohë, në analizën e Ligjit për amnisti, deputetët e PDK-së dhe LDK-së amnistuan 31 lloje të krimeve të strukturave ilegale të Serbisë në Kosovë. Pra, Ligji për amnisti, përveçse u ka shërbyer kriminelëve serbë në veri, ai gjithashtu e ka pasivizuar Prokurorinë e shtetit që në të ardhmen t'i ndjekë kriminelët, të cilët jo vetëm se nuk e njohin shtetin e Kosovës, por e luftuan dhe po e luftojnë me qëllim të rrënimit të institucioneve shtetërore, që është figurë kryesore e veprave penale për të cilat këto struktura janë amnistuar.

Për shembull, në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, si për shembull, në Mitrovicë të veriut ishin Kristomir Pantiq dhe Oliver Ivanoviqi, që të dy të involvuar drejtpërdrejt në struktura paralele, të involvuar në trazirat e pasluftës, me qëllim të dëbimit të popullsisë shqiptare nga veriu i Mitrovicës, por edhe para luftës si pjesëtarë të formacioneve paramilitare serbe.

Zgjedhjet e 3 nëntorit 2013 kontrolloheshin nga kryerësit e veprave penale kundër shtetit, që përkundër amnistimit të tyre për këto vepra, para datës 20 qershor 2013, ata duke i kryer po këto vepra pas kësaj date ishin pjesë e procesit zgjedhor, pa e njohur fare shtetin e Kosovës. Është folur shumë për shuarjen e strukturave paralele, por në asnjë moment ne nuk kemi qenë dëshmitarë të shuarjes së ndonjë institucioni, që nga koha e ratifikimit të asaj marrëveshjeje, miratimit të Ligjit për amnisti dhe, së fundmi, përfundimit të procesit zgjedhor.

Pra, përderisa në prill të vitit 2013 e kishim një strukturë të quajtur "Rojat e Urës", pas Marrëveshjes së Brukselit e kemi formacionin e quajtur "Mbrotjtja Civile", të cilin Qeveria Mustafa po e integron, siç po thotë, në Policinë e Kosovës. Nga Kristomir Pantiq, që ishte njëri

nga kryerësit e veprave penale kundër shtetit, tani e kemi një kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut, të legalizuar dhe të certifikuar nga KQZ-ja në procesin zgjedhor, pa sovranitet shtetëror. Ndër vendimet e para dhe të dëmshme të Isa Mustafës ishte edhe nënshkrimi i Marrëveshjes për Drejtësinë më 20 shkurt 2015, me anë të së cilës u shpërfill në mënyrë flagrante sistemi i Drejtësisë, duke krijuar enkas për serbët Gjykatën e Apelit në veri dhe duke aplikuar diskriminimin mbi baza etnike për drejtuesit e gjykatave dhe të Prokurorisë.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë më as nuk mund të themi se është i pavarur, as i paanshëm dhe as nuk garanton barazi për të gjithë, si pasojë e kësaj marrëveshjeje. Tani, pasi i kanë bërë gati listat e gjyqtarëve të përzgjedhur sipas etnisë dhe jo sipas aftësisë, presidenti i vetëquajtur na ofron talljen e radhës, duke njoftuar se nuk do t'i dekretojë. Sigurisht që këtë po e bën, jo se ka merak se cilët do të jenë ata që do ta ndajnë drejtësinë në Kosovë, por sepse duhet t'i njihet atij për borxh nga secili emër, se ka kaluar falë firmës së Hashim Thaçit.

Edhe në ditët e sotme, përkundër gënjeshtreve të orkestruara nga Qeveria me tellallin e quajtur Edita Tahiri, Serbia e ka të instaluar pushtetin gjyqësor në veriun e Kosovës. Serbia gjatë këtyre viteve e ka sofistikuar metodologjinë e përkrahjes dhe mirëmbajtjes së sistemit të saj paralel, të instaluar në Republikën e Kosovës. Shembull, nëse lexohet Ligji për Buxhetin e Serbisë për vitin 2016 mund të shihni se vijat buxhetore për institucionet paralele në Kosovë nuk janë të theksuara qartë si vija të veçanta buxhetore, por janë kamufluar në buxhetin e të ashtuquajturës “Zyrë Koordinuese për Kosovë dhe Metohi”.

Pra, institucionet e Republikës së Kosovës kanë dështuar që ta instalojnë sistemin e Drejtësisë në pjesën veriore të vendit dhe nuk bëhet normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, në fakt, ju po e instaloni një sistem të Drejtësisë të bazuar në struktura etnike. Për këtë ka pasur ankesa edhe nga komunitetet tjera në Republikën e Kosovës dhe të gjithë jemi dëshmitarë dhe lexues të marrëveshjes së 10 shkurtit, ku kryenegociatori Isa Mustafa u pajtua me Vuçiqin për t'i ndarë postet në Gjyqësor sipas përkatësisë etnike, thuaja se kjo marrëveshje është duke u bërë për këmbimin e “tokave të shenjta” të kryenegociatorit Mustafa dhe jo të një sistemi aq të rëndësishëm të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Haxhiu! Atëherë, Enver Hoti nga “Nisma”. Do ta marrësh fjalën? Le ta marrë fjalën Teuta Haxhiu, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Teutë, pesë minuta i ke.

Shikoni, ky është solidariteti i jashtëzakonshëm, po njeriu është këtu... ju të dy jeni. Unë të respektova ty, tash ti po e kalon. Ali Berisha atëherë e ka fjalën.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Qeverisja e dobët po reflektohet natyrshëm edhe në pjesën veriore të Republikës, e cila edhe pse formalisht duhej të administrohej nga autoritetet kosovare, praktikisht po varet tërësisht nga Serbia dhe të emëruarit e saj, qoftë në nivele lokale apo qendrore. Është dështim i madh i Qeverisë që edhe pas bisedimeve në Bruksel dhe marrëveshjeve të arritura nuk po arrin ta integrojë atë pjesë.

Një dështim i madh është mosfunktionalizimi i sistemit të Drejtësisë, që sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës do të duhej të shtrihej në tërë territorin e Kosovës. Për fat të keq, zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit për drejtësi nuk po zbatohet. Në marrëveshjen e arritur ndërmjet dy kryeministrave, atij të Kosovës dhe atij të Serbisë, është paraparë që një gjykatë themelore dhe një prokurori themelore të funksionojë për rajonin e Mitrovicës. Edhe pse Këshilli Gjyqësor i Kosovës beson se në tetor do të nisë puna e Gjykatës Themelore në veri, kjo duket e pamundur. Aktualisht, Gjykata është totalisht e bllokuar. Gjykatësit shqiptarë u detyruan të punojnë në Gjykatën e Vushtrrisë, në jug të vendit, në kushte të papërshtatshme për punë të gjykatës.

Këta gjykatës nuk kanë kurrfarë informacioni se çfarë është duke ndodhur aktualisht dhe kjo flet shumë për papërgjegjësinë e Qeverisë, në radhë të parë, që është e obliguar të krijojë kushte për punë në secilin institucion. Sa më tepër të zgjasë kjo situatë, aq më shumë do të shkelen të drejtat e njeriut në veri të Kosovës.

Qeveria e Kosovës nuk është duke i kryer obligimet e veta në mënyrë që të ofrojë kushte për integrim të pjesës veriore në strukturat e sistemit të Drejtësisë në Kosovë. Problemet në veri janë të shumta. Po, ju kryeministër, e tregoni indiferencën ndaj kësaj pjese të Republikës, jo thjesht duke mos guxuar që ta vizitoni atë, por edhe duke mos arritur ta ushtroni autoritetin shtetëror atje. Veriu, edhe pse përfiton miliona nëpërmjet fondeve të posaçëm për veriu, sipas përfaqësuesve të bizneseve, qytetarëve, raporteve policore e doganore, mbetet oazë e trafikëve të paligjshme dhe kontrabandës. Çfarë keni bërë ju si kreu i Qeverisë për ta ndalur kontrabandën, e cila ka pasoja të rënda ekonomike për mbarë Kosovën?

Një çështje tjetër e pazgjidhur është kthimi i shqiptarëve në pronat e tyre në pjesën veriore. Kjo e drejtë vazhdon të shkelet dhe nëse nuk ka organe funksionale atje, atëherë kjo do të bëhet edhe më e pafavorshme për shqiptarët.

Qeveritë e Kosovës kanë investuar mjete materiale për rindërtimin e ndërtimin e shtëpive të reja për serbët, ndërsa shqiptarëve vazhdimisht u mohohet kjo e drejtë. Ju, si Qeveri, po shfaqeni të pafuqishëm që ta integroni veriu me jugun e Mitrovicës, ndërsa ajo që është folur për shumë kohë për Urën e Ibrit, si mekanizëm i bashkimit të qytetit, po vazhdon të neglizhohet.

Të nderuar deputetë,

Serbia me veprimet e saj të përditshme, siç ishte edhe ai i mbrëmshmi, po edhe të tjera, është duke e poshtëruar Kosovën. Nuk duhet asnjë qytetar ta ndiej veten mirë. Është koha e fundit që këto bisedime të degraduara totalisht të rishikohen. Qeveria të marrë masa që këto bisedime edhe një herë ta kenë një trajtim tjetër, pasi janë të padrejta dhe përfituese është vetëm njëra anë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar të pranishëm dhe ju zoti kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Është një temë me rëndësi, e cila e preokupon secilin prej nesh. Ka të bëjë përgjithësisht me atë që quhet shtetësi dhe shtrirje e sovranitetit, prandaj kjo gjë po vazhdon t'i sfidojë institucionet e Republikës së Kosovës, prandaj them se është shqetësim për të gjithë ne dhe secili ka çfarë të thotë nga pjesa e punës dhe obligimeve që ka.

Në këtë aspekt, unë do të ndalem tek ajo që në këtë mandat bart, Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe njësitë e të drejtave të njeriut në këto komuna.

Republika e Kosovës në Kushtetutën e vet i ka vënë themelet e një shteti demokratik, bazament i bërë me standardet më të larta të respektimit të të drejtave të qytetarëve të saj, duke qenë kështu modeli më i avancuar i respektimit të pakicave, gjë e cila nuk ndodh në asnjë moment, as në shtetet përreth, në shtetet fqinje, por edhe ato të cilat ne edhe i njohim, si me demokraci të zhvilluar.

Përkundër krejt kësaj tolerance, pas një spastrimi etnik atje, që siç e dimë edhe nga raportet e regjistruara, ky raport i popullatës nuk ka qenë as në kohën e spastrimit të Milosheviqit, nga popullata e vetizoluar vazhdon të mbizotërojë mosbesimi ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Në vijimësi vazhdon keqpërdorimi i popullatës serbe për llogari të Beogradit dhe, si rrjedhojë, për çdo ditë, në vend të akomodimit të interesave të qytetarëve lokalë atje, për fat të keq, është tendencë e vazhdueshme që në rend dite të futen interesat e akomodimit të Serbisë.

Institucionet e Republikës së Kosovës vazhdojnë të sfidohen nga mohimi i shtrirjes së respektimit të juridiksionit të Republikës së Kosovës dhe për tejkalim të kësaj situete normalisht që duhen funksione apo role të shumëfishta, roli i institucioneve të Republikës së Kosovës, para së gjithash, roli i popullatës serbe atje, roli i bashkësisë ndërkombëtare, e po ashtu edhe respektimi i aktit më të lartë juridik, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila ka brenda vetes edhe mekanizma dhe instrumente ndërkombëtare të zbatuara drejtpërdrejt në Kushtetutën e Republikës. Si rrjedhojë e kësaj, një mohim i tillë është sfidë edhe për mekanizmat dhe instrumentet ndërkombëtare, gjë që atë e bën shumë më obligative që të mos rrijë e heshtur apo të jetë shumë aktive në punën e saj në këtë drejtim.

Për fat të keq, gjithë ato që u përmendën këtu, edhe liria e lëvizjes, cenohet qasja në prona, ditë më parë komisioni ynë ka pritur edhe disa fëmijë, të cilët... e këtu është edhe ministri i Arsimit, mund ta thotë më mirë, nëse ka progres në këtë drejtim, por nuk e kemi ditur që ende ka nxënës shqiptarë atje, që kanë mbetur që në kontejnerë ta zhvillojnë mësimin. Mendoj se është alarm për ne dhe besoj se ministri do të veprojë sa më shpejt që ata nxënës shqiptarë atje ta ndiejnë shijen e lirisë dhe të shtetit. Ata janë optimistë në institucione, ministër, dhe besoj se do të ketë progres në këtë drejtim. Po ashtu, siç e dimë, pa i përmendur edhe sulmet të nxënësit drejtpërdrejt dhe gjëra të tjera, të cilat na bëjnë neve shumë më obligativë që të veprojmë.

Vite më parë, me Ligjin për administrim të pushtetit lokal, ministria e ka lëshuar Udhëzimin administrativ, me të cilin i ka formuar njësitë e të drejtave të njeriut nëpër komuna. Për fat të keq, Komisioni për të Drejtat e Njeriut në planin vjetor e ka bërë monitorimin e këtyre njësive nëpër komuna, por nuk ka arritur të shkojë në veri dhe pastaj kemi marrë informatë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që këto njësi as nuk janë themeluar atje, që do të thotë se nuk ekziston as gatishmëri minimale, që të respektohet kjo e drejtë dhe do të ishte esenciale, ndoshta

për të parë se si duhet të lëvizim atje për të evidentuar atë që së pari quhet standard i sjelljes, duke mos i parë ndoshta edhe gjërat tjera.

Unë, prapë atë që e prezantoi kryeministri Mustafa, si përpjekje për të vazhduar që t'i kryejmë detyrat tona si shtet, është për t'u përshëndetur, por gjithsecili nga ne, me angazhime të shtuara, mund të bëjmë edhe më shumë që të ecim më tutje në avancimin edhe në shtrirjen e sovranitetit përgjithësisht dhe të të drejtave tona, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e merr Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Para se të vazhdoj aty ku e lanë kolegët e mi, duhet edhe një herë të ngre në vëmendjen tuaj se përse po hesht Qeveria e Kosovës, kryeministri, ministri i Brendshëm, me rastin e arrestimit të një oficeri të Policisë së Kosovës në Serbi? Pra, ai është një oficer policie, është një veteran i luftës së UÇK-së dhe këtu po heshtet. Unë nuk po kuptoj përse!

Sidoqoftë, Qeveria duhet të bëjë gjithçka që ai sa më shpejt të kthehet e kur të kthehet do të duhej ta pyesnim dhe ta merrnim në përgjegjësi përse ai kaloi në një territor, ku në fakt kontrollohet nga një polici armiqësore.

Sidoqoftë, unë po vazhdoj aty ku e lanë kolegët e mi sa i përket interpelancës për situatën në veri të vendit.

Situata e sigurisë në veri të vendit është jashtë kontrollit dhe kjo është tashmë e ditur, sepse sikur një situatë ku mbizotërojnë organizatat kriminele të jetë nën kontroll, atëherë i bie që Qeveria e Kosovës po e kontrollojka një situatë kriminele atje. Atje asnjëherë nuk ka ndodhur njëkohësisht as shpërbërja dhe çarmatosja e strukturave të sigurisë së Serbisë, të cilat e kontrollojnë atë pjesë të Kosovës.

Deri në shkurt të vitit 2000 në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës me rrethinë kanë qenë afro 60% shqiptarë. Një nga matësit e kësaj përqindjeje kanë qenë edhe matësit e orëve elektrike që kanë qenë atje. Në shkurt të atij viti vazhdoi spastrimi etnik, e theksoj: vazhdoi, sepse nuk kishte filluar atë ditë spastrimi etnik ndaj shqiptarëve dhe në këtë rast të prirë, jo nga Arkani e Shesheli, por nga Oliver Ivanoviq, atje u përzunë 1 600 familje shqiptare, u vranë 11 shqiptarë dhe po ashtu diku përafërsisht i bie rreth 11 mijë shqiptarë qytetarë u zhvendosën nga ajo pjesë prej shtëpive dhe banesave të tyre, që i bie se plani i spastrimit etnik po vazhdon të jetësohet edhe atë ditë, edhe tani, për shkak se Oliver Ivanoviqi, në fakt, po gjykohet atje, por efekti i veprimit të tij nuk është kthyer. Dhe, po vazhdon spastrimi etnik, përderisa asnjë nga qytetarët nuk është kthyer atje, të cilët ishin zhvendosur si pasojë e një fushate për spastrim etnik në qytetin e Mitrovicës.

Nuk mund të mos e tërheqim një paralele tjetër, kur insistimi i Qeverisë së Kosovës e urdhëron Policinë e Kosovës që t'i përgjakë banorët shqiptarë të Mushtishtit, duke tentuar t'ua hapë rrugën atyre që asnjëherë nuk u përgjigjën për krimet që bënë ndaj bashkëfshatarëve të tyre, e në ndërkohë të njëjtën gjë e bënë edhe kur shqiptarët duan të kthehen në pjesët e tyre, në fshatrat e tyre, në pjesën veriore të Mitrovicës, pra. Në vend se t'ua hapë rrugë, shqiptarët i pengon për kthim atje.

Në të gjitha negociatat me Serbinë, pushteti i Kosovës, pra kjo Qeveri, nuk bëri asgjë që strukturat e Serbisë të largohen nga Kosova, por përkundrazi me këto negociata, ato vetëm i kanë mirëmbajtur disa brenda Policisë së Kosovës, disa brenda këtij Parlamenti, disa brenda Qeverisë, e disa të mirëmbajtura si struktura të Serbisë në Kosovë. Pra, ato struktura po e vazhdojnë aktivitetin e tyre edhe tani.

E, ato struktura, përveçse e kontrollojnë atë pjesë, kanë vepruar në mënyrë operacionale me njësi të armatosura. Atje është vrarë një oficer i Policisë së Kosovës, siç është Enver Zymberi, atje është vrarë një oficer doganier, pra lituanes i EULEX-it, atje është vrarë edhe Silver Hajradinaj në shtëpinë e tij, atje është sulmuar edhe KFOR-i, në ndërkohë Qeveria e Kosovës në vazhdimësi është kujdesur që shqiptarët të mos kthehen në veri, sepse, sipas saj, po e provokuakan situatën që shqiptarët të mos reagojnë kur të kthehen serbët që kanë bërë krime, para se ata të gjykohen, që strukturat e sigurisë së Serbisë ose të legalizohen, ose të mos pengohen në aktivitetin e tyre në Kosovë, që t'u ruajmë përmendoret e Milosheviqit në formë kishash, siç ndodh kjo në kampusin e Universitetit të Prishtinës, që të realizohet "Zajednica" si projekt i Serbisë, që të rikthehet Telekom i Serbisë, qoftë edhe përkohësisht në Kosovë, që Policia e Kosovës e stacioneve këndeje Ibrit të mos guxojë të kalojë përtej Urës së Ibrit apo përtej Lumit Ibër në veri, e tjera, e tjera...

Po ashtu, nuk është kujdesur asnjëherë për sigurinë dhe mirëqenien e shqiptarëve në Çabër, Boletin, Koshutovë, Cerajë, Bistricë, në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë, e kudo ku ka shqiptarë andej. Pra, Qeveria kuislinge e Kosovës ka vazhduar herë të jetë aktore pasive e herë aktive në realizimin e ndarjes së Kosovës në veri e jug dhe e planeve të Serbisë për ta mbajtur nën kontroll Kosovën.

Zonja dhe zotërinj,

Shumë eksponentë të pushtetit qendror në të kaluarën dhe në të tashmen vijnë nga rajoni i Mitrovicës. Nga atje ka ardhur edhe kryeministri i parë i bashkëqeverisjes, Rexhepi. Nga atje ka ardhur edhe ish-kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Enver Peci, nga atje kanë ardhur edhe ministra e pushtetarë të tjerë, nga atje vjen edhe ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Hasani, nga atje tani është edhe ministrja e Drejtësisë, Hoxha, nga atje vjen edhe kryetari i sotëm i Kuvendit të Kosovës, Veseli, por megjithatë atje veç sa po rëndohet edhe më shumë situata.

Praktika të tilla i njohim edhe në të kaluarën e Jugosllavisë, ndonëse në një raport krejt tjetër, por diçka kanë të përbashkët. Ndonëse, raporti nuk është i njëjtë me situatën e tanishme, kur Sinan Hasani mbërrinte deri në krye të Jugosllavisë, situata në Kosovë vetëm përkeqësohej. Me gjithë këtë situatë, zgjidhja nuk mund të gjendet nëpërmjet arkitektëve të kësaj situatë. Ata që e kanë krijuar këtë situatë nuk mund edhe ta zgjidhin. Situata në Kosovë nuk mund të zgjidhet me bisedime me Serbinë, përkundrazi duhet që të mënjanohen shkaktarët e kësaj situatë, që të fillojë zgjidhja e problemeve në veri të vendit dhe në Kosovë, në përgjithësi.

Pra, për situatën e keqe në veri të Republikës shkaktarë janë Qeveria e Beogradit dhe Qeveria e Kosovës, të cilat janë dakorduar për një situatë të tillë në veri të vendit. Vetëm pa Serbinë dhe pa këtë qeveri mund të fillojë zgjidhja e kësaj situatë.

Prandaj, dorëheqja dhe largimi i strukturave të Serbisë nga Kosova garantojnë kthim në kursin e duhur të shtetbërjes së Kosovës.

KRYESUESI: Fjalën e merr Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo kërkesë për interpelancë në formën, në të cilën po parashtrohet dhe në momentin aktual të parashtrimit dhe të situatës në veri dhe gjendjes atje dhe gjuhës të përdorur sot, do të korrespondonte sigurisht me vitin 1999, 2000 apo 2001.

Kur flasim për situatën në veri duhet të jemi real, ta shohim situatën nga fillimi i saj, i problematikës së krijuar, fuqisë reale të shqiptarëve menjëherë pas vitit 1999, autoritetin e krijuar pas përfundimit të luftës dhe strukturat të cilat e kanë kontrolluar atë situatë atje.

Sigurisht se sot situata është shumë më e mirë, por kur flasim për situatën në veri duhet folur dhe falënderuar së pari banorët shqiptarë të pjesës veriore, të cilët rezistuan atje edhe gjatë '98-tës edhe '99-tës gjatë kohës së luftës, edhe pas luftës, të gjithë ata banorë shqiptarë të veriut janë heronj të Kosovës, sepse sot edhe kjo interpelancë po ftohet duke iu falënderuar vetëm atyre atje, e ndoshta edhe dikush këtu e bën për qëllime politike, por të gjithë ata që sot qëndrojnë në veri nuk qëndrojnë për qëllime politike, por qëndrojnë në tokën e tyre, në shtëpinë e tyre, për të jetuar dhe lëvizur të lirë. Dhe, asnjëherë prej '99-tës e deri më sot shqiptarët në pjesën veriore nuk lëvizin më lirë se sot. Dhe, këtë duhet thënë hapuri, situata nuk është e mirë në veri, por shqiptarët sot në veri lëvizin më lirshëm se sa kanë lëvizur ndonjëherë prej '99-tës e tutje. Dhe, sot mund të shkosh deri në pikën kufitare 1 dhe 31, mund të pish kafe në Leposaviq, mund të pish edhe në Zubin-Potok dhe asnjëherë Çabra më e sigurt se sot nuk ka qenë. Çabra ka qenë e rrezikuar në 1999-tën, e gjithashtu edhe Lagjja e Boshnjakëve ka qenë në 1999-tën, 2000-tën dhe 2001-tën. Kemi dëshmor të ramë për atë pjesë, Avni Haradinaj, i cili ka shkuar në Lagjen e Boshnjakëve për të shpëtuar familjarët shqiptarë dhe shqiptarët që rrezikoheshin nga strukturat e atëhershme.

Sigurisht, vepra dhe vendimi i Qeverisë për shtrirjen e sovranitetit në veri dhe vepra heroike e policit, Zymberi, në pjesën veriore, duke rënë atje, është një nga sakrificat që ky shtet i ka bërë për shtrirjen e sovranitetit atje.

Rrezikimet e tjera të familjeve shqiptare kanë qenë permanente, por sot në atë pjesë veprojnë struktura të zgjedhura dhe ne nuk mund t'ua përcaktojmë se cilin kryetar komune do të zgjedhin atje, por nëse shqiptarët janë më të vëmendshëm, më unikë si subjekte politike edhe në pjesën veriore, sigurisht se ndikimi i tyre në vendimmarrje në asamblетë komunale, në komunat shqiptare, do të jetë më i madh. Prandaj, nëse ne u ikim interesave të ngushta politike dhe atje e ndjekim interesin shtetëror, atëherë sigurisht se një gjë e tillë është më e mundshme.

Sot mund ta akuzojmë ministrin se nuk po bën, ndoshta, maksimumin, por të mos harrojmë se ata që sot po e akuzojnë ministrin e Punëve të Brendshme për shtrirjen e sovranitetit edhe më shumë në pjesën veriore, në 1999-tën dhe 2000-tën kanë qenë ministra të Punëve të Brendshme në Qeverinë e përkohshme.

Dhe, kur këto struktura uzurpatore në veri janë vendosur atje, sigurisht se ish-ministri i Punëve të Brendshme i asaj kohe në Qeverinë e përkohshme, ose vëllezërit e tij kanë qenë të ngarkuar me uzurpime në Klinë dhe në Prishtinë.

Edhe kjo duhet të thuhet, sigurisht. Prandaj nëse sot kjo temë po hapet, po hapet për qëllime politike, por jo për ndonjë ndikim pozitiv në jetën e qytetarëve në veri.

Jeta e qytetarëve në veri sot është më e mirë se sa që ka qenë dje dhe sigurisht se me një angazhim të të gjithëve, do të jetë edhe më e mirë. Do të jetë edhe më e mirë nëse nuk e përdorim veriu për qëllime politike, por e përdorim si institucion, si pjesë e këtij vendi, për qëllimin më të mirë dhe që çdo qytetar atje të ndjehet i lirë.

Në sot kemi investime edhe në fshatra, në pjesën e Albanikut. Investimet kanë përfunduar edhe në pjesën e Zubin-Potokut. Çabra sot është mirë. Janë shtrirë investime në pjesët më të thella të veriut.

Mirëpo, gjithsesi duhet thënë një fakt. Deri në vitin 2008 ka qenë një tentativë e lëvizjes së qytetarëve nga veriu në jug. Dhe, pas vitit 2008, me ardhjen në qeveri të kryeministrit Thaçi, ka filluar një zhvendosje tjetër e qytetarëve, ka filluar vendosja e qytetarëve nga jugu në veri dhe kemi rindërtimin e shtëpive, projekt i Qeverisë Thaçi 1 dhe 2, në pjesën veriore dhe kthimin e vendosjen e shqiptarëve në atë pjesë.

Ky kthim nuk është i mjaftueshëm. Ende ka banesa të uzurpuara në veri dhe përderisa gjykatat marrin vendim për lirin e atyre banesave të uzurpuara, të projekteve JU e të tjera në Prishtinë, sigurisht se një gjë e tillë duhet të ndodhë edhe me vendimet për pjesën veriore për lirin e çdo prone, e cila është uzurpuar në veri.

Prandaj, kur flasim për veriu flasim me gjuhën dhe faktet reale të cilat janë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sadri Ferati e ka fjalën. Por, të lutem, vetëm një moment! Së pari le ta marrë fjalën, se zonja Haxhiu po thotë ka kohë, e unë e di që nuk e ka, por le ta marrë fjalën. Pra, zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: E arritura e Qeverisë së Republikës së Kosovës është legalizimi i strukturave paralele në pjesën veriore të Mitrovicës dhe direkt legalizimi ose produkti nga këto struktura i Listës Serbe këtu, e që politikat hartohen në Beograd, kurse implementohen këtu.

Prandaj, e gjithë kjo çka ka ndodhur, është rezultat i kësaj Qeverie dhe të gjitha të mirat që kanë shkuar tek ata shqiptarë atje, sot ata nuk po i prekin. Unë nuk di! Di edhe atë që një nxënëse, ashtu sikur që e tha Liria, ka kërkuar në Komisionin tonë me fjalët e një fëmije: “Ju lutem, ndërtoni shkollën tonë ku jetojmë, në baraka”. Pra punojnë dhe jetojnë fëmijët atje në baraka.

Unë nuk di ç’ është e arritur. Unë nuk di që diçka tjetër kanë prekur të mirë ata shqiptarë në veri, por dëmet janë shumë më të mëdha. Se sa të kthyer ka atje, le të na tregojnë saktë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe kështu ta dhanë një minutë dhe shkojmë tutje. Sadri, urdhëro!

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjithmonë, sa herë që veriu është në rend të ditës, kjo është një temë interesante, është sfiduese.

Unë po besoj se askush sot nuk është duke u bindur se kjo është një temë sfiduese, por ata që janë marrë me shtetndërtimin dhe ata që e kanë përcjellë dhe është investuar në krijimin e Republikës së Kosovës, gjithmonë ka qenë të bindur se kjo është një prej temave kryesore, bile edhe në vetë dizajnimin e Republikës së Kosovës që nga fillimi i diskutimeve për planin e Ahtisarit veriu ka qenë një diçka që gati se e ka determinuar një pjesë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Dhe, nuk ka qenë asgjë naive. Të gjithë e kanë ditur se nga i vjen rreziku më i madh Republikës së Kosovës në aspektin e integritetit të saj.

Dhe, të gjithë ata që kanë qenë kundër asaj kushtetute, de fakto nuk e kanë nuhatur cili është rreziku i shtetit të Kosovës. Dhe tani ne të gjithë po bindemi se ata që e kanë pasur me shpirt e me zemër, edhe e kanë gjetur diagnozën. Pra, është pikërisht që lëvizja nga status quo-ja do të çojë në lindjen e një shteti, që është Republika e Kosovës, por forcimi i saj dhe funksionalizimi i saj do të ketë sfida, dhe pikërisht raporti i integritetit të veriut dhe raportet ndëretnike do të jenë sfida kryesore për të krijuar një besim, se këtu po lind një shtet që nuk do të bazohet mbi të kaluarën dhe gabimet që kanë ndodhur përmbi një vizion dhe mbi ndërtimin e një shoqërie që do të jetë shembull dhe që as ata që kanë investuar në lirinë e këtij vendi, as miqtë tanë ndërkombëtarë asnjëherë nuk do të pendohen pse ne sot jemi qytetarë të Republikës së Kosovës.

Edhe ky rezultat asnjëherë nuk ka qenë i matur vetëm me dëshirat tona. Sikur të ishte matur çka ne dëshirojmë, do t'i kishim rënë më shkurt, do ta kishim bërë më shpejt, do të kishim dalë më të fuqishëm. Por, pikërisht raporti i atyre forcave dhe gjendja në terren na ka detyruar ta kalojmë këtë rrugë, përafërsisht.

Ndoshta, edhe kemi mundur më mirë. Mirëpo, vetë ndërtimi i shtetit nuk është as privilegj dhe as përgjegjësi vetëm e një personi, e një partie, e pozitës, opozitës, ose vetëm e shqiptarëve ose vetëm e joshqiptarëve, por pikërisht një shtet që u jep të gjithëve, krijon obligim që të gjithë të investojmë në atë.

Unë e di se cila ka qenë qasja në të kaluarën, besa jo vetëm neveri, posaçërisht, por ndoshta nganjëherë edhe në Prishtinë, që është nisur nga ajo: “Sa më keq, aq më mirë”. Dhe, në fund, ne u bindëm se ajo çka është keq nuk sjell dobi.

Prandaj, do të duhej ta ndërrojmë qasjen të gjithë, që të mund ta kemi një perspektivë më të shpejtë në këtë drejtim.

Dhe, Pakoja e Ahtisarit, Kushtetuta, Republika e Kosovës ka dëshmuar se integrimi i veriut nuk është një akt, por megjithatë ka paraparë se do të jetë një proces mjaft sfidues, nëpërmjet të cilit ne duhet të kalojmë.

Unë e di që të gjithë duhet të kemi një rol pozitiv dhe në kuadër të përgjegjësi tona për të krijuar një besueshmëri më të madhe për të ecur përpara.

Mua, disa liderë të komunitetit serb, përbërës të Listës, por edhe në ekzekutiv, nuk më bindin se e kanë me zemër kur i shoh atje në orar të punës duke dalë para një kishe, ndërsa asnjëherë nuk u bie në mend se edhe trojet e xhamive janë rrezikuar, aty ku e ka më lehtë dhe aty ku ka qasje. Sikur ta kisha parë unë atë person, duke dalë e duke thirrur në tolerancë, në respektim të besimeve fetare, të Xhamia e Urës së Ibrit, ndoshta do të kisha dalë ta pyes a je lodhur edhe të ndërtesa që pretendohet se është kishë në kampusin e Universitetit. Mirëpo, unë nuk i besoj atij, sepse ai po më bën mua të mos i besoj për një sjellje të njëanshme, edhe duke dëshiruar të prezantohet se ai është interes parcial, sepse i shërben një interesi të vogël.

Dhe, prapë po kthehem në atë kohën kur edhe në vitin 2004 është menduar se i shërbejmë një interesi të vogël dhe u pa se të gjithë do të dëmtohem.

Dhe, për fat të keq, nganjëherë edhe ne vetë nuk kemi qenë të vetëdijshëm se kush po na i udhëheq disa procese. Ne e dimë se disa protesta e disa barrikada janë vendosur në mënyrë të kontrolluar, është ditur kush po i qet e kush po i heq.

Por në vitin 2004 edhe sot e kësaj dite unë si banor i Kosovës dhe i Mitrovicës nuk e di as kush e nisi, as si përfundoi.

Prandaj, nuk dëshiroj asnjëherë të jem dhe të shoh se në Kosovë po mbretëron stihia, se po mbretërojnë procese të mllefrit dhe që pastaj nuk dimë as kush i nisi, as kush po i përfundon.

Unë dëshiroj të besoj, sepse edhe një gjendje aktuale, edhe një situatë favorizuese që e kemi në raport me komunitetin serb, dhe pres se ajo do të jetë një favor që i bëhet një gjendjeje ekzistuese, në mënyrë që të tejkalohet më shpejt tranzicioni deri në normalizimin e gjendjes, por jo të pretendohet se ajo do të ndodhë çdoherë, se nuk ndodh ajo.

Por, nga ana tjetër, unë pres se pikërisht mbi ato favore të krijohet një mundësi - që qytetarët e Republikës së Kosovës të gjithë të ndihen të barabartë, të kenë mundësi të barabarta dhe që bashkërisht ta ndërtojmë një perspektivë të barabartë.

Dhe e di që, nëse vazhdojmë kështu, nuk do të jetë e largët dita kur ne do të kemi në kuadër të reprezentacionit të Republikës së Kosovës edhe pjesëtarë të komunitetit serb nën flamurin tonë të përbashkët, tonin dhe të tyre, të Republikës së Kosovës. Sepse, nuk do të kemi vetëm Majlinda, por të kemi edhe të komuniteteve të tjera që me aq krenari do ta dëgjojnë himnin dhe do të shikojnë ngritjen e flamurit të Republikës së Kosovës.

E di që ka reagime, jo të gjithë besojmë në këtë, por unë jam dëshmitar i asaj kur njerëzit nuk kanë besuar as në Rambuje, as në Vjenë, as në Ekipin negociator, as në vizionin e presidentit Rugova, as në mesazhet e luftës së shenjtë të UÇK-së, mirëpo sot janë ulur bashkë me ne këtu

dhe ka kohë të mësojnë, nëse atëherë s'kanë besuar, tash bile janë dëshmuar disa gjëra, janë shumë të lexueshme.

Ose, së paku unë po i lexoj dhe le të më lejohet të vazhdoj me këtë çka unë po kuptoj. Prandaj, në këtë drejtim unë mendoj se ne nuk duhet të dorëzohemi në momentin që tani numërojmë rezultatet, që janë në mungesë të asaj që ne dëshirojmë, por në atë çfarë e meritojnë ligjet pozitive të Kosovës dhe situata reale.

Sepse, nëse gjithmonë ne presim të numërojmë prej 10, harrojmë çka është 1, 2, 3. Dhe thuhet, duke pritur proceset e gatshme, t'i dhurojë dikush, ti harron të punosh, ose duke pritur që të jesh ideal, ti de fakto nuk mund të jesh as mesatar.

Dhe, në këtë drejtim, nëse ne vazhdojmë kështu të dëshmojmë se shteti, Republika është menduar se po u dorëzohet njerëzve që kanë vizion, që dinë të bëjnë politikë, që dinë të formojnë shtet dhe dinë ta zhvillojnë atë shtet, se sa do ta përshtatin atë shtet dhe ato vlera me vlera më të larta, aty ku ne po synojmë të shkojmë, në Bashkimin Evropian dhe civilizimin perëndimor.

Prandaj, në këtë drejtim, unë dëshiroj t'i ftoj të gjithë për të qenë pjesë e ideve tona, e kontributit tonë. Do të kisha dëshiruar të shoh një ridizajnim të dialogut në mënyrë që dialogu, përveç përmbajtjes, të ketë edhe një efikasitet dhe që shumë shpejt edhe qytetarët, edhe ata më skeptikët, të shohin se Kosova po bëhet shtet, dhe nga ana tjetër, të shohin se edhe Beogradi po del nga Kosova.

Dhe ndoshta ne s'do të kishim pasur fuqi ta largojmë, por interesi i vetë Beogradit shihet se është udhëtimi kah Brukseli dhe aty e kemi stacionin e përbashkët, ku do të takohemi.

Dëshiroj të jetë në përpikëri zbatimi i marrëveshjeve të arritura deri tash dhe pastaj të vazhdohet me zbatimin e përpiktë të ligjit në të gjitha fushat dhe që sundimi i ligjit të jetë i pakompromis në atë pjesë.

Përveç funksionimit dhe aftësisë të segmentit të drejtësisë në atë pjesë, që kemi deficit marramendës, sepse pikërisht popullizmi dhe krimi atje ka bërë që ecja jonë ka qenë më e ngadalshme.

Mirëpo, tash ne kemi partnerë nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që dalëngadalë, edhe vetë Beogradi është bërë një partner, jo shumë me dëshirë, por patjetër që do të detyrohet t'i pranojë ato rezultate dhe të jetë aktor në implementimin dhe zbatimin e këtyre marrëveshjeve dhe që sundimi i ligjit sigurisht pastaj do t'i begatojë edhe fushat e tjera, nga liria e lëvizjes dhe segmentet e tjera të jetës.

Asimetria e aplikuar deri tani, edhe një herë duhet të dëshmohet se ne nuk po e dëmtojmë shtetin, përkundrazi, ne po e forcojmë shtetin me vetëdije, por do të kisha dëshiruar që në kuadër të asaj asimetrie ne të shohim efekte pozitive edhe për qytetarët shqiptarë që jetojnë në atë pjesë, qoftë nga fondi i veçantë apo nga kompetencat shtesë që i kanë komunat në atë pjesë të Kosovës.

Do të kisha dëshiruar që ministrinë sektoriale të kenë plane dhe veprime të veçanta dhe për atë ta njoftojnë Kuvendin në periudha të rregullta, se cilat janë veprimet konkrete dhe cilat janë rezultatet në atë pjesë.

Pastaj, të gjithë duhet të angazhohemi të ngremë kapacitete të komunave atje, që ato të ushtrojnë në mënyrë efikase përgjegjësitë e tyre, por që njëkohësisht ato të përkthehen me jetën më të mirë të qytetarëve, në mënyrë që ata të shohin se cili është përfitimi i tyre në zbatimin e ligjeve të Republikës së Kosovës dhe në sjelljen e tyre si qytetarë normalë në kuadër të Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me institucionet që vetë ata do t'i zgjedhin me votën e lirë.

Do të kisha dëshiruar që sa më shpejt të përfundojë regjistrimi i popullatës në atë pjesë, ngase me këtë ne përveç se do t'i kishim penguar disa anomali për të mos ardhur votat në paketa, për ta deformuar legjitimitetin, por nga ana tjetër, pastaj edhe do të kishim dhënë një definicion të saktë se çka është rikthim i qytetarëve të Republikës dhe çka është kolonizim, me të cilën ne po abuzojmë tepër shumë. Regjistrimi do t'i eliminojë këto paqartësi.

Duhet të ketë një program i veçantë dhe unë për këtë më pak e kam dëgjuar ministrin për Kthim se çka bëhet për kthimin e shqiptarëve në atë pjesë dhe atë me veprime konkrete institucionale, por jo stihike.

Unë kam pasur rastin të dëgjoj qytetarët e Mitrovicës që atyre në mënyrë selektive u thuhet se kujt ia meremetojnë banesën e kujt s'ia meremetojnë, e cila banesë është shkatërruar para syve të gjithëve atje. Prandaj, të gjitha ato fonde, me të cilat ne, komunitetit serb i ndërtojmë shtëpia për t'ia bërë të mundshme për ta shitur pak më shtrenjtë, ndërsa atje nuk e meremetojmë banesën në të cilën mund të kthehen qytetarët e komunitetit shqiptar.

Pastaj, në kuadër të fondeve të veçanta të bëhet një presion që të ketë një fond po ashtu të veçantë stimulativ për banorët shqiptarë në ato katër komuna. Dhe, në fund, të rriten investimet e Republikës së Kosovës, pra e ministrive, por njëkohësisht edhe të veprohet në drejtim të tërheqjes së investitorëve, të cilët pastaj do ta dhënë një kontribut më të madh të mundshëm në mosdiferencimin e njerëzve - ne dhe ata.

Dhe në fund, mbi të gjitha këto që thashë dhe mbi të gjitha këto ide të cilat unë i shpreha, të implementohen ato që janë të mundshme.

Unë asnjëherë nuk e kam vënë në pikëpyetje dhe tash aq më pak në ekzistimin dhe forcimin e shtetit të Republikës së Kosovës, integritetin e saj dhe perspektivën e shtetit të lirë dhe të integruar në Bashkimin Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të dimë si e kemi kohën e fituar. "Vetëvendosja" e ka një minutë, cili po flet? Rexhep Selimi, një minutë! Dhe, ju që jeni për shtet ligjor, zbatoheni ligjin!

REXHEP SELIMI: Dëgjo ti, Kamish! Po, unë kam qenë ministër i Rendit Publik në Qeverinë e përkohshme të Kosovës, duke themeluar Policinë e Kosovës bashkë me Klaus Reinhard e Stiv Benet, kur ti, bashkë me shefin tënd të SHIK-ut keni qenë duke i kthyer doktorët shqiptarë që donin të shkonin në spitalin rajonal të Mitrovicës. Po, kështu ka qenë.

Por, me kaq nuk duket se të kam njoftuar. Sepse, njëri nga ata, të cilët i ka kontribuar mosshkuarjes atje jeni edhe ju si emisar, duke shkuar në shtëpinë e Ali Kadriut, duke e kërcënuar që ai të mos vazhdojë ndërtimin.

Pra, për këtë çka unë kam bërë, nuk më vjen keq. Ty duhet të të vijë keq, edhe të shpifësh duhet të të vijë keq dhe të merresh me manipulime. Prandaj, në këtë rast je bërë avokat i Oliver Ivanoviqit, vazhdo si i tillë.

Nëse e ke problem Ministrinë e Punëve të Brendshme, nuk e kam hall, nëse e ke problem Ministrinë e Punëve të Brendshme më shumë se Ministrinë e Punëve të Brendshme - MUP-in e Serbisë, as këtë nuk e kam problem. Prandaj, kur të dalësh këtu, mos shpif dhe mos gënje.

KRYESUESI: Partia juaj ka ende minuta, por ti tash po i shfrytëzon. Mirë, shkurt, dhe e di sa minuta i ke. Nuk është punë partie, këtë e ke si replikë, sepse diskutimin e ke pasur.

(Ndërrhyrje)

E ka kryer ai, a? Po kryeje edhe ti, pra, një minutë!

BEKIM HAXHIU: Shiko, ti, Rexhë! Ne e dimë situatën e 99-tës, edhe të sotshme dhe më vjen mirë që e pranon një fakt se nëse ka qenë dikush me ata banorë, me Ali Kadriun, me doktorë në veri... Jo, jo! Me doktorë për të qëndruar atje, Rexhë! Kanë qenë këta, që ti i përmende më herët, bashkë me mua. Dhe, po them, po e them, Rexhë, derisa këto probleme kanë qenë ne veri dhe ti ke qenë ministër i Punëve të Brendshme, vëllezërit tuaj janë marrë me uzurpime në Klinë dhe në Prishtinë.

Ky është fakt! Jo, ta kanë larguar tash. AKP-ja ta largoi vëllain prej Prishtine, prej uzurpimit. Ashtu është!

KRYESUESI: Unë po ta jap edhe një minutë, por një moment, ju lutem!

(Ndërrhyrje)

Jo, zoti Selimi dhe ti zoti Haxhiu, e dini dytë, sepse edhe Rregulloren e dini, nuk jemi në një seancë dëgjimore, por në një seancë me interpelancë. Unë ju dhashë shans ta bëni një replikë, mirëpo mos e zhvillonin në diskutim, sepse s'është temë kjo. Të lutem, shfrytëzoje edhe një minutë e kryeje, sepse nuk është kjo temë, të vazhdojmë me tjerët, sepse ka që duan të flasin.

BEKIM HAXHIU: Pajtohem, i nderuar!

Diskutimi im ishte konceptual, ishte përmbajtjesor në kuptimin e zhvillimeve në veri, prandaj e thashë atë që ka qenë situata atëherë dhe që është tani. Dhe, qytetarët e veriut dhe të Mitrovicës më njohin mua dhe ty, prandaj më kanë nderuar mua, e jo ty.

KRYESUESI: Janë edhe dy deputetë të paraqitur për diskutim. Njëri s'ishte këtu, e tash u kthye, është zoti Zemaj. Ibishi është këtu. Janë edhe 18 minuta dhe nëse ndahen, ju bien nga 9,

përndryshe nëse flisni sa pararendësi i LDK-së, veç njëri i harxhon dhe s'i dalin. E ka fjalën Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues,
Kryeministër,
Ministra,
Kolegë deputetë,

Realisht nuk do të dëshironim sot t'i ikim temës së debatit. Për mendimin tim, sa herë që duhet të bisedonim mbi të gjitha dhe nëse kërkohet përgjegjësi institucionale mbi situatën politike jo vetëm në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, por në vend, mendoj që serioziteti dhe aktualiteti nuk duhet të anashkalohet dhe mbi të gjitha, jo vetëm për ta përdorur për folklor politik apo për konsum ditor politik, siç edhe po trumbetohet jo rrallëherë, u pa edhe në ditën e sotme.

Nëse vitin e kaluar kemi dëgjuar raportimin për marrëveshjen nga ana e kryeministrit dhe një vit i tërë ka kaluar dhe tema e kësaj interpelance të sotme mendoj se do të duhej të ishte përgjegjësia e institucioneve në tërësi rreth situatës aktuale në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, sepse edhe obligimet e Kuvendit, nuk e di që deri sot kanë raportuar apo është raportuar për mbikëqyrjen qoftë respektimit ligjor të atyre marrëveshjeve, apo edhe tentimi që të shihet nga ana vizuale dhe praktike e komisioneve parlamentare dhe, nëse nuk gaboj, përveç Komisionit për Punë të Brendshme, asnjë komision tjetër parlamentar nuk e ka parë të udhës që të vizitojë pjesën veriore, institucionet e saj, ato të drejtësisë, shëndetësisë, të arsimit e tjera, që të shohin për së afërmi se si po zhvillohet jeta institucionale dhe publike. Mbi të gjitha, pasi që kemi një kualifikim këtu në këtë arsyetim se Serbia dhe strukturat ilegale serbe e mbajnë të uzurpuar jetën publike dhe private të banorëve të asaj pjese.

Prandaj, për këto arsye, pak shumë edhe për ministrat që janë prezentë dhe vetë kryeministri në elaboratin e tij i dha disa përgjigje dhe përgjigjet mendoj se duhet vazhduar të kërkohen nga ana e Kuvendit, edhe konkrete, me shifra, me statistika që përpos njoftimit publik që do t'i kenë deputetët, të mos ngarkohet edhe opinionin publik, sepse njerëzit jetojnë e veprojnë në atë pjesë dhe mbi të gjitha zhvillojnë jetën, apo tentojnë edhe ta begatojnë jetën, e kur i dëgjojnë këto fjalime aq pompoze, aq folklorike, kurse ata atje përballen me realitetin, mendoj se nuk është e ndershme dhe nuk i kontribuon situatës në përgjithësi.

Sa i përket historikut të çështjes së veriut, mendoj se shumica e gjërave tash dihen, qoftë nga 1998, 1999 dhe po shihen se kërkesa për një fajtor për gjendjen në veri besoj është e vonuar, sepse ajo tash ka hyrë në një fazë tjetër të shtetndërtimit dhe po shpresoj se me sundimin e rendit dhe ligjit në vend, do të marrin përgjigje edhe ato delikte e veprime që për mua personalisht kanë qenë kriminale, sepse njerëzit me emra e mbiemra janë të njohur se kush ka bashkëpunuar dhe kujt i ka konvencuar situata në veri, kush ka bërë tregti të paligjshme, kush ka bërë uzurpime, kush ka tentuar që kjo pasiguri ligjore të vazhdojë atje dhe njerëzit dihen, qoftë në territorin në atë pjesë, edhe në territorin e brendisë së Kosovës, apo edhe të cilët kanë pasur fuqi politike e patriotike, nën thonjëza, për t'i zhvilluar ato aktivitete.

Qytetarët e asaj pjese që jetojnë, sidomos qytetarët shqiptarë, të cilët janë të diskriminuar me vite të tëra, qoftë në rikthim, apo qoftë edhe ndihmën që e kanë marrë nga shteti, mendoj se tash pak

a shumë kanë arritur që të shohin edhe vetë se si ecin, të quaj kushtimisht, avancimin nga pjesë të marrëveshjeve politike që janë arritur në Bruksel.

Mendoj se shumë gjëra, të cilat u theksuan në pjesën e raportimit, dhe ato që mbesin, mendoj se tash duhet të jemi pak më syçelë, mbi të gjitha, pse jo, të dalim edhe nga petku politik e partiak, sepse njerëzit jashtë dinë e shohin dhe, mbi të gjitha po komunikojnë më shumë me atë pjesë, por ne bashkërisht me Kuvendin e Qeverinë duhet t'i bashkërendojmë aktivitetet dhe sidomos komisionet parlamentare dhe të shohin në praktikë se sa po implementohen dhe cilat janë masat, qofshin ato preventive dhe të avancuara të jetës institucionale e publike.

Unë do të dëshiroja saktë të di, si deputet i Republikës së Kosovës, dhe sigurisht edhe kryesuesit të seancës i intereson, sepse po e shoh që me mimikë po më aprovon, sa nga strukturat paralele të "rojave të urës", për shembull, janë inkorporuar në Policinë e Kosovës, cili është numri i gjyqtarëve, i prokurorëve, se si po ecën ky proces i marrjes së kompetencave nga Këshilli Gjyqësor e Këshilli Prokurorial i Republikës së Kosovës, cili është saktësisht plani qoftë operativ i Forcave të Sigurisë për avancimin në atë pjesë, apo trajtimi i objekteve që do të shfrytëzoheshin dhe gjërat elementare, siç janë arsimi dhe shëndetësia.

Arsimi dhe shëndetësia janë tema që më së shumti ndoshta Serbia po tenton dhe vazhdon të tentojë të ushtrojë ndikimin e saj.

Dhe, për fund, besoj se pak a shumë përgjigje të tilla sot morëm dhe unë qëndroj prapa atij deklarimi se përgjegjësitë duhet të ndahen, duhet të jenë konkrete nëse dëshirojmë të kemi integritet të plotë të jetës institucionale dhe rikthim të banorëve në atë pjesë.

Gjuha e përdorur, retorika boshe, nuk i kontribuon zgjidhjes së situatës, qoftë pozitive apo opozitive, dhe besoj që, nëse kështu vazhdojmë, aty do të sillemi. Është mirë dhe me krenari të thuhet sukseset. Nuk është e turpshme që edhe nga aspekti opozitar të pranohet. Është mirë dhe e domosdoshme që të deklarohen mosesukseset, aty ku duhet të shtyhen gjërat përpara, por të thuhet se asgjë s'ka lëvizur në atë pjesë, ose nuk e ke jetuar fare, ose s'ke përcjellë jetën institucionale, ose nuk ke përcjellë raportet, ose s'e di si ka qenë ndarja e përgjegjësisë qoftë nga aspekti i përgjegjësisë vendëse, por mbi të gjitha, edhe të atyre ndërkombëtare që sot nuk u potencuan dhe u anashkalua si fakt, sepse e dimë të gjithë se ndërkombëtarët kanë pasur ndikim jashtëzakonisht të madh në atë pjesë. Minutat shtesë, besoj do t'i vazhdojë kolegu im, Nuredin Ibishi. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka, i fundit, Nuredin Ibishi.

NUREDIN IBISHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar,
Zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministër,
Kabinet qeveritar,

Unë shpreh konsideratën për deputetët që kanë kërkuar interpelancën, por edhe ekspozenë e kryeministrit lidhur me gjendjen e sigurisë në veri të Kosovës, e njëkohësisht edhe konsideratën për deputetët që pavarësisht tensioneve, ngritën çështje të cilat janë shqetësim i përbashkët.

Çështja për të cilën unë do të flas më shumë është edhe aspekti, të cilin edhe zoti Zemaj e ceku, i prezencës institucionale në veri dhe unë po cek se Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe FSK e ka bërë një vizitë më 27 qershor në veri të Kosovës me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit të Policisë, pra në Mitrovicën e veriut, në komandën rajonale të Stacionit policor dhe nga autoritetet kompetente kemi marrë informacione lidhur me zbatimin e ligjit, duke filluar nga aspekti praktik, do të thotë të funksionimit të sistemit policor, të bashkëpunimit me Prokurorinë, me gjyqësinë dhe normalisht me komunitetet që jetojnë në veri të vendit.

Po ashtu, është për t'u veçuar edhe aspekti i krijimit të këshillave për siguri publike në kuadër të komunave dhe këshillave lokale, e gjithashtu në këtë situatë është edhe krijimi i ekipeve vepruese atje, që janë një perspektivë për gjendje më të mirë të sigurisë në vend.

Pra, duke marrë parasysh të gjitha këto në 17-vjeçarën e kaluar në aspektin e problemeve, sfidave dhe perspektivës së integritetit të veriut dhe lidhur me strukturat paralele, mendoj se situata është dukshëm më e mirë dhe mendoj që edhe Qeveria, edhe gjyqësori, por edhe Kuvendi duhet të bëjnë më shumë, me qëllim që jo vetëm të prezencës, por edhe aspektin e integritetit, në aspektin kuptimplotë të të gjithë sektorëve apo segmenteve të sigurisë, sidomos atje ku ka të bëjë edhe me lëvizjen e lirë dhe të drejtat e njeriut, të cilat realisht nuk janë në nivelin e duhur në kuptimin e asaj sidomos të komunitetit joshumicë në veri, të shqiptarëve, të boshnjakëve, turqve dhe të tjerëve.

Pra, pa dashur ta zgjas, edhe një herë shpreh mendimin dhe qëndrimin tim se institucionet e Kosovës, sidomos për këtë situatë kisha për të apeluar për krijimin e prokurorive dhe gjykatave në veri, për të cilat momentalisht ndihet mungesë aty, për arsye se dihet që gjykata vepron vetëm në Vushtrri, së bashku me prokurorinë, dhe ky krijim i funksionalizimit të sistemit në veri do të sillte avantazh për të gjitha komunitetet me qëllim të krijimit të kushteve jetësore, por edhe krijimit të gjendjes më të mirë të sigurisë për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë etnike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur që të flasin për temën. Prandaj, nëse do, Qeveria le të artikulohet. Nuk do!

Atëherë, paraqitësi i kërkesës për interpelancë e ka kohën e tij dhe fjalën e ka zoti Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Shumë folës sot thanë se kjo që po ndodh në veri është proces. Pajtohem edhe ne se është proces, por është shumë e rëndësishme se kah po shkon ky proces, cili është kahu i procesit? A po shkon drejt integritetit të veriut, apo drejt shpërbërjes së saj?

Nga ato që i përmendi kryeministri dhe i numëroi si suksese nuk premtojnë fort për integritetin e veriut të Kosovës, e këto janë: se serbët e veriut kanë pranuar nënshkrimin e një marrëveshjeje të mirëkuptimit për realizimin e projekteve në veri; se ata kanë pranuar akordimin e fondit për zhvillim; se kanë pranuar qytetarët e veriut të takohen me kryeministrin për të realizuar projektet e tyre; se ata e kanë aprovuar buxhetin e komunave dhe në këtë mënyrë, kanë pranuar të marrin para nga buxheti i Kosovës. Dhe, në të gjitha këto raste, ata kanë pranuar ta shfrytëzojnë këtë

buxhet, në të cilin nuk kontribuojnë për asnjë cent, prandaj kjo nuk flet shumë për integrim, por është më tepër një mundësi që ne po ua japim për të zhvatur nga ky buxhet.

Po ashtu, edhe zhbërja e disa strukturave paralele, të cilat me urdhrin e kryeministrit janë futur në listat e rrogave, e pagave, pa punuar fare, edhe kjo nuk flet shumë për integrim. Ata edhe më tutje punojnë për Serbinë.

Dhe krejt kjo që është cilësuar si bashkëpunim, natyrisht se vjen në një përfundim që shtron një pyetje: A thua, ky bashkëpunim ka rezultuar me Lagjen e Diellit, për të cilën Qeveria në vend që ta pengojë këtë projekt kolonizues, po angazhohet për legalizimin e saj?

Dhe, si konkluzion i këtyre përpjekjeve për integrim dhe atë që e tha kryeministri se serbët e veriut po integrohen, ne s'kemi si t'i besojmë deri sa kryeministri nuk ka arritur t'i integrojë ministrat në Qeverinë e tij, të cilët i paguan kjo Qeveri, e ata shef e kanë Vuçiqin dhe jo Isa Mustafën.

Kolegë deputetë,

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës si dhe për të gjitha këto arsye të paraqitura gjatë kësaj interpelance lidhur me gjendjen në veriun e vendit tonë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” u propozon për miratim deputetëve të Kuvendit të Kosovës këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Qeveria e Kosovës, ministritë respektive, të nxjerrin vendime dhe të veprojnë në terren për ndalimin e çdo veprimi lidhur me ndërtimin e një lagjeje kolonizuese në veri të vendit;

2. Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të plotësojnë me kuadër tjetër ligjor normativ parandalimin e iniciativave të tilla, me karakter të ndarjes etnike;

3. Të ngarkohet Qeveria e Kosovës të hartojë menjëherë planin e masave dhe kalendarin për garantimin e kthimit të qytetarëve shqiptarë dhe rindërtimin e shtëpive të tyre në veri të vendit, dhe

4. Kryeministri i Qeverisë së Kosovës t'i raportojë Kuvendit të Kosovës 60 ditë nga miratimi i kësaj rezolute për gjendjen dhe masat e marra nga Qeveria për kthimin e qytetarëve shqiptarë në pronat e tyre dhe ndalimin e ndërtimit të kolonive serbe në Kosovë.

Pra, i lus të gjithë deputetët ta përkrahin këtë rezolutë, për të cilën pyeti Haxhiu nëse është politike. E ka këtë qëllim që e lexova unë, e jo qëllime të tjera, të cilat dikush mund t'i mendojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Unë ju lus të gjithëve tash, edhe juve që në këtë rast jeni, “Vetëvendosja” që po luteni për deputetë të tjerë, edhe herëve të tjera kur po luten këta, që të mësoheni se obstrukcionet në Kuvend janë qesharake ngado që bëhen.

Nuk po e zhvilloj më tutje tezën, ju e kuptoni të gjithë. Nuk ka deputetë që të votohet sot, as për këto, e as për të tjerat. Debati ka mbaruar. Kjo vlen edhe për ju të tjerët, njësoj është, e dyanshme.

Në mbledhjen tjetër, që e cakton Kryesia e Kuvendit, do të kryhen votimet. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*